



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Mallakastër”

RAPORT

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

Bashkia Mallakastër

Tiranë, 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-21
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Mallakastër	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4-5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-14
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	14-18
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	18-21
II	HYRJA	21-25
1	Objektivat e auditimit	21
2	Qëllimi i auditimit	21-22
3	Identifikimi i çështjes	22
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	22
5	Përgjegjësitë e audituesve	22
6	Kriteret e vlerësimit	22-23
7	Standardet e auditimit	23
8	Metoda e auditimit	23-24
9	Dokumentimi i auditimit	24-25
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	25-172
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Mallakastër	25-26
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	26-172
2.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	26-35
2.2.-2.2.5	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.	35-42
2.2.6	Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.	42-52
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023.	52-76
2.4-2.4.3	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit	76-131
2.4.4	Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	131-144
2.5	Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.	144-149
2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe Njësisë Vendore.	150-152
2.7	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	152-172
IV	REKOMANDIME	172-201
V	ANEKSE	201-216
VI	LISTA E DOKUMENTEVE	216-217

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Mallakastër:

Bashkia e re e Mallakastrës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me Bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me Bashkinë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 27.062 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë 43.033 vetë si popullsi. Sipërfaqja e bashkisë së re është 329.19 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 82.45 banorë për km², ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 130.72 banorë për km².

Kryetar i Bashkisë Mallakastër është z. Q.I si dhe Këshilli Bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë.

Për vitin 2023 planifikimi përfundimtar i shpenzimeve ka qenë 870,641 mijë lekë, ndërkohë që realizimi ka qenë 605,412 mijë lekë ose në masën 69% me një diferencë mos realizimi në vlerën 265,229 mijë lekë.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ka qenë në vlerën 394,650 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 191,560 mijë lekë ose në masën 48% me një diferencë mos realizimi në vlerën 203,089 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij:

Bashkia e Mallakastrës është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish-Bashkia Mallakastër dhe katër ish-komunat në afërsi të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe ato janë: Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar dhe Selitë.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të Auditimeve për muajin Janar të vitit 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87 prot., datë 16.01.2024.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- ✓ Verifikimi i transaksioneve;
- ✓ Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- ✓ Intervistat;
- ✓ Verifikimi në sisteme etj.,

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 51 gjetje dhe ka dhënë 57 rekomandime, nga ku masa organizative 40 gjetje me 47 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 4 gjetje me 4 rekomandime, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike 2 gjetje me 2 rekomandime, masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash 3 gjetje me 3 rekomandime dhe masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia 2 gjetje me 2 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm:

1.a. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Mallakastër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore.

-Nuk janë hartuar plane vjetore të miratuara nga titullari i institucionit për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave vjetore.

-Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dërguar pranë MFE-së nuk përfshin të gjithë kapitujt dhe elementët përkatës.

1.b. Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan parregullsitë, si më poshtë:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Nga shqyrtimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Mallakastër, pika 1 e saj, “Objekti i kartës së auditimit të brendshëm” nuk është përditësuar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e cila nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

-Në planin strategjik nuk është paraqitur volumi i punës që do të kryhet në 3 vitet e ardhshme (por është paraqitur për vitet 2022-2024) pra nuk është parashikuar veprimtaria që do të zhvillohet nga NJAB në vitin 2025, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2.

-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemi i Prokurimeve, Sistemi i Pagave, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit, ku sipas përcaktimit të bërë në kapitullin nr. 3.1.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për të përcaktuar kohën për kryerjen e auditimeve merret në konsideratë niveli i riskut për çdo sistem. Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit:

2.a. Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 820,442 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 870,641 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 605,412 mijë lekë ose në masën 69%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 322,848 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 293,316 mijë lekë ose në masën 90%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 223,802 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,265 mijë lekë ose në masën 39%.

Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 8,673 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,511 mijë lekë ose në masën 52%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 219,320 mijë lekë ose në masën 72%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe realizuar 219,320 mijë lekë ose në masën 71%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

2.b. Bashkia Mallakastër më datë 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 10,419,769 lekë. Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2023 nuk është parashikuar asnjë fond për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 nuk është likuiduar vlera e detyrimeve të prapambetura 10,419,769 lekë, por janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 19,805,360 lekë si pasojë e humbjes së vendimeve gjyqësore. Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura nga Bashkia Mallakastër është kryer me shkresën nr.440 prot, datë 29.01.2024, detyrimet e prapambetura janë raportuar në vlerën 10,419,769 lekë.

Nga verifikimi i faturave të palikujduara rezultoi se më datë 31.12.2023, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën 22,226,489 lekë.

Detyrimet e Bashkisë Mallakastër vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive. Në këto kushte likuidimi i këtyre faturave nuk mund të kryhet.

3. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre:

3.a. Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore është në vlerën **394,650,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **191,560,521 lekë** ose në masën **48%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **203,089,479 lekë**. Referuar vlerës 203,089,479 lekë të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

“Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 37,576,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,035,861 lekë ose realizuar në masën 13%; “Taksë toke” është planifikuar në vlerën 26,226,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,863,521 lekë ose realizuar në masën 52%; “Taksë ndotje mjedisi” është planifikuar në vlerën 122,446,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 59,136,080 lekë ose realizuar në masën 48%; “Taksa e kalimit të pronësisë” është planifikuar në vlerën 24,439,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 3,442,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,660,495 lekë ose realizuar në masën 309%; “Tarifë për dhënie leje, liçenca dhe autorizime është planifikuar në vlerën 1,824,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,107,926 lekë ose realizuar në masën 170%; “Regjistrimi i automjeti të përdorura” është planifikuar në vlerën 13,113,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,139,589 lekë ose realizuar në masën 107%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura.,

3.b. Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim-Taksave, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në ifrastrukturë dhe DRSHTRR Mallakastër në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mallakastër. Bashkia Mallakastër ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Mallakastër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117.

3.c. Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezulton se përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe njësisive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023, gjithsej rezultojnë 6 subjekte të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Mallakastër të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë, kërkesë për bashkëpunim nga Sektorit të Tatim Taksave dhe Policisë Bashkiake.

3.d. Nga auditimi i dokumentacionit mbi të ardhurat e realizuara nga kontratat e qirave për sipërfaqe pyjore, kullosore dhe inproduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Mallakastër, rezulton se në territorin e Bashkisë Mallakastër ushtrojnë aktivitet 2 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private, konkretisht:

1. Subjekti “F ” Shpk me Nipt L...D, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1829, datë 29.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Drizari, Hekal për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.144 km² ose 14.4 ha

2. Subjekti “C Shpk me Nipt L...A, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1868, datë 08.04.2019, për shfrytëzimin e vendburimit Povel Grashicë për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.033 km² ose 3.3 ha.

3.e. Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër konstatohet se deri më datën 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën **64,904,730 lekë** shumë e cili i përket vetëm abonentëve familjarë.

Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, është krijuar borxhi tatimor në **vlerën 6,462,724 lekë për abonentët familjar**. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datë 31.12.2023, është në vlerën **71,367,454 lekë**.

Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër konstatohet se deri në datë 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën **1,114,815,925 lekë**. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2023, është në vlerën **1,107,401,700 lekë**.

Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, janë në vlerën **1,178,769,154 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër** e përbëra nga:

- Detyrime abonentët familjarë në vlerën 71,367,454 lekë;
- Detyrime nga biznesi VIP në vlerën 1,074,888,444 lekë;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 11,207,733 lekë;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 8,985,573 lekë;
- Detyrime nga institucionet në vlerën 12,319,950 lekë;

4. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023:

4.a. Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 159,129,766 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 193,554,879 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 48,897,392 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,729,649 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 133,927,838 lekë.

4.b. Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 61,111,859 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 61,697,234 lekë me një rritje në vlerën 58,375 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 1,192,034,397 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore dhe për pasojë kjo

Ilogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Sektorit të Tatim Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërpartit llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

4.c. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 10,422,499 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,419,769 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

4.d. Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 669,570,307 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 689,116,975 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

4.e. Në myllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,489,713 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 698,822 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,330,767 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 734,579 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 10,729,649 lekë ku totali shkon në vlerën 20,983,530 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 28,708,429 lekë.

4.f. Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërpartit llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, u konstatua se kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 3,977,574 lekë si rrjedhojë e mos kontabilizimit të detyrimeve për shpronësim.

4.g. Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,861,939,155 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 251,052,915 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,865,460 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitorohet për pakësimin e vitit në vlerën 251,052,915 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 8,865,460 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 546,104,586 lekë.

5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit:

5.a. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit 192,162,428 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate 127,847,465 lekë pa Tvsh. Nga auditimi i 6 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Mallakastër për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, me fond limit 192,162,428 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 127,847,465 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në aplikimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

-Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 192,162,428 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 127,847,465 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë

e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

-Në 4 procedura nga 6 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 118,537,965 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Mallakastër, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

-Në 3 procedura prokurimi, preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të Bashkisë Mallakastër të cilët nuk janë të pajisur me licensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5.

6. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike:

6.a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush” me REF-34714-06-28-2022, me nr. 3408/9 prot., datë 27.09.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, dhe Kontraktorit OE “C” Shpk. Vlera e kontratës është 109,498,855.68 lekë me Tvsh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. **1.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorush” dhe “Diga e Rezervuarit-Kutë” u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës. Sipas detajit teknik në projektin e zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm; në terren kjo gjë nuk është respektuar në disa pjesë të rrugës. Konkretisht në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorush” ishte realizuar shtresën (binder + asfalt) më një lartësi totale mesatarisht 7 cm dhe në në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Kutë” ishte realizuar shtresa (binder + asfalt) më një lartësi totale mesatarisht 9 cm. Në total për segmentet rrugore vlera e dëmit ekonomik shkon 12,440,493 lekë pa tvsh. **2.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Kutë” dhe “Diga e Rezervuarit-Çorush” u vunë re disa çedime në rrugë në disa pjesë të sajë me një sipërfaqe totale 50 m², të cilat kanë efektin ekonomik 128,100 lekë pa Tvsh. **3.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorush” në disa pjesë të tijë u vu re se nënshtrësia e rrugës nuk ishte realizuar me mbushje me çakëll 30 cm sipas projektit; por ajo ishte realizuar 10 cm në një gjatësi rreth 150 ml me efekt ekonomik 99,750 lekë pa Tvsh. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **12,668,343 lekë pa Tvsh** (12,440,493 + 128,100 + 99,750) e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “C” Shpk

6.b. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj” me nr. REF-35560-07-06-2022, me nr. 3486/13 prot., datë 05.10.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, dhe Kontraktorit OE “S” Shpk. Vlera e kontratës është 129,202,020 lekë me Tvsh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. **1.** Në segmentin rrugor fshati Dukas u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës në (Segmentin 3’). Sipas detajit teknik në projektin e zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm. Në terren ka ndodhur një shmangie nga projekti i zbatimit, u vu re se ishte realizuar vetëm shtresa binder me një lartësi totale 6 cm dhe jo shtresa e asfaltit; duke patur efektin ekonomik 656,640 lekë pa tvsh. **2.** Nga kontrolli në terren dhe i dokumentacionit tekniko-ligjor të dosjes së objektit pjesa “Materiali fotografik për punimet e kryera në objekt” u vu re se muret mbajtëse ishin kryer duke mos respektuar vizatimet teknike, nga dy fije vertikale shpërndarëse në projekt në një fije shpërndarëse vertikale, duke patur një efekt ekonomik 227,500 lekë. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **884,140 lekë pa Tvsh** (656,640 lekë + 227,500 lekë) e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “S” Shpk

6.c. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujës-jellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)” me nr. 777/7 prot., datë 06.07.2021, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga titullari

i sajë z. Q.I dhe Kontraktorit BOE “A ” Shpk & “E ” Shpk & “K ” Shpk. Vlera e kontratës është 568,485,331.72 lekë me Tvsh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi si më poshtë vijon: **1.** Për zërin e punës “*F.V.Tub cel. Ø(355.6 x δ=8,5)mm i h/izoluar ne fabrike L= 5710m*” ka një pasaktësi në llogaritjen e peshës së tubit të çelikut. Kontraktori këtë zë e ka raportuar 429.91 ton ndërsa sipas llogaritjeve analitike referuar skedës teknike të prodhuesit ky zë shkon 392.91 ton; pra kemi një diferencë me efekt financiar prej 6,232,650 lekë pa tvsh. **2.** Referuar kapitullit “Depo 200 m³” në situacionin përfundimtar kemi futjen e disa zërave të rinj pune midis tyre kemi dhe zërin “*F.V.Mates E.M. Dn 300mm PN-40*” me çmimin 996,072 lekë/copë. Po të shihet me vëmendje ky zë pune ekziston në preventivin e ofertuar fitues të tenderit me çmimin 779,984 lekë/copë. Ky zë i ri me çmimin 996,072 lekë/copë nuk duhet të ishte pranuar në preventivin e rishikuar si nga ana e Mbikëqyrsit dhe nga ana e AK. Pra kemi një diferencë e që ka një efekt financiar 432,167 lekë pa tvsh. **3.** Referuar kapitullit “Tubacionet e transmetimit” në situacionin përfundimtar zëri “*F.V.Stafe EF Dn (350 x110)mm*” është raportuar 24 copë ndërsa në librezën e masave ky zë është raportuar 10 copë. Pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 219,856 lekë pa tvsh. **4.** Referuar kapitullit “Fuqia puntore Kabina” zëri i punës “*Montim Transformatori fuqie 750kVA, 20/0.4kV*” në situacionin përfundimtar është raportuar 30 copë, ndërkohë tek pjesa e pajisjeve ky zë është lënë 0 sepse transformatorët janë vendosur të tipit (1000kVA, 6/0.4 kV.) Pra kemi një diferencë me efekt financiar 28 copë x 9,450 lekë/copë = 264,600 lekë pa tvsh. **5.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “*Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m³, shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shk ne toke*” është raportuar 20,003.49 m³ sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m³, pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 1,491,644 lekë pa tvsh. **6.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “*Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri*” është raportuar 22,824 m² sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m², pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 3,831,750 lekë pa tvsh. **7.** Sipas kapitullit “Depo V=Rrethi i depos Klos” në situacionin përfundimtar zëri “*Rrethim me zgarë metal.galv(zgar komplet)*” është raportuar 167.20 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky rrethim ishte realizuar me një lartësi më të vogël me efekt financiar 122,569.04 lekë pa tvsh. **8.** Sipas kapitullit “Depo V=Rrethi i depos Klos” në situacionin përfundimtar zëri “*Hidroizolim me emulsion me 2 duar bitum(nga jashtë)*” është raportuar 119.27 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky zë nuk ishte kryer me bitum, me efekt financiar 66,791.2 lekë pa Tvsh. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet në total vlera prej **12,662,028 lekë pa Tvsh** (6,232,650 + 432,167 + 219,856 + 264,600 + 1,491,644 + 3,831,750 + 122,569.04 + 66,791.2); e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori BOE “A ” Shpk & “E ” Shpk & “K ” Shpk.

6.d. Për periudhën nga data 01.08.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Bashkisë Mallakastër duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **3,834 litra naftë në vlerën 729,534 lekë**. Nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej 3,834 litra naftë konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

-Për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **57,473 litra naftë në vlerën 10,673,716 lekë**. Nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej **30,937 litra naftë në vlerën 5,671,104 lekë** konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Për mjetet që njësi matëse kanë volumet dhe orët e punës në fletët e udhëtimit nuk ndodhet i përcaktuar vendi i punës (sipas rrugëve apo kanaleve etj., për çdo ditë pune), objekt i punës, orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësi/distanca e rrugë apo kanaleve në të cilën është kryer punimi apo pastrimi, fotot e punimeve të realizuara por ndodhet vetëm përmbledhsja e volumeve dhe orëve

të punës dhe e datave të bashku me vendin e punës (emërtimi sipas njësive administrative) për secilin mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

-Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për shtrimin e rrugëve me çakull kryesisht në fshatrat e Mallakastrës ka angazhuar gjashtë mjete të llojit kamion për realizimin e këtyre punimeve. Në lidhje me këtë situatë grupi i auditimit ka kryer rakordimin e të dhënave nga kontratat e mëparshme të furnizimit me çakull ku konstatohet se ndërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike përfaqësuar nga z. B.V Drejtor i NSHP-së dhe OE "E" Shpk përfaqësuar nga z. SH.E Administrator i Kompanisë është lidhur kontrata me nr. 58/6 prot., datë 27.06.2022, me objekt "Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh" në vlerën 29,989,068 lekë me Tvsh me afat 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Sasia e çakullit e përcaktuar për furnizim në kontratë është 5,513.68 m³ çakull guror në vlerën 4,920,944 lekë me Tvsh.

Furnizimi i kësaj kontrate ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë. Kjo kontratë i përket vitit 2022, ndërsa për vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër nuk ka nënshkruar kontratë të re për furnizimi me çakull. **Pra nuk dokumentohet dhe argumentohet ku është gjendur sasia e çakullit e cila është përdorur shtrimin e rrugëve në fshatrat e Mallakastrës.**

Për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **23,195 litra naftë në vlerën 4,265,080 lekë** për shtrimin e rrugëve me çakull.

-Për nga data 01.09.2023, deri më 31.12.2023, për kryerjen e transportit të çakullit për shtrimin e rrugëve janë përdorur pesë mjete të llojit kamion me targë AA871XP me drejtues mjete z. F.M , AA872XP me drejtues mjete z. P.L , AA895DH me drejtues mjete z. F.E , AB540DN me drejtues mjete L.J dhe FR1915B me drejtues mjete z. E.XH , **për të cilat është konsumuar karburant 4,492 litra naftë në vlerën 861,149 lekë jashtë afateve të përcaktuara në urdhrat e titullarit të institucionit për realizimin e punimeve (pra para nisjes së punimeve apo pas përfundimit të punimeve).** Ndërsa për sasinë e konsumuar për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.07.2023, të karburantit **10,565 litra naftë në vlerën 1,843,550 lekë nga NSHP nuk disponohet urdhër për fillimin e punimeve.**

Gjithashtu nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej **23,195 litra naftë në vlerën 4,265,080 lekë** konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet.

7. Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit:

7.a. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe me certifikatë përdorimi për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, u konstatua se:

-Në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i distancave nga objektet e tjera;

-Në **4 raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore;

-Në **2 raste**, Bashkia Mallakastër dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

8. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe Njesisë Vendore:

8.a. Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT Bashkia Mallakastër për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, rezulton se:

Janë mbajtur gjithsej **5** (pesë) proces-verbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë **5** (pesë) vendime për dënim me masë administrative (gjobë) me vlerë **882,099 lekë**, është marrë **1** (një) vendim për pezullim punimesh dhe asnjë vendim për prishje të objekteve të kundërligjshëm.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, konstatohet se nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm nga kryeinspektori, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, si dhe në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000137, datë 08.05.2023, konstatohet se në asnjë prej këtyre rasteve nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes 000138, datë 25.09.2023, është marrë masa ndëshkuese me gjobë me vlerë 50,000 lekë, por nuk është nxjerrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”.

Në lidhje me proces-verbale të konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, (referuar Tabelës nr. 2), konstatohet se në asnjë prej këtyre rasteve evidentimi i shkeljes nuk është kryer nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, por informacioni ka ardhur nga Prokuroria, veprime këto në kundërshtim me nenin 1, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, nenin 5, pika “a”.

Në lidhje me proces-verbale të konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, (referuar Tabelës nr. 2), konstatohet se në asnjë rast IMTV nuk ka njoftuar dhe kërkuar asistencë nga IKMT për prishjen e këtyre ndërtimeve, në kushtet e mungesës së mjeteve të përshtatshme për kthimin në gjendjen fillestare nga ana e Bashkisë Mallakastër. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 52, të Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 6.

8.b. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Mallakastër, nuk ka kryer detyrat e tij funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit, *konkretisht*:

Çertifikatë përdorimi për shtesë kati (banim) mbi objekt ekzistues, me adresë në fshatin Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. B.P , për të cilën është marrë Vendimi nr. 01, datë 07.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar aktit përfundimtar të kolaudimit, i cili është hartuar në datën 15.11.2022, shprehemi se zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të parashikuar në lejen për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, pra brenda datës 15.10.2022. Në sistemin e-lejet, si dhe nga auditimi i aktivitetit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) është konstatuar se nuk është marrë asnjë masë ndaj subjektit zhvillues për shkelje të afatit të punimeve.

9. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

9.a. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 204/8 prot., datë 11.07.2023, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 1014/16 prot., datë 12.07.2023, ku janë lënë për zbatim 29 masa organizative, 1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 112,566 lekë dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 846,572 lekë, 14 masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 1,171,333,912 lekë dhe 20 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 23 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë në vlerën 112,566 lekë e cila është janë pranuar plotësisht, nga masa e pranuar 1 masë është e pa zbatuar.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 2 masa në vlerën 846,572 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe **1 masë është e pa zbatuar**.

d. Për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 14 masa në vlerën 1,171,333,912 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 9 masa janë në proces zbatimi.

e. Masa disiplinore janë rekomanduar 20 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 20 masa janë në proces zbatimi.

Gjithashtu nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm:

1.a. Kryetari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.b. Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Mallakastër, të marrë masa:

-Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pageve, etj, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

-Gjithashtu nga Përgjegjësi i NjAB-së të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

2.a. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

2.b. Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

2.b.1. Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

3. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre:

3.a. Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit buxhetor aktual.

3.b. Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

3.b.1. Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjorbitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

3.c. Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

3.d. Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3.e. Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 1,178,768,204 lekë**, e cila përbëhet nga:

-71,367,454 lekë detyrime nga abonentët familjarë;

-1,074,888,444 lekë detyrime nga biznesi VIP;

-11,207,733 lekë detyrime nga biznesi i madh;

-8,985,573 lekë detyrime nga biznesi i vogël;

-12,319,000 lekë detyrime nga institucionet;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim-Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Tatim-Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mallakastër, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

4. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023:

4.a. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

4.b. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kunërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

4.c. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të rregjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

4.d. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grondeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

4.e. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

4.f. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë Mallakastër ndaj të tretëve, në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

4.g. Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit:

5.a. Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në hartimin e projekteve nga persona të palicesuar, në dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

6. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike:

6.a. Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **12,668,343 lekë pa Tvsh** nga kontraktori OE “C ” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

6.b. Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **884,140 lekë pa Tvsh** nga kontraktori OE “S ” Shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

6.c. AK Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **12,662,028 lekë pa Tvsh** nga Kontraktori BOE “A ” Shpk & “E ” Shpk & “K ” Shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

6.d. Nga organet drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të analizohet vlera **13,370,417 lekë** e cila ka të bëjë me mos evidentimin e të gjithë procesit mbi konsumin e karburantit, duke hartuar rregulla në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për

mjetet dhe pajisjet e institucionit si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

7. Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

7.a. Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHHTLP), Bashkia Mallakastër të marrë të gjitha masat për:

-Të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, në çdo rast të ruhen distancat nga objektet e tjera kufitare sipas përlllogaritjes së parashikuar në rregullore, me qëllim zhvillimin e kontrolluar të territorit.

-Në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla.

-Të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve, siç janë marrja në konsideratë e vetëm atij dokumentacioni që është nënshkruar elektronikisht nga hartuesi i tij, policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale duhet të jenë brenda afatit të mbulimit, rilevimi topografik duhet të jetë i plotësuar me të gjitha të dhënat e nevojshme, dokumentat e pronësisë së parcelave në zhvillim duhet të jenë të rifreskuara jo më shumë se 90 ditë në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, si dhe projekti ndërtimor duhet të paraqesë të gjithë elementë funksional dhe struktural të zbatimit.

-Të kërkohet në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

-Të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e këtyre lejeve, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Në çdo rast, DAZHHTLP duhet të kërkojë mendimin e ASHK-së, si në fazën e shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi, po ashtu edhe në atë të shqyrtimit të lejes së ndërtimit.

8. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe Njësisë Vendore:

8.a. Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër të marrë masa për:

-Të ndjekur me përpikmëri procedurat administrative dhe inspektuese, të parashikuar në legjislacion dhe rregullore, në lidhje me inspektimin, evidentimin, si dhe ndërmarrjen e masave administrative, për të gjithë kundërvajtësit e konstatuar në shkelje të dispozitave ligjore;

-Të nxjerrë vendimin e pezullimit të punimeve, në çdo rast që subjektet zhvilluese kanë nevojë për hapësirë kohore për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit justifikues të konstatimit të IMTV;

-Të nxjerrë vendimet e prishjes së objekteve të konstatuar në mospërputhje me ligjin, edhe nëse për këto çështje palët mund të jenë në procese gjyqësore;

-Të merren masa për të njoftuar rast pas rasti, autoritetet kompetente, në këtë rast IKMT, për të kërkuar asistencë prej tyre për prishjen e objekteve të kundërligjshme, në kushtet kur IMTV nuk është e pajisur me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të prishjes;

-Të merren masa për kryerjen e inspektimeve periodike për evidentimin e kundërvajtjeve, sipas përgjegjësiwe përkatëse dhe sipas planeve të punës, mujore dhe vjetore.

8.b. Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHHTLP), Bashkia Mallakastër të marrin masa për rritjen e bashkëveprimit ndërstrukturor me qëllim respektimin e dispozitave ligjore në lidhje me afatet e përfundimit të punimeve të objekteve me leje të miratuara. Nga ana e DAZHHTLP të merren masa për të informuar zyrtarisht IMTV për të gjitha rastet që miratohet dokumenti “Njoftim për Fillimin e Punimeve”, si dhe të merren masa nga IMTV për të inspektuar në mënyrë periodike respektimin e afatit të përfundimit të punimeve nga zhvilluesit e objekteve të miratuara.

9. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

9.a. Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

9.a.1. Nga Bashkia Mallakastër të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekoandimeve duke respektuar njëkohësitë edhe afatin e raportimit.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Mallakastër, KLSH ka dhënë **“Opinion të modifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare dhe **“Opinion të modifikuar”** për përputhshmërinë.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative, rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara, uljen e borxhit tatimor, rekomandime për shpërbllim dëmi dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2023:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë.

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimit shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të parashkruara në paragrafin e “Bazës për opinion me rezervë” pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Mallakastër më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 12,108 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 159,129,766 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 193,554,879 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 48,897,392 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,729,649 lekë.

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 1,192,034,397 lekë e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

-Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Gjithashtu për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” nuk është përlllogaritur normë amortizimi.

-Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 718,330,558 lekë kosto historike është përfshirë vlera 653,605,722 lekë si dhe në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 708,932,190 lekë kosto historike është përfshirë vlera 322,013,137 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se përpara vitit 2023 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 62,500,417 lekë në Shoqërinë U (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër.

-Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 34,640,004 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare U është 621,858,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër 34,640,004 lekë ose 5.49%. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare B është 2,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër është 500,000 lekë ose 25%. Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë.

-Llogaria 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale” përbëhet nga dy projekte Studim Projektim “Ndërtimi Ujësjiellësit të fshatrave të Njësia Administrative Aranitas” në vlerën 9,303,986 lekë dhe Studim Projektim “Ndërtim i Ujësjiellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë” në vlerën 10,546,668 lekë të përfunduara dhe të likuiduara dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

-Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 669,570,307 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie janë përfshirë 8 kontrata punimesh, mbikëqyrje dhe kolaudimi të përfunduara dhe të likuiduara në vlerën 171,116,853 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 669,570,307 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 689,116,975 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,489,713 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 698,822 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,330,767 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 734,579 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 10,729,649 lekë ku totali shkon në vlerën 20,983,530 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 28,708,429 lekë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 94,675,833 lekë, nga të cilat 39,937,791 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2022 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Mallakastër nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

-Në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk janë kontabilizuar detyrimet në vlerën 3,977,574 lekë e cila i përket detyrimeve mbi shpronësimet.

-Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,861,939,155 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 251,052,915 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,865,460 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 251,052,915 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 8,865,460 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 546,104,586 lekë.

b. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2022.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Pogradec, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar.**

Baza për opinion:

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Mallakastër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë realizuar fazat e përgatitjes së PBA-së për vitet 2023-2025;

-Gjendje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Mallakastër në fund të vitit 2023 është në vlerën 22,226,489 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta;

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, të kenë vlerën **1,192,034,397 lekë.**

-Në 6 raste janë vendosur kriteret të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

-Në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale **118,537,965 lekë.**

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve për 3 kontrata është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale **26,259,410 lekë** si pasojë e diferencave në realizimin e punimeve.

Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren:

-Në 1 rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj;

-Në 4 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe ka mangësi në dokumentacionin e nevojshëm; - Në 2 raste nuk është kërkuar/respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje lejet e ndërtimit.

-Nga auditimi i vendimeve të marra nga ana e IMTV, Bashkia Mallakastër konstatohet se në dy raste nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm; në dy raste të tjera nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve. Në asnjë rast (përveç konstatimit të shkeljes së afatit të punimeve) konstatimi i kundërvajtjes nuk është kryer nga ana e IMTV, por si indicie nga ana e Prokurorisë.

-Në asnjë rast IMTV nuk ka njoftuar dhe kërkuar asistencë nga IKMT për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, në kushtet e mungesës së mjeteve të përshtatshme për kthimin në gjendjen fillestare nga ana e Bashkisë Mallakastër.

-Në një rast, IMTV nuk ka kryer kontrole gjatë ndërtimit të objektit të pajisur me leje ndërtimi dhe/ose nuk ka evidentuar shmangiet nga projekti i miratuar. Në një rast tjetër, IMTV nuk ka evidentuar shkeljen e afatit të përfundimit të punimeve dhe nuk ka marrë masat ndëshkuese sipas rastit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 33/1 prot., datë 10.01.2024, i ndryshuar me shkresën nr. 33/2 prot., datë 13.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.01.2024, deri më 01.03.2024, në institucionin Bashkia Mallakastër u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M.H (Përgjegjës grupi)
2. K.H, anëtarë
3. A.V, anëtarë
4. P.XH, anëtarë
5. A.S, anëtarë

1. Objektivat e auditimit: Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Bashkinë Mallakastër kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit: Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Mallakastër është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

3. Identifikimi i çështjes: Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mallakastër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.,.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit: Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Mallakastër është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Mallakastër. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015. “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisë të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

- Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”.
- Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Etj.,.

7. Standardet e auditimit: Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Mallakastër grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkoen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,.

7. Intervistimi:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Libohovë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione:

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{1a} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Mallakastër.

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Mallakastër”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës (*materiale por jo të përhapura*), si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve, lejeve të ndërtimit, zbatimit të kontratave të punimeve etj.,.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe projekt raportin e auditimit të audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Mallakastrës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me Bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me Bashkinë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit.

Njësiti Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Ballsh	Qyteti Ballsh
Qëndër Dukas	Visokë, Belishovë, Belistan, Drenovë, Drenovë Fushë, Kash, Usojë, Ngraçie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas
Greshicë	Greshicë, Greshicë e Re
Aranitas	Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen
Hekal	Hekal, Klos, Mollaj, Rromës
Ngraçan	Ngraçan, Riban
Kutë	Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçëm
Fratar	Behaj, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh
Selitë	Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë

Njësiti Shpenzuese në varësi të Bashkisë Mallakastër:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Funksionet kryesore të Bashkisë Mallakastër kryhen në fushat:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Shërbimeve sociale;
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Mbrojtjes së mjedisit;
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike;
- Zhvillimit ekonomik vendor;
- Sigurisë publike.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë, kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

i. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

ii. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;

iii. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Referuar të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Mallakastër si dhe duke u bazuar në përgjigjet e pyetësorit, më poshtë paraqesim punën e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë pavarësisht përpekeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në mënyrë të detajuar argumentohen si më poshtë:

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike:

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejta, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësinë profesionale të punonjësve.

-Struktura organizative për Bashkinë Mallakastër është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 8, datë 29.12.2022, me objekt “Për miratimin e strukturës organike, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2023”.

-Nurmi i përgjithshëm prej **475 punonjës** është miratuar me VKB nr. 70, datë 19.12.2022, me objekt “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër”, si më poshtë:

- Aparati i Bashkisë Mallakastër + Çerdhet 121 punonjës;
- Arsimi + Zjarrëfikësen + Gjendjen Civile 129 punonjës;
- Njësia Administrative Fratar 49 punonjës;
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 176 punonjës.

Realizimi i strukturës organizative për vitin 2023 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative për vitin 2023 Bashkia Mallakastër				
Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	
1	Punonjës Aparati	98		82
2	Policia Bashkiake	12		10
3	M.N.Z	14		11

4	Bordi Kullues	3	2
5	Pyje e Kullota	4	1
6	Shërbime Publike	50	45
7	Kultura	10	9
A	Totali Administrata sipas Strukturës	191	160
	Funksione të Deleguara		
1	Arsimi Baze ne Organike	92	78
2	Arsimi Mesem	9	9
3	Gjendja Civile	7	7
B	Totali I Funksioneve të deleguara ne organic/mbi organik	108	94
	Totali A+B	299	254

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative për vitin 2023 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike			
Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt
1	Punonjës Aparati	10	8
2	Punonjës të rrjetit Rrugor	99	87
3	Punonjës të menaxhimit te mbetjeve	9	9
4	Punonjës të Shërbimeve Publike	58	53
	Totali	176	157

-Me Vendimin nr. 1, datë 18.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të institucionit.

-Kodi i Etikës është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 8, datë 18.10.2023, me objekt “Për miratimin e Kodit të Etikës të Bashkisë Mallakastër”.

-Nga Bashkia Mallakastër me Aktin nr. 3947/1 prot., datë 01.12.2021, është hartuar rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe konfidencialitetit dhe shkresën nr. 3947/2 prot., datë 01.12.2021, është hartuar rregullorja për hetimin administrativ dhe kërkesën e sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja. Si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm e përbërë nga dy punonjë, në lidhje me ndjekjen e procedurave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe atë të kodit të punës.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Protokollit të institucionit me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e te dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

-Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.

1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

-Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Nuk ka raporte për monitorimin periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga Ujësja e Mallakastër Sh.a si pjesë Shoqërisë Rajonale Ujësja e Kanalizime Fier, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit të administrimit për sa i përket aksioneve të saj, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Audit i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

-Nga Bashkia Mallakastër është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit. Për çdo drejtori janë përcaktuar objektivi, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjësi sektori dhe specialisti, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

-Nuk janë hartuar plane vjetore të miratuara nga titullari i institucionit për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektive vjetore.

1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Nëpunësit e Bashkisë Mallakastër i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Për ndjekjen e procedurave për sa i përket punonjësve që rregullojnë marrëdhëniet e punës me shërbimin civil, angazhohet strukturat si më poshtë:

Spektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit në zbatim të nenit 10, pika 1, e Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", Kreu II.

-Komiteti i Përhershëm i Pranimin në zbatim të përcaktimeve në Kreun II, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

-Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64, gërma "e", "ë", "f" dhe "g" e Ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".

-Nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Mallakastër në fillim të vitit është hartuar plani vjetor i pranimin të shërbimit civil, në përputhje me strukturën organizative të institucionit.

-Nga Bashkia Mallakastër nuk është hartuar harta e proceseve të punës.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bien në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

-Për sa i përket punonjësve që rregullojnë marrëdhëniet nëpërmjet kodit të punës konstatohet se, referuar Kreut III pika 3.1 Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, ku përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;

➤ Një sistem për vlerësimin e performancës;

-Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Mbi politikat dhe praktikën e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve si dhe ka një ndarje detyrash dhe përgjegjësisë deri në nivel përgjegjës sektori dhe specialisti.

1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Çdo titullar i njësive publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësive.

-Me Urdhrin nr. 126, datë 19.05.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

-Me Urdhrin nr. 127, datë 19.05.2023, të Kryetarit të Bashkisë janë ngritur Ekipe të Menaxhimit të programit në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, gërma "b", neni 24, pika 2.

-Nga GMS janë hartuar procesverbalet përkatëse për hartimin e planit strategjik në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për MFK i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

-Nga Bashkia Mallakastër nuk janë hartuar plane pune në lidhje me funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

-Nga GMS nuk administrohet procesverbalet në lidhje me dokumentimin e punës së tyre.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësive, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësive, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësive publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësive së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës konkretisht nëpunësit zbatues.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

3. AKTIVITETET E KONTROLLIT

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësive dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësive publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

-Për vitin 2023 Bashkia Mallakastër nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe

vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, hapi 5.

-Bashkia Mallakastër nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. MONITORIMI

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 6249/1 prot., datë 21.01.2023, nga Bashkia Mallakastër është hartuar dhe dërguar në MFE Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raporti Vjetor për Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, konkretisht:

➤ II. Vlerësimin e sisemit të MFK-së në të cilën përfshihet:

Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektiveve; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjja ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.

➤ III. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:

Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

➤ IV. Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:

Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përmbushjen e objektiveve dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.

➤ V. Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:

Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mëtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.

Me shkresë nr. 6249/2 prot., datë 21.02.2023, Bashkia Mallakastër ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

5. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Titullarët e njësisë publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

➤ Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

➤ Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

➤ Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

➤ Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

➤ Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësisë publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Mallakastër dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe **z. A.R** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB) në Bashkinë Mallakastër, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së NJAB të Bashkisë Mallakastër është bazuar në VKM nr. 212, datë 30.03.2012, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar.

Spektori i Auditimit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Urdhrit nr. 8, datë 29.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër përbëhet nga tre pozicione 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist si më poshtë:

Viti 2023							
Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Emëruar	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi
1	A.B	Përgjegjës sektori	05.11.2022	Financë	13	13	2010
2	XH.E	Specialist	01.07.2022	Administrim Biznesi	3	1	-
3	D.B	Specialist i jashtëm	02.11.2022	Financë	35	25	2005

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Mallakastër është miratuar me shkresën nr. 2025/3 prot., datë 14.09.2018, nga titullari i institucionit.

-Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Nga shqyrtimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Mallakastër, pika 1 e saj, "Objekti i kartës së auditimit të brendshëm" nuk është përditësuar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" e cila nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në DPHAB pranë MFE për vitet 2023-2025 me shkresën nr. 4677/2 prot., datë 19.10.2022.

-Në planin strategjik nuk është paraqitur volumi i punës që do të kryhet në 3 vitet e ardhshme (por është paraqitur për vitet 2022-2024) pra nuk është parashikuar veprimtaria që do të zhvillohet nga NJAB në vitin 2025, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2.

3. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 603/1 prot., datë 09.02.2024, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2023 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të Bashkisë Mallakastër janë mbajtur të plotësuara e të administruara në përputhjet me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullit VI, në to është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme, por në shumicën e tyre mungon Plani i Veprimit të subjekteve të audituara.

2.1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në Planin Vjetor për vitin 2023, për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB i cili është miratuar me shkresën nr. 189 prot., datë 13.01.2023, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

Nr.	Auditimet e planifikuara	Auditimet e realizuara
1	Drejtoria e Bujqësisë Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit	Drejtoria e Bujqësisë Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit
2	Njësia Administrative Fratar	Spektori i Tatim Taksave
3	Ujësijellës Sh.a Mallakastër	Njësia Administrative Fratar
4	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse	Spektori i Financës

Për sa trajtuar më sipër Ujësijellës Kanalizime Sh.a Mallakastër nuk është audituar për arsye se ka kaluar në administrimin e Shoqërisë Rajonale Ujësijellës Kanalizime Fier.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016.

-Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

-Nga Përgjegjësi i NjAB nuk është vepruar konform me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1, “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemi i Prokurimeve, Sistemi i Pagave, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit, ku sipas

përcaktimit të bërë në kapitullin nr. 3.1.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për të përcaktuar kohën për kryerjen e auditimeve merret në konsideratë niveli i riskut për çdo sistem. Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. A.B me detyrë Përgjegjës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Për hartimin e PBA-së për vitet 2023-2025 konstatohet se, për realizimin e fazave të përgatitjes kanë dalë urdhrat e titullarit të institucionit nr. 126, datë 19.05.2023, dhe nr. 127, datë 19.05.2023, “Për krijimin e GMS-në dhe EMP-në për hartimin e PBA-së për vitet 2023-2025”. Nga auditimi konstatohet se nuk janë realizuar fazat për përgatitjen e PBA-së për vitet 2023-2025 si më poshtë:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2022.

2. Me VKB nr. 44, datë 26.07.2022, janë miratuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së për vitet 2023-2025.

3. Me VKB nr. 58, datë 27.10.2022, është miratuar dokumenti për programin buxhetor afatmesëm të rishikuar për vitet 2023-2025, i cili përmban vetëm tavanet buxhetore.

4. Me VKB nr. 70, datë 19.12.2022, është miratuar Buxheti i vitit 2023 dhe Programi Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar për vitet 2023-2025, i Bashkisë Mallakastër brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 41, dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1302/1 prot., datë 27.12.2022.

5. Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit Prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.

6. Nga Sektorët e Bashkisë Mallakastër nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.

7. Nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2022, pranë MFE, Projektin dokumentin e PBA-së për vitet 2023-2025 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.

8. Nga Bashkia Mallakastër nuk janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

Mos hartimit i PBA-së për vitet 2023-2025 sjell mungesën e parashikimit të financimit të projekteve të investimeve për vitet në vazhdim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025” Paragrafi I “Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

Të dhënat për projekt buxhetin për vitin 2023 sipas tabelës në vijim:

Tabela B1: Projekt Buxheti i vitit 2023

000/Lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	163,646	263,247
601	Sigurime Shoqërore	27,169	43,962
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	37,894	195,253
604	Transferta Korente të Brendshme	3,762	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0
606	Transferta për Buxhetore Familjarë & Individ	0	8,673
609	Kontigjencat	4,000	14,453
I	Shpenzime Korrente	236,471	525,588
230	Kapitale të Patrupëzuara	25,795	0
231	Kapitale të Trupëzuara	224,938	294,849
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	250,733	294,849

230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0
II	Shpenzime Kapitale	250,733	294,849
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti	0	0
	I+II +III Totali i Shpenzimeve	487,204	820,437

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Për vitin 2023 buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 70, datë 19.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarkut Fier me shkresën nr. 1302/1 prot., datë 27.12.2022. Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën **394,650 mijë lekë**, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën **188,513 mijë lekë**, transfertat specifike ka vlerën **128,277 mijë lekë**, trashëgimi nga viti i kaluar e ndarë në transfertë e pakushtëzuar dhe transfertë specifike në vlerën **20,000 mijë lekë** dhe nga të ardhurat **89,000 mijë lekë**.

-Buxheti i Bashkisë Mallakastër është miratuar më datë 19.12.2023, në buxhet janë përfshirë fonde të trashëguara nga viti 2022 nga kapitulli 01 (të ardhurat e veta) dhe fonde të trashëguara nga viti 2022 kapitulli 05 (transfertë e pakushtëzuar dhe specifike). Përfshirja e fondeve të trashëguara në hartimin e buxhetit të ri pa u mbyllur viti buxhetor do të sjelli hartimin e një buxheti jo real për shkak të informacionit jo të saktë të fondeve të pa përdorura sepse viti buxhetor nuk është mbyllur.

Sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit Mallakastër fonde të trashëguara nga viti 2022 për vitin 2023 janë:

-Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike (kapitulli 01) në vlerën **81,928,318 lekë**;

-Të ardhura të veta (kapitulli 05) në vlerën **16,946,581 lekë**;

Në miratimin e buxhetit vjetor 2023 të ardhurat e trashëguara të pakushtëzuara janë paraqitur në vlerën 109,000,000 lekë e cila do të sjelli uljen e shpenzimeve kapitale ose operative për vitin 2023. Referuar buxhetit vjetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak Mallakastër me Vendimin nr. 70, datë 19.12.2022, të ardhurat së bashku me transfertat e pakushtëzuar, sektoriale dhe të kushtëzuara janë në vlerë 1,087,483,820 lekë dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,087,483,820 lekë. Buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Në hartimin e buxhetit vjetor Bashkia Mallakastër ka përfshirë edhe fondet e kushtëzuara në vlerën 267,046,820 mijë lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 104, përcaktohet që: “Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve që nuk janë transferuar ose deleguar tek njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk janë të ardhura vendore dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto fonde përdoren vetëm për financimin e funksionit të deleguar, projekte të veçanta dhe sipas llogarisë ekonomike për të cilin është dhënë ose sipas përcaktimeve të legjisllacionit apo marrëveshjes”.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale nga të ardhurat vendore për vitin 2023 është bërë si vijon:

-Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe transfertë e pakushtëzuar është në vlerën 294,849 mijë lekë.

-Totali i planifikimit të shpenzimeve kapitale për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 294,849 mijë lekë burimi i të ardhurave të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Tabela B2

000/Lekë

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave		Emërtimi i zërave	
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	394,650	600 Paga	263,247
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2022	17,646	601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	43,956
Total të ardhurat e veta	412,296	602 Shpenzime operative	195,253
Transfertë e pa kushtëzuar dhe specifike e trashëguar nga viti i mëparshëm 2022	81,928	604 Transferime korrente të brendshme	0
Transfertë e pakushtëzuar 2023	198,513	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	8,673
Transfertë specifike	128,278	230-231 Investime	294,849
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	408,719	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	14,458
Totali të Ardhurave	820,437	Totali Shpenzimeve	820,437

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të

krijua nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit të institucionit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2023 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

-Me VKB nr. 10, datë 21.02.2023, është miratuar buxheti shtesë në vlerën **4,711,425 lekë** për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022.

-Me VKB nr. 69, datë 21.02.2023, është miratuar rishpërndarja e fondeve buxhetore në vlerën **22,849,000 lekë**.

-Me VKB nr. 36, datë 24.07.2023, është miratuar buxheti shtesë për mbulimin e rritjes së kufirit minimal të pagave në vlerën **7,618,176 lekë**.

-Me VKB nr. 32, datë 27.06.2023, është miratuar buxheti shtesë për funksionet e deleguara duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën **5,021,918 lekë**.

-Me VKB nr. 41, datë 23.08.2023, është miratuar rishpërndarja e fondeve buxhetore, në vlerën **1,650,000 lekë**.

-Me VKB nr. 44, datë 28.09.2023, është miratuar rishpërndarja e fondeve buxhetore në vlerën **53,288,580 lekë**.

-Me VKB nr. 52, datë 30.10.2023, është miratuar buxheti shtesë, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën **10,000,000 lekë**.

-Me VKB nr. 55, datë 30.11.2023, është miratuar rishpërndarja e fondeve buxhetore në vlerën **36,000,000 lekë**.

-Me VKM nr. 834, datë 28.12.2023, është miratuar buxheti shtesë në vlerën **810,000 lekë**.

Në mënyrë të hollësishme në tabelën B3 në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqiten të dhënat mbi ndryshimet e buxhetit sipas periudhave përkatëse për vitin 2023.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mallakastër si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela B4

000/Lekë

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër dhe transfertën e pakushtëzuar							
Njësia	Bashkia Mallakastër+ Ndërmarrjet e vartësisë viti 2023						
Artikulli	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(3)-(4)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB nr. 70, datë 19.12.2022)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	163,646	263,247	276,372	250,896	25,476	90%
601	Sigurime Shoqërore	27,169	43,962	46,476	42,420	4,056	91%
600+601	Paga +Sigurime	190,815	307,209	322,848	293,316	29,532	90%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	37,894	195,253	223,802	88,265	135,537	39%
603	Subvencione	495	0	0	0	0	0%
604	Transferata Korente të Brendshme	3,267	0	0	0	0	0%
605	Transferata Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0%
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	0	8,673	8,673	4,511	4,162	52%
609	Kontigjencat	4,000	14,458	14,458	0	0	0%
602-609	Shpenzime operative	45,656	218,384	246,933	92,776	154,157	37%
Shpenzime Korrente		236,471	525,593	569,781	386,092	183,689	67%
230	Kapitale të Patrupëzuara	25,517	0	0	0	0	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	224,938	294,849	300,860	219,320	81,540	72%
Totali	Shpenzime Kapitale	250,455	294,849	300,860	219,320	81,540	72%
Totali (korrente + kapitale)		486,926	820,442	870,641	605,412	265,229	69%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar, Bashkia Mallakastër së bashku me njësitë vartëse (analizë e cila mat saktë performancën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, pasi nuk përfshihen fondet që vijnë nga transferata e kushtëzuar).

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 820,442 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 870,641 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 605,412 mijë lekë ose në masën 69%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 322,848 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 293,316 mijë lekë ose në masën 90%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 223,802 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,265 mijë lekë ose në masën 39%.

Zëri transferata buxhete familjare është planifikuar në vlerën 8,673 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,511 mijë lekë ose në masën 52%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 219,320 mijë lekë ose në masën 72%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe realizuar 219,320 mijë lekë ose në masën 71%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2023 ka vlerën 394,650 mijë lekë ndërsa realizimi ka vlerën 191,560 mijë lekë ose në masën 48%. Bashkia Mallakastër ka pasur të ardhura të trashëguara nga viti 2022 shumën 16,946,581 lekë.

Gjatë viti 2023 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Mallakastër është në vlerën 191,686 mijë lekë.

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si më poshtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 75,150 mijë lekë;
- Llogaria 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 13,173 mijë lekë;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 43,359 mijë lekë;
- Llogaria 606 (Transferta buxhete familjarë, individ) në shumën 1,763 mijë lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 58,238 mijë lekë.

Buxheti faktik i vitit 2023 është në vlerën 605,412 mijë lekë duke mos përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK. **Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Mallakastër me të ardhurat e veta mbulon 31.6% të buxhetit vjetor 2023.** Të dhënat e mësipërme për vitin 2023, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Në mënyrë të hollësishme **në tabelën B5** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit paraqiten të dhënat mbi realizimin e buxhetit sipas burimeve të financimit për vitin 2023.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile” i ndryshuar, të nenit 29 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vëndore”, të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondi i kontigjence parashikohet për herë të parë filluar nga viti 2017 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, ka filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Mallakastër në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar fondi i rezervë në vlerën 14,453,771 lekë, në masën 1.3% të buxhetit.

Me VKB nr.70, datë 19.12.2022, është miratuar për vitin 2023 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total si më poshtë:

- Fondi rezervë nga granti në vlerën 14,453 mijë lekë;
- Fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- Fondi kontigjencës nga granti në vlerën 0 lekë;
- Fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- Fondi i emergjencës civile nga granti në vlerën 19,123 lekë;
- Fondi i emergjencës civile nga të ardhurat në vlerën 0 lekë.

Planifikimi dhe përdorimi si në tabelën e mëposhtme:

Tabela B6

000/Lekë

Planifikimi dhe përdorimi		
Emërtimi	Plan 2023	Fakt 2023
Fond Rezervë dhe Fond Kontigjence	14,453	0
Fond Emergjence (Familjet e dëmtuara nga tërmeti)	19,123	9,020
Totali	33,576	9,020

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit:

Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Mallakastër nuk administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Gjithashtu nuk disponohet një korrespondencë shkresore me Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me raportim mujor apo vjetor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44, UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj..)

Bashkia Mallakastër më datë 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 10,419,769 lekë. Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2023 nuk është parashikuar asnjë fond për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 nuk është likuiduar vlera e detyrimeve të prapambetura 10,419,769 lekë, por janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 19,805,360 lekë si pasojë e humbjes së vendimeve gjyqësore dhe nga ky detyrim i ri i krijuar

është likuajduar vlera 7,998,640 lekë. Më datë 31.12.2023, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën 22,226,489 lekë. Detyrimet e Bashkisë Mallakastër vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive. Në këto kushte likuidimi i këtyre faturave nuk mund të kryhet.

Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura:

1. Shkresa nr. 2659 prot., datë 30.05.2023, raportimi i 4-mujor të parë dërguar në MFE. Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mallakastër janë raportuar në vlerën 10,419,769 lekë.

2. Shkresa nr. 4446 prot., datë 21.09.2023, raportimi i 4-mujor të dytë dërguar në MFE. Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mallakastër janë raportuar në vlerën 10,419,769 lekë.

3. Shkresa nr. 440 prot., datë 29.01.2024, raportimi i 4-mujor të tretë dërguar në MFE. Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Mallakastër janë raportuar në vlerën 10,419,769 lekë.

Detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2023, janë në vlerën 22,226,489 lekë në raportim nuk është përfshirë vendimi gjyqësor i datës 17.11.2022 me vlerë 16,806,720 lekë.

Në **tabelën B7** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2022.

Në **tabelën B8** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur faturat e pa likuiduara më datë 31.12.2023.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 60 si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore:

Gjatë vitit 2023 në Bashkinë Mallakastër janë protokolluar 3 vendime gjyqësore sipas tabelës në vijim të materialit. Vendime gjyqësore për dëmshpërblim pagë janë z. E.Ç me vlerë 2,679,640 lekë dhe znj. M.L me vlerë 319,000 lekë. Pagesa e këtyre shumave sipas vendimeve gjyqësore është likuiduar brenda vitit 2023.

Referuar Vendimit Gjyqësor nr. 309, datë 17.11.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë në Bashkinë Mallakastër është rregjistruar dëmshpërblimi për palët paditëse z. D.K , znj. J.K , znj. K.K dhe z. E.C për vlerën 16,806,720 lekë. Për vitin 2023 janë kryer pagesa në vlerën 5,000,000 lekë për vendimin gjyqësor.

Për vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit Vlorë më datë 06.03.2023, është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë. Rekursi është rregjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 15.11.2023.

Bashkia Mallakastër me shkresën nr.175 prot., datë 15.01.2024, ka bërë kërkesë për përshpejtim shqyrtim rekursi i çështjes civile nr. 11115-00642-00-23.

*Aktualisht ndodhemi në fazën e pritjes së shqyrtimit të rekursit nga ana e Gjykatës së Lartë. Lista analitike e detyrimeve për vendimet gjyqësore, paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Kreditori	Nr. Vendimit të gjykatës	Arsye pagesës	Vlera e detyrimit	Pagesat 2023	Vlera e mbetur
1	E.Ç	Nr.14261, datë 10.03.2023	Dëmshpërblim paga	2,679,640	2,679,640	0
2	Z. P Shpk	Nr. 309, datë 17.11.2022	Dëmshpërblim	16,806,720	5,000,000	11,806,720
3	M.L	Nr. 65, datë 01.02.2023	Dëmshpërblim paga	319,000	319,000	0
Totali				19,805,360	7,998,640	11,806,720

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 është shpenzuar vlera 7,998,640 lekë, nga e cila vlera 2,998,640 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 2 raste, ndërsa vlera 5,000,000 lekë për 1 rast i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore (dëmshpërblim për shpronësimet). Për sa trajtuar më sipër **vlera 7,998,640 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në

proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Ekonomike dhe Çështjeve Sociale për vitin 2023, në lidhje me investimet publike konstatohet se nuk ka financim projektsh nga FSHZH/FZHR. Nga Ministritë e Linjës/AKUM për vitin 2023, rezulton se janë financuar 2 projekte investimi ujësjellsash të cilat kanë filluar punimet në vitin 2020 dhe 2021 me vlerë kontrate 1,066,211,939 lekë të cilat janë në proces. Nga Ministria e Financës janë financuar 2 projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara me vlerë kontrate 54,015,497 lekë këto projekte kanë përfunduar dhe janë likuiduar brenda vitit 2023.

Fondet e deleguara për vitin 2023 nga Ministria e Linjës për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020 kanë vazhduar në vitin 2021 dhe sipas kontratave përfundojnë në vitin 2023 ose janë në proces gjatë vitit 2023 si dhe likuidimi i tyre, paraqiten në mënyrë të hollësishme si më poshtë në **tabelën B9** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe **z. A.R** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e aplikuar për vitin 2023 është miratuar me Vendimin nr. 8, datë 29.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër ku pjesë e saj përfshihet edhe Sektori i Tatim Taksave. Ky Sektor sipas strukturës së miratuar ka në përbërje të saj 5 punonjës konkretisht: 1 Përgjegjës Sektori dhe 4 specialist. Në **Pasqyrën 1** paraqiten mënyrë analitike të dhënat mbi punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Arsimi	Urdhri i emërimit
1	A.M	Përgjegjës Sektori	Kontabilitet Financë, Master Profesional	Datë 05.04.2018
2	A.XH	Specialist	Administrim Biznesi, Master Shkencor	Datë 23.04.2007
3	E.G	Specialist	Administrim Biznesi, Master Profesional	Datë 08.08.2016
4	L.D	Specialist	Master Shkencor Financë	Datë 23.01.2023
5	G.H	Specialist	E mesme ekonomik	Datë 11.01.2021

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Me VKB nr. 61, datë 24.11.2021, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Mallakastër për vitin 2023. Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Mallakastër parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Mallakastër për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Në **Pasqyrën 2** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023.

Nr.	Emërtimi	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
Të ardhura tatimore				
1	Taksë ndërtese	37,576,000	5,035,861	13%

Lekë

2	Taksë mbi tokën bujqësore	26,226,000	13,863,521	52%
3	Taksë trualli	48,412,000	23,988,583	49%
4	Taksë table	2,530,000	896,350	35%
5	Taksë ndikimi në infrastrukturë	13,080,000	2,454,264	18%
6	Tatim i thjeshtuar	-	84,760	-
7	Regjistrimi i automjeteve të përdorura	13,113,000	14,139,589	107%
8	Taksë nga renta minerale	8,119,000	1,665,695	20%
9	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	24,439,000	-	-
10	Tatim mbi TAP	3,442,000	10,660,495	309%
Shuma I		176,937,000	72,789,118	41%
Të ardhura jotatimore				
1	Tarifë pastrimi	17,809,000	8,868,719	49,7%
2	Tarifë për hapsirat publike	24,726,000	465,128	1.8%
3	Tarifë ndriçimi	6,449,000	1,766,520	27%
4	Tarifë gjelbërimi	16,325,000	15,557,089	95.2%
5	Tarifë për reklama	-	-	-
6	Tarifë parkimi	90,000	819,378	910%
7	Tarifë e shërbimit veterinar	574,000	-	-
8	Tarifa për shërbimeve të tjera administrative	3,735,000	2,364,695	63%
9	Tarifa për dhënie leje, liçenca dhe autorizime	1,824,000	3,107,926	170%
10	Tarifë ndotje mjedisi	122,446,000	59,136,080	48%
11	Të ardhura nga qira toke	2,295,000	1,360,396	59%
12	Të ardhura nga qira ndërtese	-	29,673	-
13	Të ardhura nga pagesat e kopësht dhe çerdhe	3,758,000	2,716,020	-
14	Të ardhurat nga gjobat	122,446,000	59,136,080	48%
15	Sekuestrime dhe zhdëmtime	-	49,245	-
16	Tarifa për shërbim komunitar	1,263,000	-	-
17	Tarifë për liçencat e prodhimit dhe tregtimit të naftës	6,195,000	-	-
18	Tarifë për linjat e komunikimit tokësor (telefon, energji, tv kabllor, internet)	5,680,000	-	-
19	Tarifë për përdorimin e zjarrëfikëses	183,000	69,000	37%
20	Qendra Komunitare	1,263,000	-	-
21	Të tjera	3,098,000	13,185,216	425%
Shuma II		217,713,000	118,771,403	54%
Totali		394,650,000	191,560,521	48%

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore është në vlerën **394,650,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **191,560,521 lekë** ose në masën **48%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **203,089,479 lekë**.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- “Regjistrimi i automjeti të përdorura” është planifikuar në vlerën 13,113,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,139,589 lekë ose realizuar në masën 107%.
- “Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 3,442,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,660,495 lekë ose realizuar në masën 309%.
- “Tarifë parkimi është planifikuar në vlerën 91,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 819,378 lekë ose realizuar në masën 910%.
- “Tarifë për dhënie leje, liçenca dhe autorizime është planifikuar në vlerën 1,824,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,107,926 lekë ose realizuar në masën 170%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- “Tarifë pastrimi” është planifikuar në vlerën 17,809,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,868,719 lekë ose realizuar në masën 49%.
- “Tarifë ndriçimi” është planifikuar në vlerën 6,449,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,766,520 lekë ose realizuar në masën 27 %.
- “Tarifë ndriçimi” është planifikuar në vlerën 18,641,600 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,388,905 lekë ose realizuar në masën 53%.
- “Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 37,576,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,035,861 lekë ose realizuar në masën 13%.
- “Taksë trualli” është planifikuar në vlerën 48,412,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 23,988,583 lekë ose realizuar në masën 49%.
- “Taksë toke” është planifikuar në vlerën 26,226,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,863,521 lekë ose realizuar në masën 52%.

- g. “Taksë tabelle” është planifikuar në vlerën 2,530,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 896,350 lekë ose realizuar në masën 35%.
- h. “Taksë ndotje mjedisi” është planifikuar në vlerën 122,446,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 59,136,080 lekë ose realizuar në masën 48%.
- i. “Taksa për hapsirat publike” është planifikuar në vlerën 24,726,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 465,128 lekë ose realizuar në masën 1.8%.
- j. “Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 13,080,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,454,264 lekë ose realizuar në masën 18%.
- k. “Taksa e kalimit të pronësisë” është planifikuar në vlerën 24,439,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga Sektori i Tatim Taksave nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo sektor nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Mallakastër që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Mallakastër në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mallakastër.

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 1, datë 18.05.2020, në nenin 40, pika 4 “Detyrat e Përgjegjës të Sektorit” përcaktohet që: “Përgjegjësi i Sektorit të Tatim-Taksave është personi përgjegjës për kryerjen e akt rakordimeve me strukturat përkatëse të Bashkisë dhe agjentëve tatimor, të cilat i paraqet më pas për miratim tek drejtori”. Vetëm për ndjekjen e arkëtimeve për kategorinë abonentë familjarë dhe rakordimeve me Agjentin Tatimor, Shoqërinë Rajonale U është lidhur Akt-marrëveshja me nr. 2552 prot., datë 25.05.2023.

Referuar akt-rakordimit me nr. 3079/1 prot., datë 20.06.2023, i mbajtur midis Sektorit të Tatim-Taksave dhe Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Mallakastër fonde të cilat janë pa u dherdhur në llogarinë e

Thesarit të Bashkisë Mallakastër nga UKM Sh.a janë në vlerën 22,766,787 lekë deri më datë 31.12.2022.

Për vitin 2023 nuk janë mbajtur akt-rakordime midis Bashkisë Mallakastër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier.

Sektori i Tatim Taksave ka dërguar faturat e arkëtimit Shoqërisë Rajonale U si më poshtë:

1. Faturë arkëtimi datë 12.09.2023, për muajt Janar-Gusht 2023 shuma e arkëtuar 839,163 lekë.

2. Faturë arkëtimi datë 18.10.2023, për muajin Shtator 2023 shuma e arkëtuar 1,036,686 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 85,504 lekë.

Shkresa nr. 4902 prot., datë 18.10.2023, me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

3. Faturë arkëtimi datë 23.11.2023, për muajin Tetor 2023 shuma e arkëtuar 1,372,813 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 40,961 lekë.

Shkresa nr. 585 prot., datë 23.11.2023, me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

4. Faturë arkëtimi datë 13.12.2023, për muajin Nëntor 2023 shuma e arkëtuar 1,332,465 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 82,904 lekë.

Shkresa nr. 6099 prot., datë 13.12.2023, me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

5. Faturë arkëtimi datë 19.01.2024, për muajin Dhjetor 2023 shuma e arkëtuar 1,603,817 lekë dhe nga detyrime të prapambetura është arkëtuar vlera 12,911 lekë.

Shkresa nr. 265 prot., datë 19.01.2023, me objekt njoftim për shlyerje të detyrimit tatimor.

Bashkia Mallakastër referuar Ligjit nr. 112/2016, datë 03.11.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 47 "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave" citohet se: "Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:

a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike".

-Akt-rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier janë mbajtur vetëm për periudhën Janar-Qershor 2023, akt-rakordimet janë të pafirmosura nga personat përgjegjës nga Bashkia Mallakastër dhe DRFF. Për muajt Korrik-Dhjetor 2023 nuk janë mbajtur akt-rakordime.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorinë e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

-DRSHTRR Fier në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mallakastër. Gjithashtu konstatohet se sipas Sektorit të Tatim Taksave, mos arkëtimet nga ana e Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Mallakastër janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës për të cilat nga Bashkisë Mallakastër është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse.

-Për sa më sipër Bashkia Mallakastër duhet të fillojë procedurën për të gjobitur Agjentin Tatimorë ASHK në zbatim të dispozitës ligjore të mësipërme.

-Bashkia Mallakastër ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

Në **Pasqyrën Aneks 3** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agjentët tatimorë për vitin 2023.

Lekë			
Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Realizimi 2023
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT Fier)	0	84,760
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Fier)	3,442,000	
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	13,113,000	14,139,589

4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	24,439,000	0
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	8,119,000	1,665,695
Totali		49,113,000	15,890,044

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave.

Bizneset, regjistrimin dhe mbajtja e të dhënave:

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Mallakastër kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim-Taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon rregjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Mallakastër i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim-Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim-Taksave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Në Pasqyrën Aneksi nr. 7. Rregjistri i biznesit Bashkia Mallakastër.

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivitet	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2023	366	16	0	382
2	Biznesi Madh	2023	63	3	0	66
3	Institucione	2023	19	0	0	19
Totali			455	20	0	467

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Abonentët familjarë dhe privat:

Bashkia Mallakastër nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për abonentët privatë dhe familjarë.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Sektori i Tatim-Taksave për abonentët familjarë dhe abonentët privatë paraqiten si më poshtë:

Detyrimet e familjarëve:

Bashkia Mallakastër ka lidhur Akt-Marrëveshje me nr. 2552 prot., datë 25.05.2023, me Shoqërinë Rajonale U me objekt kontrate mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve familjarë (taksë ndërtesë, tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi publik).

Sipas informacionit të përcjellë nga Sektori i Tatim-Taksave rregjistri elektronik në të cilin disponohet databaza e abonentëve familjarë përbehet nga 2,221 abonentë vetëm qyteti Ballsh.

Sipas nenit 6 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 1 Bashkia Mallakastër ka detyrimin të depozitohet pranë agjentit tatimor listën e plotë të kryefamiljarëve, së bashku me nivelin e taksave dhe tarifave vendore sipas llojit të tyre, pika 2 ka detyrim për të paraqitur në fund të çdo muaj pranë agjentit tatimor, ndryshimet që do të pësojë lista.

Bashkia Mallakastër ka vepruar në kundërshtim me Akt-Marrëveshjen nr. 2552 prot., datë 25.05.2023, neni 6 sepse Sektori i Tatim Taksave nuk përcjell listat e azhornuara tek agjenti tatimor çdo muaj por informacioni për ndryshimet e databazës e merr nga vetë agjenti tatimor.

Në **Pasqyrën Aneks 4**, në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësive administrative për taksat dhe tarifatat vendore të vitit ushtrimor 2023 të cilat **janë në shumën 67,560,061 lekë**.

Në **Pasqyrën Aneks 4** gjendet informacion për detyrimet e abonentëve familjarë në njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër dhe qytetin e Ballshit vetëm për taksën bujqësore, taksën e truallit dhe taksën e ndërtesës.

Njësitë Administrative nga Sektori i Tatim-Taksave nuk ju faturohet detyrimi sipas paketës fiskale për tarifatat vendore të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Debitorët familjarë për qytetin e Ballshit për vitin 2023 nuk janë rakorduar me Shoqërinë U dhe për vitin 2023 nuk kemi informacioni për debitorët e krijuar gjatë vitin 2023 por vetëm vlerën e mbartur nga viti i mëparshëm.

Debitorët familjarë për qytetin e Ballshit në datë 31.12.2022 **janë në shumën 3,807,393 lekë**.

Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023, vlera debitore është në shumën **71,367,454 lekë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mallakastër** nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri më datë 31.12.2023.

Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar.

Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifatat vendore për abonentët private:

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në **vlerën 1,107,401,700 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër**. Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet në **Pasqyrën Aneksi nr. 7** si vijon:

Lekë

Nr.	Loji i bizneseve	Detyrimet		
		Viti 2023		
		Numri i subjekteve	Detyrime 31.12.2022	Detyrime 31.12.2023
1	Biznes i vogël	123	7,795,253	8,985,573
2	Biznes VIP	7	1,082,847,829	1,074,888,444
3	Biznes i madh	30	10,272,504	11,207,733
4	Institucione	4	13,900,309	12,319,950
Totali		164	1,114,815,925	1,107,401,700

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Sa më sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Mallakastër, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshime. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”. neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e

vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.,.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore abonentët familjar dhe privat:

Sipas VKB nr. 61, datë 24.11.2022, për miratimin e paketës fiskale për Bashkinë Mallakastër është përcaktuar si mëposhtë për tarifat për familje:

Nr.	Njësia Administrative	Lloji i tarifës në lekë/familje/vit		
		Tarifë pastrimi	Tarifë gjelbërimi	Tarifë ndriçimi
1	Njësia Administrative Ballsh	2,000 lekë/vit	500 lekë/vit	1,000 lekë/vit
2	Njësiti e tjera	1,000 lekë/vit	250 lekë/vit	500 lekë/vit

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Për abonentët e qytetit Ballsh është përcaktuar Agjent Tatimor “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier” e cila i tarifon abonentët sipas paketës fiskale në faturën mujore të ujit.

Nga informacioni i përcjell nga Sektori i Tatim-Taksave nga 2,221 familje në njësinë Ballsh tarifohen vetëm 1,363 abonentë familjarë. Abonentët familjarë të përjashtuar nga tarifat sipas paketës fiskale i përkasin kategorive të kryefamiljarëve të parashikuara në paketën fiskale.

Për Njësitë e tjera Administrative sipas paketës fiskale janë përcaktuara nivelet e tarifave për abonentët familjarë sipas tabelës së mësipërme. Sipas regjistrave për njësitë administrative numri i familjeve të njësive administrative është 7,248 familje të cilat nuk janë tarifuar për vlerën 7,248,000 lekë për tarifën e pastrimit për të cilën ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër. Tarifa e gjelbërimit dhe e ndriçimit nuk ofrohet si shërbim nga Bashkia Mallakastër dhe abonentët nuk janë tarifuar për këto shërbime.

Nga Sektori i Tatim Taksave nuk janë tarifuar tarifat për Njësitë Administrative referuar **Pasqyrës Aneks 5** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur numri i familjeve të patarifuar për tarifën e pastrimit në **vlerën 7,248,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.**

Sipas VKB nr. 61, datë 24.11.2022, është miratuar paketa fiskale e Bashkisë Mallakastër ku janë përcaktuar taksat dhe tarifat për abonentët privatë.

Nga Sektori i Tatim-Taksave nuk janë tarifuar bizneset e mëdha të cilat kanë si adresë ushtrimi aktiviteti në njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër referuar **Pasqyrës Aneks 6** në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur bizneset e patarifuar për tarifën e pastrimit në vlerën **770,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.**

Sektori i Tatim Taksave ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Kreun IV, neni 4, pika 7, neni 20, nenet 20-24, Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Paketën Fiskale të Bashkisë Mallakastër viti 2023, neni 12, pika 1.

Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është 9,385,810 lekë për 307 persona. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 426,844 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 38,864 lekë si dhe është krijuar detyrim për këtë taksë në vlerën 387,980 lekë për 12 persona. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në **vlerën 9,773,789 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.**

Në **Pasqyrën Aneksi nr. 10** paraqiten të dhëna për taksën e infrastrukturës për vitin 2023:

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2023		Arkëtuar deri 31.12.2023		Debitorë me 31.12.2023	
	Persona	Lekë	Person	Lekë	Person	Lekë
Taksë infrastrukture (legalizim)	320	9,812,653	1	38,864	319	9,773,789

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Mallakastër për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Rajonale Fier, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve:

➤ Kontrata për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, por janë aktive 4 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2023 kanë qenë aktive 4 kontrata me sipërfaqe totale 1,020 m² me vlerë kontrate 729,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2023 OE “O ” Sh.a **nuk ka shlyer detyrimin për kontratat në shumën 571,750 lekë.**

Kontrata nr. 199 prot., datë 26.12.2001, midis Bashkisë Mallakastër dhe V Sh.a nuk është më në fuqi sepse në bazë të certifikatës së pronësisë me numër 1456523, datë 08.01.2021, objekti i kontratës së qirasë nuk është më në pronësinë dhe administrimin e Bashkisë Mallakastër por nën administrimin e Ministrisë së Brendshme. Analiza e detajuar mbi subjektet të cilët kanë nënshkruar kontratë për dhënien me qira të hapësirave për vendosjen e antenave me Bashkinë Mallakastër si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitin 2023, paraqiten në **Pasqyrën Aneksin nr. 10**, në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër ka lidhur 31 kontratë të reja për dhënien me qira të kullotave dimërore dhe verore për bagëtitë me vlerë kontrate 178,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2023 janë shlyer të gjitha detyrimet. Analiza e detajuar mbi personat të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje kullotat dimërore dhe verore për bagëtitë me Bashkinë Mallakastër si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitin 2023, paraqiten në **Pasqyrën Aneksin nr. 11**, në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit..

➤ Qira për tokën bujqësore.

Bashkia Mallakastër administron 210 kontrata qiraje për tokën bujqësore në Njësitë Administrative Hekal, Qëndër, Aranitas, Selitë, Kutë dhe Fratar, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2013 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, konkretisht 7,000 lekë/ha në vit.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Mallakastër nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithësej 1,368,387 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se **në fund të vitit 2023 janë debitor 127 subjekte në vlerën 2,432,960 lekë.** Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

Analiza e detajuar mbi subjektet të cilët kanë nënshkruar kontratë për dhënien me qira të hapësirave për tokë bujqësore me Bashkinë Mallakastër si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitin 2023, paraqiten në **Pasqyrën Aneksin nr. 11**, në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Sektori i Tatim-Taksave ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi paisjen me licensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejjimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Sektori i Tatim-Taksave konstatohet se në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Në territorin e Bashkisë Mallakastër janë të regjistruara 9 biznese në aktivitet në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 9 subjekte janë pajisur me autorizim 6 subjekte, të cilët kanë paguar vlerën e plotë të licencës dhe janë pajisur me autorizim me afat 5 vjeçar. Më poshtë gjendet lista e subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre.

Në **Pasqyrën Aneksi nr. 13** paraqiten: Kontratat e Subjekteve që tregtojnë hidrokarbure:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Detyrimi për vitin 2023
			Fillimi	Mbarimi			
1	“N” Shpk	J...C	24.07.2019	23.07.2024	1,000,000	1,000,000	0
2	“L” Shpk	J...C	07.10.2021	06.10.2026	1,000,000	1,000,000	0
3	“N” Shpk	J...C	07.03.2023	07.03.2028	1,000,000	1,000,000	0
4	“K” Shpk	J...P	15.08.2019	14.08.2024	1,000,000	1,000,000	0
5	“E” shpk	J...O			1,000,000	-	0
6	“SH” Shpk	K...W	10.07.2023	09.07.2028	1,000,000	1,000,000	0
7	“B” Shpk	K...D			1,000,000	-	0
8	“B” Shpk	K...N			1,000,000	-	0
9	“O” Shpk	J...K	21.04.2022	20.04.2027	1,000,000	1,000,000	0
Totali					9,000,000	6,000,000	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Mallakastër të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga Sektorit të Tatim Taksave dhe Policisë Bashkiake. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1, germa b, përcaktohet se “Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, ...”.

Mangësitë e mësipërme janë një risk potencial në ushtrimin e aktivitetit nga subjekte të cilat nuk plotësojnë kriteret përkatëse dhe kushtet teknike, si dhe mungesë e mundësisë së ushtrimit e kontrolleve të herëpashershme nga strukturat përgjegjëse. Shkaku konsiderohet se janë mangësitë në marrjen e masave shteruese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për të gjitha subjektet që nuk zotërojnë licencën e tregtimit deri në aplikimin e tyre për licencën përkatëse dhe përfitimin e saj.

Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore, kullosore dhe improduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Mallakastër për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje referuar dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Tatim-Taksave. Në territorin e Bashkisë Mallakastër ushtrojnë aktivitetet 2 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Këto subjekte janë:

1. Subjekti “F” Shpk me Nipt L...D, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1829, datë 29.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Drizari, Hekal për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.144 km² ose 14.4 ha

2. Subjekti "C Shpk me Nipt L...A, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1868, datë 08.04.2019, për shfrytëzimin e vendburimit Povel Grashicë për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.033 km² ose 3.3 ha.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, i Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin kullor", pikat 3, 7, 9, 10, 11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1816 prot., datë 18.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. A.M , z. A.XH , z. E.G , z. G.H , znj. L.D në cilësinë e përgjegjësit dhe specialistëve të Sektorit të Tatim-Taksave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Detyrimet familjare.

Përsa i përket detyrimeve familjare për qytetin e Ballshit dhe për të gjitha njësitë Administrative ne disponojmë rregjistra elektronik dhe rriegjistra fizik të cilat i protokollojmë në zyrën e protokollit pranë Bashkisë në çdo fillim vit dhe në çdo fundvit për arsye të përpunimit dhe njoftimit të çdo familje debitore dhe jo debitore, në çdo njoftim familjarë ka numër protokollit të veçantë sipas regjistrit të protokolluar pranë Bashkisë. Rakordimi i fundvitit 2023 me UKF për arsye objektive nuk është kryer por në një kohë shumë të shkurtër do të kryhet siç është kryer edhe vitet e kaluara.

-Bazuar në paketën fiskale me nr. 61, datë 24.11.2022, si dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 35, dhe Ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 17 i tij, këto tarifa do të aplikohen në njësit dhe nënndarjet e tyre ku ofrohen shërbimet nga Bashkia Mallakastër.

-Nga aktrakordimet që një kopje ju është paraqitur edhe juve është pasqyruar vlera e debisë e pambledhur nga ana e agjentit tatimor në total si dhe shuma e arkëtuar por e pa kaluar në llogarinë e Bashkisë e cila rezulton debi shifra 22,766,787 të cilën ju e cilësoni si të ardhur e munguar është e deklaruar në regjistrat tanë si debi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Sektori i Tatim-Taksave i cili citon se, Bashkia Mallakastër disponon rregjistër fizik për abonentët familjarë, grupit të auditimit gjatë fazës së auditimit në terren në periudhën nga data 15.01.2024, deri më 16.02.2024, nuk i është vendosur në dispozicion gjithashtu edhe me observacionin e dërguar nuk i është vendosur në dispozicion grupi të auditimit. Referuar procedurës së pastrimit të Bashkisë Mallakastër përgjatë vitit 2023, ky shërbim ofrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Mallakastër. Abonentët privatë dhe familjarë duhet të tarifohen për shërbimet e përfituara nga Bashkia Mallakastër. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Pretendimi i subjektit: Nga auditimi i kryer, përsa i përket borxhit të biznesit në shumën 1,107,401,700 lekë ne si sektor kemi kryer njoftimit dhe letër kujtesa përkatëse për të gjithë debitorët, më herët kemi bërë dhe urdhër bllokimi të llogarive bankare.

Nga vlera e mësipërme e borxhit të biznesit 87.5% i përket biznesit vip të hidrokarbureve nga të cilat Armo dhe Allum Enterprises janë subjekte të mbyllura.

Sektori i Tatim Taksave vazhdimisht ka kryer urdhër bllokime dhe vendosje të barrës hipotekore për taksapaguesit në shuma të konsiderueshme ndaj Bashkisë Mallakastër.

Më poshtë gjenden shkresat e drejtuara institucioneve përkatëse nga Bashkia Mallakastër.

-Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore drejtuar zyrës së rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier me nr. 1218 prot., datë 18.05.2018.

-Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore drejtuar zyrës së rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë me nr. 1217 prot., datë 18.05.2018.

-Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore drejtuar zyrës së rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës me nr. 1219 prot., datë 18.05.2018.

-Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore drejtuar zyrës së rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Mallakastër me nr. 1220 prot., datë 18.05.2018.

-Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore drejtuar zyrës së rregjistrimit të pasurive të paluajtshme Vlorë me nr. 1216 prot., datë 18.05.2018.

Urdhër bllokimi nr. 2027 prot., datë 24.11.2017.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e mësipërm të paraqitur nga Sektori i Tatim-Taksave për masat e marra ndaj subjekteve debitore të biznesit vip është paraqitur dokumentacion justifikues për masat e marra ndaj këtyre subjekteve janë paraqitur njoftimet për vendosjen e barrës hipotekore.

Sektori i Tatim-Taksave duhet të mbajë në konsideratë për çdo subjekt debitor duhet të ndjeki në mënyrë rigoroze afatet e njoftimit dhe të ndjeki të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore. Për bizneset e tjera debitorë nuk është paraqitur dokumentacion justifikues për procedurat e ndjekura nga sektori i Tatim-Taksave për mbledhjen e detyrimeve. Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Konkluzioni mbi situatën e borxhit tatimor dhe kontratave për dhënien me qira të aseteve:

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore dhe ato të kontratave janë debitorë abonentët familjar, biznes i madh dhe i vogël etj., në vlerën **1,194,647,691 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, kemi ulje të debitorëve në shumën **2,613,294 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, janë në vlerën **1,192,034,397 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Mallakastër** si më poshtë:

Lekë

Lloji i taksës dhe tarifës	Deri më 31.12.2022	01.01.2023-31.12.2023	Progresive
Detyrimet nga abonentët familjarë	64,904,730	6,462,724	71,367,454
Biznesi i madh dhe biznesi i vogël	1,114,815,895	(6,927,451)	1,107,888,444
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	9,385,809	387,980	9,773,789
Dhënia e tokave bujqësore me qira	5,541,257	(2,536,547)	3,004,710
Totali	1,194,647,691	(2,613,294)	1,192,034,397

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **z. Q.I** Kryetar i Bashkisë Mallakastër, **z. A.M** me detyrë Përgjegjës Sektori i Tatim-Taksave, **z. A.XH**, **z. E.G**, **z. G.H**, **znj. L.D** me detyrë specialist pranë Sektorit të Tatim-Taksave, **z. M.M** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve dhe **z. L.SH** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve dhe Mjedisit.

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 16.02.2024)

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Mallakastër për vitin 2023 (të cilat përfshijnë pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2023 të Bashkisë Mallakastër dhe ato të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike) janë të nënshkruara nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Mallakastër me shkresën nr. 745 prot., datë 19.02.2024, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Mallakastër për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike.

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilët kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimin, asgjësimin, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjet dhe fletë-daljet etj.,.

a. Auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Mallakastër:

Për vitin 2023 Kryetari i Bashkisë Mallakastër z. Q.I për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 371, datë 18.12.2023, për krijimin e komisioneve të inventarizimit si më poshtë:

-Për inventarizimin e aktiveve të Shkollës së Mesme D. Hekali, Shkollës I. Klosi, Kash, Beslidhja dhe 5 Shkurti është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. K.H kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A.SH , znj. M.Q .

-Për inventarizimin e aktiveve të Kopshtit nr. 1, dhe nr. 2, Çerdhes dhe Qendrës Kulturore të Fëmijëve është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. A.V kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M.SH , znj. E.S .

-Për inventarizimin e aktiveve të Zjarrëfikëses, Sektorit të Kulturës, Klubit Sportiv dhe QKSHF-së është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. E.G kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S.K , znj. B.P .

-Për inventarizimin e aktiveve të Zyrove të Bashkisë Mallakastër dhe Policisë Bashkiake është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. M.LL kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. H., z. A. M.

-Për inventarizimin e aktiveve të Zyrove të ish-Njësisë Administrative Kutë si dhe Shkollat Ninesh, Çorush, Drizar, Bejar është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. G.A kryetar i komisionit dhe anëtarët z. N.N , z. L.S .

-Për inventarizimin e aktiveve të Njësisë Administrative Fratar, Shkollës 8 vjeçare, Shkollës së Mesme Fratar, Kopshti Kapaj është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. D.K kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A.M , znj. B.L .

-Për inventarizimin e aktiveve të Shkollës + Kopshteve Drenovë, Lapulec, Visokë, Belishovë i përbërë nga z. A.XH është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. A.XH kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M.M , znj. XH.A .

-Për inventarizimin e aktiveve të Shkollave + Kopshteve Aranitas (Gjerbes), Metoh, Panahor, Ngracan, Zyrat e ish-Njësisë Administrative Aranitas, Ngracan është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. N.S kryetar i komisionit dhe anëtarët z. N.K , z. L.Z .

-Për inventarizimin e aktiveve të Shkollave + Kopshteve si dhe Zyrat e ish-Njësisë Administrative Hekal, Greshic është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. E.M kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M.SH , znj. E.L .

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, germa "c".

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. K.H , znj. A.SH , znj. M.Q , znj. A.V, znj. M.SH , znj. E.S, z. E.G , znj. S.K , znj. B.P , znj. M.LL, znj. A.H, z. A.M, z. G.A, z. N.N , z. L.S , z. D.K, znj. A.M , znj. B.L , z. A.XH , znj. M.M , znj. XH.A , z. N.S, z. N.K , z. L.Z , znj. E.M, znj. M.SH , znj. E.L në cilësinë e anëtarëve të komisioneve të inventarizimit.

Me Urdhrin nr. 263, datë 21.09.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit i përbërë nga znj. M.SH kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. L.D , z. H.L .

Me shkresën nr. 4449/1 prot., datë 14.12.2023, nga komisioni i vlerësimit është hartuar relacioni mbi vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mjeteve dhe materialeve të inventarit për vitin 2022. Në këtë relacion nga komisioni i vlerësimit janë evidentuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit që i përkasin **llogarisë 327 "Inventar i imët" në vlerën 3,110,070 lekë dhe llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 2,428,362 lekë.**

Nga auditimi konstatohet se, procesi i vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit është kryer jashtë afateve të parashikuara në Urdhrin nr. 263, datë 21.09.2023, pika 2, ku përcaktohet që: “Afati i përdorimit të procedurës së vlerësimit të jetë data 21.10.2023”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.SH , znj. L.D , z. H.L në cilësinë e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me Urdhrin nr. 301, datë 25.10.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara për dalje për jashtë përdorimit i përbërë nga znj. S.K kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. B.P , z. H.L , znj. L.D , z. E.Y .

Nga auditimi konstatohet se, nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit **nuk është mbajtur një procesverbal mbi asgjesimin e aktiveve sipas listës të përkatuar në relacionin me shkresën nr. 4449/1 prot., datë 14.12.2023**, nga komisioni i vlerësimit. Në këtë praktikë ndodhen vetëm fletë-hyrjet dhe fletë-daljet nga magazina e institucionit që i përkasin sasisë së skrapit dhe drurit për zjarrë të depozituar pranë magazinës së Bashkisë Mallakastër. Sasia prej 11.5 m³ dru zjarri është depozituar sipas fletë-dalje përkatëse në disa prej shkollave të qarkut Mallakastër, që do të shërbejnë për ngrohejn e ambienteve të brendshme të këtyre institucioneve. Në mënyrë analitike të dhënat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Fletë-hyrje		Objekti	Njësia e matjes		Gjendje në magazinë
	Nr.	Data		Kg/M ³		
1	24/1	01.12.2023	Hekur për skrap	786 Kg		
			Dru për zjarr	11.5 M ³		
Nr.	Fletë-dalje		Objekti	Njësia e matjes		Institucionet përfituese
	Nr.	Data		M ³		
1	542	01.12.2023	Dru për zjarr	1		Shkolla Lapulec
2	543	01.12.2023	Dru për zjarr	2		Shkolla Çorush
3	544	01.12.2023	Dru për zjarr	0.5		Shkolla Ismail Klosi
4	545	01.12.2023	Dru për zjarr	1		Shkolla Bejar
5	546	01.12.2023	Dru për zjarr	5		Shkolla Dervish Hekal
6	547	01.12.2023	Dru për zjarr	2		Shkolla Visokë
Totali				11.5		

Nuk disponohet një dokumentacion mbi ndarjen e vlerës së materialeve si tavolina, karrige etj., që janë klasifikuar në skrap dhe dru zjarri me qëllim nxjerrjen e vlerës tjetër të mbetur për asgjesim. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, dat 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. S.K , znj. B.P , z. H.L , znj. L.D , z. E.Y në cilësinë e komisionit për nxjerrjen e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se është nxjerrë jashtë përdorimit **vlera totale 4,702,409 lekë** për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,110,070 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,592,339 lekë. **Nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë kontabilitetit është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbalin e asgjesimit të aktiveve)**. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Mbi bazën e kërkesës së paraqitur pranë titullarit të institucionit nga znj. M.M ka nisur procesi për asgjesimin e letrave me vlerë në vlerën 1,517,730 lekë për arsye se janë të papërshtatshme për t’u përdorur për shkak të vlerës që kanë dhe formatit. Lista e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit për letrat me vlerë paraqitet si më poshtë:

Lekë							
Nr.	Emërtimi	Institucioni	Subjekti	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Bileta kalçeto	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	9,731	100	973,100
2	Bileta parkimi	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	1,550	10	15,500
3	Bileta parkimi	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	2,541	20	50,820
4	Bileta parkimi	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	2,142	30	64,260
5	Bileta therje bagëti gjedhi	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	2,500	100	250,000

6	Bileta therje bagëti gjedhi	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	700	200	140,000
7	Bileta therje bagëti të imta	Bashkia Mallakastër	Arka e Bashkisë	Fije	481	50	24,050
Totali							1,517,730

Me Urdhrin nr. 343, datë 22.11.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara për dalje për jashtë përdorimit (për letrat me vlerë) i përbërë nga znj. M.LL kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M.M , znj. E.A.

Nga auditimi konstatohet se, nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit **nuk është mbajtur një procesverbal mbi asgjësimin e letrave me vlerë në vlerën 1,517,730 lekë.**

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.LL , znj. M.M , znj. E.A në cilësinë e komisionit për nxjerrjen e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet se është kryer pakësim vlera 1,517,730 lekë në llogarinë 532 “Vlera të tjera”. **Nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë kontabilitetit është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbalin e asgjësimin të letrave me vlerë).** Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues.

b. Auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër:

Për vitin 2022 (proces inventarizimi i cili është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2023), Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. B.V për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 69, datë 06.12.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit i përbërë nga znj. N.O kryetar i komisionit dhe anëtarët z. E.Y , znj. E.T, z. K.S , z. B.Y .

Me shkresën nr. 186/1 prot., datë 20.01.2023, nga komisioni i inventarizimit është hartuar raporti për inventarin fizik së bashku me procesverbalin përmbledhës drejtuar titullarit të institucionit.

Me Urdhrin nr. 23, datë 10.05.2023, të z. B.V Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit i përbërë nga znj. V.Z kryetar i komisionit dhe anëtarët z. P.G , z. F.B , z. XH.K , z. Q.M.

Në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur nga komisioni i vlerësimit është mbajtur procesverbali i datës 16.05.2023, janë evidentuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit që i përkasin **llogarisë 327 “Inventar i imët” në vlerën 1,423,891 lekë dhe llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 52,000 lekë.**

Me Urdhrin nr. 28, datë 19.06.2023, të z. B.V Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike ka ngritur komisionin për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit i përbërë nga znj. N.O kryetar i komisionit dhe anëtarët z. K.S , z. B.Y .

Nga komisioni i asgjësimin më datë 26.06.2023, është mbajtur procesverbali i verifikimit të materialeve për nxjerrje jashtë përdorimit si dhe më datë 19.07.2023, është mbajtur procesverbali i grumbullimit të materialeve, ku është kryer ndarja nga materialet e konsumit dhe ato të hekurit. Me fletë-hyrjen nr. 21, datë 19.07.2023, në magazinën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike janë bërë hyrje 90 kg hekur.

Nga auditimi konstatohet se, nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit **nuk është mbajtur një procesverbal mbi asgjësimin e aktiveve sipas listës të përkatuar në procesverbalin e datës 16.05.2023,** nga komisioni i vlerësimit.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. N.O , z. K.S , z. B.Y në cilësinë e komisionit për nxjerrjen e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se është nxjerrë jashtë përdorimit **vlera totale 1,475,891 lekë** për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 1,423,891

lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 52,000 lekë. **Nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë kontabilitetit është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbalin e asgjesimit të aktiveve).** Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. N.O me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për vitin 2023, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. F.SH për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit ka nxjerrë Urdhrin nr. 52, datë 18.12.2023, për krijimin e komisionit të inventarizimit i përbërë nga znj. N.O kryetar i komisionit dhe anëtarët z. XH.K , z. F.B , z. K.S , z. B.Y . Deri më datë 01.03.2024, është realizuar faza e inventarizimit të aktiveve.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto		2,475,097,827
Aktivet		2,670,565,816
Pasivet		195,467,989
Aktivet Neto		2,475,097,827

		Lekë
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2023		363,030,563
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		193,795,779
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		68,409,352
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		100,825,432

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

				Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	193,554,879	159,129,766	34,425,113
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	240,900	2,516,730	(2,275,830)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		193,795,779	161,646,496	32,149,283

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 159,129,766 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 193,554,879 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 48,897,392 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,729,649 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 133,927,838 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 49-50.

-Llogaria 532 “Vlera të tjera” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,516,730 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 240,900 lekë. Përgjatë vitit 2023 është bërë dalje nga magazina vlera 2,275,830 lekë e cila përbëhet nga nxjerrja jashtë përdorimit e letrave me vlerë në vlerën 1,517,730 lekë dhe biletat e tregut në vlerën 758,100 lekë të përdorura në vitin 2023. Vlera e mbetur gjendje më datë 31.12.2023, prej 240,900 lekë i përket biletave të tregut gjendje në magazinë.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	28,874,065	23,004,063	5,870,002
32	Inventar i imët	39,535,287	36,539,829	2,995,458
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		68,409,352	59,543,892	8,865,460

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 68,409,352 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 28,874,065 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 39,535,287 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 8,865,460 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 8,865,460 lekë.

-Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 28,874,065 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2023		23,004,063
Shtesa (K)		46,138,278
Pakësime (D)		40,268,276
Gjendja në 31.12.2023		28,874,065

-Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 39,535,287 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2023		36,539,829
Shtesa (K)		4,754,297
Pakësime (D)		1,758,839
Gjendja në 31.12.2023		39,535,287

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	61,697,234	61,111,859	585,375
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	28,708,429	32,821,633	(4,113,204)
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		90,405,663	93,933,492	(3,527,829)
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	10,419,769	10,422,499	(2,730)
Totali		10,419,769	10,422,499	(2,730)

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 61,111,859 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 61,697,234 lekë me një rritje në vlerën 58,375 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 1, Aneksi nr. 3,** të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llekë	
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2023	66,571,862
Shtesa (K)	552,099
Pakësime (D)	66,831
Gjendja debitore në 31.12.2023	66,670,236

Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk është përfshirë vlera 1,192,034,397 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Sektorit të Tatim Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur për debitorët nga taksat dhe tarifave vendore të pa kontabilizuara në bilanc paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Llekë			
Lloji i taksës dhe tarifës	Deri më 31.12.2022	01.01.2023-31.12.2023	Progresive
Detyrimet nga abonentët familjarë	64,904,730	6,462,724	71,367,454
Biznesi i madh dhe biznesi i vogël	1,114,815,895	(6,927,451)	1,107,888,444
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	9,385,809	387,980	9,773,789
Dhënia e tokave bujqësore me qira	5,541,257	(2,536,547)	3,004,710
Totali	1,194,647,691	(2,613,294)	1,192,034,397

Si dhe në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërpartit llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila Kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 7.

-Gjendja e llogarisë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)" më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 32,821,633 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 28,708,429 lekë me një pakësim në vlerën 4,113,204 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llekë	
Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2023	32,821,633
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	4,113,204
Gjendja debitore në 31.12.2023	28,708,429

-Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 10,422,499 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,419,769 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm".

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 2, Aneksi nr. 3**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llekë	
Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"	
Çelje e vitit 2023	10,422,499
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2023	10,419,769

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	II. Aktive Afatgjata	2,307,535,253	1,799,875,763	507,659,490
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	80,104,551	60,557,883	19,546,668
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	80,104,551	60,557,883	19,546,668
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	1,538,313,727	1,499,671,729	38,641,998
210	Toka, Troje, Terene	309,970	309,970	0
211	Pyje, Plantacione	8,560,400	8,560,400	0
212	Ndërtesa e konstruksione	685,535,268	718,330,558	(32,795,290)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	793,898,423	708,932,190	84,966,233
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	15,646,910	19,315,337	(3,668,427)
215	Mjete transporti	24,303,742	30,379,678	(6,075,936)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	10,059,014	13,843,596	(3,784,582)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	689,116,975	239,646,151	449,470,824
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	19,546,668	25,795,965	(6,249,297)
231	Për Aktive Afatgjata materiale	669,570,307	213,850,186	455,720,121

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 60,557,883 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 19,546,668 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 80,104,551 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		60,557,883
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		60,557,883
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		19,546,668
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	8	Kosto historike		80,104,551
	9	Amortizim i akumuluar		0
	10	Gjendja më datë 31.12.2023		80,104,551

Lekë

Studime-Projektme (kosto historike)		Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari					
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës Hekal-Klos-rruga nacionale Levan Tepelenë”.		2,655,100	0	0	2,655,100
Hartim Projekti: “Rikualifikimi urban i bllokut nga zyra Arsimore Mallakstër deri në fund të rrugës “Nikaia” në Lagjen 5 Shkurti Ballsh”.		2,187,494	0	0	2,187,494
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës Ballsh (Rruga Gjok Doci)-Drenovë e Re”.		1,283,400	0	0	1,283,400
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës Damës-Kremenar”.		1,645,056	0	0	1,645,056
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës ruga nacionale Levan Tepelene-Ninesh-Gadurovë”.		1,283,400	0	0	1,283,400
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës Aranitas-Gjerbës”.		1,760,400	0	0	1,760,400
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës së vjetër (nacionale) fshati Visokë”.		1,454,400	0	0	1,454,400
Hartim Projekti: “Rikonstruksion i rrugës Bejar-Kutë, Çorrush”.		3,548,582	0	0	3,548,582
Hartim Projekti: “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Ballsh”.		4,253,742	0	0	4,253,742
Hartim Projekti: “Krijim hapsire rekrative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh”.		1,762,344	0	0	1,762,344
Studim Projektim: “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit”.		5,040,000	0	0	5,040,000

Studime-Projekte (kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari				
Studim Projektim i sistemit te furnizimit me uje nga burimi i Pocemit per qytetin e Ballshit	7,888,000	0	0	7,888,000
Projektim: "Ndërtim i shkollës "Gjok Doci" Fratar".	3,603,252	0	0	3,603,252
Projektim: "Rikualifikim i zonës urbane, kryqëzim-rruge kryesore-ish Agjensi-Komisariat".	2,600,404	0	0	2,600,404
Projektim: "Ndërtim KUZ në qytetin e Ballshit".	4,397,299	0	0	4,397,299
Projektim: "Rikonstruksion dhe termoizolim i 10 pallateve në qytetin e Ballshit".	833,987	0	0	833,987
Projektim: "Ndërtim i shkollës "Gjok Doci" Fratar".	1,883,120	0	0	1,883,120
Projektim: "Rikonstruksion i rruges Aranitas Cfir Metoh	2,563,939	0	0	2,563,939
Studim Projektim: "Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit".	13,517,216	0	0	13,517,216
Studim Projektim: "Ndërtimi i Ujësjetës të fshatrave të Njësisë Administrative Aranitas".	0	9,303,986	0	9,303,986
Studim Projektim "Ndërtim i Ujësjetës të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë".	0	10,242,684	0	10,242,684
Totali	60,557,883	19,546,668	0	80,104,551

Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" është përfshirë projekti me objekt "Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit" në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Gjithashtu për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime" nuk është përlllogaritur normë amortizimi.

Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" i përmirësuar, pikat 66-69, VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Seksioni II "Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar" pika 1/b "Klasifikimi kontabël" e cila ndër të tjera përcakton se: "Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202" "Studime dhe Kërkime", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" pika 2, klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël), pika 5 dhe gërma "d", pika 36, "Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogarit me metodën lineare me normë amortizimit 15%".

2. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 309,970 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 309,970 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		309,970
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		309,970
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	8	Kosto historike		309,970
	9	Amortizim i akumuluar		0
	10	Gjendja më datë 31.12.2023		309,970

-Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,560,400 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	8,560,400
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2023	8,560,400
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	8,560,400
	9	Amortizim i akumuluar	0
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	8,560,400

-Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 718,330,558 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,121,320 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 343,194,004 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 685,535,268 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 3, Aneksi nr. 3**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,025,607,952
	2	Amortizim i akumuluar	307,277,394
	3	Gjendja në 01.01.2023	718,330,558
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	3,121,320
	5	Amortizim i shtesës	35,916,610
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	1,028,729,272
	9	Amortizim i akumuluar	343,194,004
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	685,535,268

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 708,932,190 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 226,752,671 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,576,533,247 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 793,898,423 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 4, Aneksi nr. 3**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,143,678,999
	2	Amortizim i akumuluar	1,434,746,809
	3	Gjendja në 01.01.2022	708,932,190
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	226,752,671
	5	Amortizim i shtesës	141,786,438
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	2,370,431,670
	9	Amortizim i akumuluar	1,576,533,247
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	793,898,423

a. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 718,330,558 lekë kosto historike është përfshirë vlera 653,605,722 lekë për 146 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

b. Në gjendjen e llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në vlerën 708,932,190 lekë kosto historike është përfshirë vlera 322,013,137 lekë për 143 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë

09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.

c. Nga auditimi i llogarisë 213 “**Rrugë rrjete vepra ujore**” konstatohet se përpara vitit 2023 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 62,500,417 lekë në Shoqërinë U (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Fier), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër. Në lidhje me këtë situatë nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Mallakastër dhe Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Mallakastër. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Mallakastër për Shoqërinë U për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari				
Ujësjetellësi Kutës	115,939	0	0	92,751
Ujësjetellësi 5 fshatrave Fratar	682,837	0	0	546,270
Rikonstrukcion rrjeti i Ujësjetellësit Ballsh	2,692,344	0	0	2,153,875
Ujësjetellësi Rromës	112,189	0	0	89,751
Rrejti i brendshëm i fshatrave Fratar	4,062,398	0	0	3,249,918
Ndërtim KUZ Lagja B Ballsh	30,156,029	0	0	24,124,823
Ndërtim Ujësjetellësi Rajonal Mallakastër	40,303,786	0	0	32,243,029
Totali	62,500,417	0	0	62,500,417

-**Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 19,266,137 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 234,000 amortizim të akumuluar në vlerën 45,854,460 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,646,910 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	61,267,370
	2	Amortizim i akumuluar	42,001,233
	3	Gjendja në 01.01.2023	19,266,137
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	234,000
	5	Amortizim i shtesës	3,853,227
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	61,501,370
	9	Amortizim i akumuluar	45,854,460
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	15,646,910

-**Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 30,379,678 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por amortizim të akumuluar në vlerën 79,246,689 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 24,303,742 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	103,550,431
	2	Amortizim i akumuluar	73,170,753
	3	Gjendja në 01.01.2023	30,379,678
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	6,075,936
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	103,550,431
	9	Amortizim i akumuluar	79,246,689
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	24,303,742

-**Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 13,892,796 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,398,256 lekë, pakësim në vlerën

1,758,839 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 51,394,206 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,059,014 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	61,813,803
	2	Amortizim i akumuluar	47,921,007
	3	Gjendja në 01.01.2022	13,892,796
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	1,398,256
	5	Amortizim i shtesës	3,473,199
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	1,758,839
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	8	Kosto historike	61,453,220
	9	Amortizim i akumuluar	51,394,206
	10	Gjendja më datë 31.12.2023	10,059,014

-Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 34,640,004 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare U me Nipt K...N është 621,858,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale U me Nipt M...G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër 34,640,004 lekë ose 5.49% ($5.49 \times 621,858,000 / 100 = 34,640,004$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare B me Nipt L...Q është 2,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër është 500,000 lekë ose 25% ($25 \times 2,000,000 / 100 = 500,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

4. Invenstimet

-Llogaria 230 "Për aktivet afatgjata jo materiale" më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 25,795,965 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 19,546,668 lekë dhe pakësim në vlerën 25,795,965 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 230 "Për aktivet afatgjata jo materiale"	
Gjendje në 01.01.2023	25,795,965
Shtesa (K)	19,546,668
Pakësime (D)	25,795,965
Gjendja në 31.12.2023	19,546,668

Lekë				
Për aktivet afatgjata jo materiale (kosto historike) Objekte inventari	Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendja
	01.01.2023	(D)	(K)	31.12.2023
Projektim "Rikualifikim i zonës urbane kryqëzim-rruge kryesore-ish-Agjiens-Komisiariat".	2,600,404	0	2,600,404	0
Projektim "Ndërtim KUZ në qytetin e Ballshit".	4,397,299	0	4,397,299	0
Projektim "Rikonstruksion dhe termoizolim i 10 palateve në qytetin e Ballshit".	833,987	0	833,987	0
Projektim "Ndërtim i shkollës "Gjok Doci" Fratar".	1,883,120	0	1,883,120	0
Projektim "Rikonstruksion i rrugës Aranitas C'fir Metoh".	2,563,939	0	2,563,939	0
Studim Projektim "Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit".	13,517,216	0	13,517,216	0
Studim Projektim "Ndërtimi Ujësllësit të fshtarave të Njësia Administrative Aranitas".	9,303,986	9,303,986	0	9,303,986
Studim Projektim "Ndërtim i Ujësllësit të fshtarave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë".	10,242,684	10,242,684	0	10,242,684
Totali	25,795,965	19,546,668	25,795,965	19,546,668

Kjo llogari përbëhet nga dy projekte Studim Projektim "Ndërtimi Ujësllësit të fshtarave të Njësia Administrative Aranitas" në vlerën 9,303,986 lekë dhe Studim Projektim "Ndërtim i Ujësllësit të fshtarave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë" në vlerën 10,546,668 lekë të përfunduara dhe të likuiduara dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 202 "Studime dhe kërkime".

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23.

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 213,850,186 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 669,570,307 lekë dhe pakësim në vlerën 213,850,186 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 669,570,307 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2023	213,850,186
Shtesa (K)	669,570,307
Pakësime (D)	213,850,186
Gjendja në 31.12.2023	669,570,307

Lekë				
Për aktive Afatgjata materiale (kosto historike)	Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendja
Objekte inventari	01.01.2023	(D)	(K)	31.12.2023
Rikonstruksion i rrugës Bejar-Diga e Rezervuarit	32,251,740	0	32,251,740	0
Rikonstruksion i rrugës Gani Malasi Ballsh	2,197,476	0	2,197,476	0
Mbikqyrje punimesh “Rikonstruksion i rrugës Gani Malasi Ballsh”.	48,851	0	48,851	0
Rikonstruksion i pjesshëm i zyrave të Njësise Administrative Fratar	3,423,089	0	3,423,089	0
Mbikqyrje “Rikonstruksion i pjesshëm i zyrave të Njësise Administrative Fratar”.	95,066	0	95,066	0
Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara	29,039,543	0	29,039,543	0
Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh	19,000,000	0	19,000,000	0
Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm Ujësjellësi Rajonal (Nga burimi i Poçemit).	51,382,285	0	51,382,285	0
Mbikqyrje “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”.	817,000	0	817,000	0
Mbikqyrje “Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm Ujësjellësi Rajonal (Nga burimi i Poçemit).	50,000	0	50,000	0
Rikonstruksion i rrugës Diga e rezervuarit-Anbreg-Kutë-Çorrush	54,116,492	0	54,116,492	0
Rikonstruksion i rrugëve ne fshatrat Dukas, Visokë, Greshic, Mollaj	19,026,422	0	19,026,422	0
Kontribut i Bashkise Mallakastër me 24% të vlerës për projektin: “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara”.	2,248,419	0	2,248,419	0
Mbikqyrje “Ndërtim shetitore nga Shkolla O deri te varrezat e qytetit”.	153,802	0	153,802	0
Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj	0	103,715,491	0	103,715,491
Rikonstruksion i rrugës Diga e Rezervuarit-Anbreg-Kutë-Çorrush	0	49,894,266	0	49,894,266
Mbikqyrje punimesh rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anbreg-Kutë-Çorrush”.	0	654,827	0	654,827
Rikonstruksion i rrugëve Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti Qendër Rromës-Lagja Tabakaj), rruga Fratar-Drizar dhe rruga Ninesh-Nenaj-Dames)	0	24,041,107	0	24,041,107
Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngracan (segmenti Panahor-Subashaj) dhe rruga Ballsh-Drenovë e re (Segmenti Depo e ujit-Shkolla)	0	17,100,000	0	17,100,000
Mbikqyrje punimesh në objektin: “Rikonstruksion i rrugëve Visokë-Dukas-Greshic-Mollaj”.	0	742,263	0	742,263
Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara	0	3,535,656	0	3,535,656
Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh	0	189,812,347	0	189,812,347
Supervizion punimesh në objektin “Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh”.	0	1,000,000	0	1,000,000
Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm Ujësjellësi Rajonal (Nga burimi i Poçemit).	0	266,000,000	0	266,000,000
Supervizion punimesh ne objektin “Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm Ujësjellësi Rajonal (Nga burimi i Poçemit).	0	500,000	0	500,000
Supervizion punimesh për objektin: “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara viti 2021”.z	0	378,385	0	378,385
Kolaudim punimesh për objektin “Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara viti 2021”.	0	41,052	0	41,052
Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pafavorizuara viti 2022	0	12,154,913	0	12,154,913
Totali	213,850,186	669,570,307	213,850,186	669,570,307

-Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 669,570,307 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie janë përfshirë 8 kontrata punimesh, mbikëqyrje dhe kolaudimi të përfunduara dhe të likuiduara në vlerën 171,116,853 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018,

“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 669,570,307 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 689,116,975 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”.

Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Mallakastër, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Mallakastër i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrija e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Mallakastër. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Mallakastër duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Mallakastër dhe Njësi Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Mallakastër. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Mallakastër, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Mallakastër disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Mallakastër ka në pronësi në total **1,652 pasuri** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

➤ **Njësia Administrative Ballsh:**

-Me VKM nr. 161, datë 27.02.2013, “Për miratimin e listave së inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Ballsh”, janë transferuar gjithsej **274 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Kutë:**

-Me VKM nr. 758, datë 02.11.2011, “Për miratimin e listave paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore për Njësinë Administrative Kutë”, janë transferuar **169 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Qendër:**

-Me VKM nr. 71, datë 02.02.2011, “Për miratimin e listave së inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Qendër”, janë transferuar **277 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Hekal:**

-Me VKM nr. 244, datë 27.02.2008, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Hekal”, janë transferuar **207 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Ngraçan:**

-Me VKM nr. 33, datë 24.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për Njësinë Administrative Ngraçan”, janë transferuar **33 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Selitë:**

-Me VKM nr. 706, datë 19.10.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Selitë”, janë transferuar **203 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Aranitas:**

-Me VKM nr. 474, datë 18.07.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Aranitas”, janë transferuar **175 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Greshicë:**

-Me VKM nr. 93, datë 31.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Greshicë”, janë transferuar **78 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

➤ **Njësia Administrative Fratar:**

-Me VKM nr. 31, datë 24.01.2007, “Për miratimin e listave së inventarit paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore për njësinë Administrative Greshicë”, janë transferuar **263 pasuri** nga të cilat **nuk është pajisur asnjë pasuri me çertifikatë pronësie.**

Shënim: Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave ka kaluar në mënyrë përfundimtare me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”.

c. Në total në pronësi të Bashkisë Mallakastër janë **1,652 pasuri** të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura **për të cilat asnjë pasuri nuk është pajisur me çertifikatë pronësie.**

d. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Mallakastër **të cilat janë të evidentuara në kontabilitet asnjë prej tyre nuk posedon titull pronësie.** Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Mallakastër më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Lekë				
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	3,489,713	8,788,953	(5,299,240)
42	Detyrime ndaj personelit	18,144,668	17,138,680	1,005,988
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	698,822	785,135	(86,313)
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	5,330,767	5,089,164	241,603
436	Sigurime shëndetësore	734,579	700,621	33,958
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	94,675,833	60,250,720	34,425,113
467	Kreditorë të ndryshëm	10,729,649	10,738,948	(9,299)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	61,663,958	61,111,859	552,099
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		195,467,989	164,604,080	30,863,909

-Në myllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,489,713 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 698,822 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,330,767 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 734,579 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 10,729,649 lekë ku totali shkon në vlerën 20,983,530 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 28,708,429 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1.

-**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2023, është në vlerën 8,788,953 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Mallakastër. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 5,229,240 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,489,713 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2023	8,788,953
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	5,229,240
Gjendja debitore në 31.12.2023	3,489,713

Lekë			
Nr.	Objekti	Operatori ekonomik	Vlera
1	Diesel për mjetet e transportit	N Shpk	1,348,020
2	Benzinë për mjetet korrese dhe prerese	N Shpk	36,600
3	Mirëmbajtje e mjeteve të transportit	F Shpk	.1,397,364
4	Kopshti Ballsh	Individ	466,835
5	Çerdhe Ballsh	Individ	240,894
Totali			3,489,713

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 18,144,668 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2023		17,138,680
Shtesa (K)		1,005,988
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2023		18,144,668

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, konstatohet se:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
4	15.01.2024		3,204,098
5	15.01.2024		2,600,503
6	15.01.2024		1,233,292
7	15.01.2024		378,858
8	15.01.2024		43,924
9	15.01.2024		1,736,489
10	15.01.2024		2,314,267
11	15.01.2024		177,535
12	15.01.2024		189,888
13	15.01.2024		189,893
1	12.01.2024		2,818,217
2	12.01.2024		2,543,576
3	12.01.2024		714,128
Totali			18,144,668

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 698,822 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”		Lekë
Çelje e vitit 2023		785,135
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		86,313
Gjendja debitore në 31.12.2023		698,822

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
1	15.01.2024		640,459
6	12.01.2024		58,363
Totali			698,822

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Shënim: Pakësimi në llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimit të kufijëve të pagave që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat nga punësimi sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Gjithashtu ka ndikuar edhe largimi apo punësimi i punonjëse të rinj.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 5,330,767 lekë dhe 734,579 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2023		5,089,164
Shtesa (K)		241,603
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2023		5,330,767
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”		
Çelje e vitit 2023		700,621
Shtesa (K)		33,958
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2023		734,579

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	15.01.2024	2,031,737
2	15.01.2024	2,154,535
4	12.01.2024	1,068,826
6	12.01.2024	376,693
Totali		5,330,767
1	15.01.2024	248.214
3	15.01.2024	244.179
5	12.01.2024	12.1093
6	12.01.2024	121.093
Totali		734,579

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Shënim: Shtesat për llogarinë 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogarinë 435 “Sigurime shëndetësore” shëndetësore kanë ardhur si efekt i rritjes së nivelit të pagave dhe nga punësimet e reja dhe largimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2023.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 94,675,833 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2023	60,250,720
Shtesa (K)	35,074,718
Pakësime (D)	0
Gjendja debitoare në 31.12.2023	94,675,833

Për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Mallakastër janë ngurtësuar fonde në vlerën 39,937,791 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Mallakastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 39,937,791 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2023, janë në vlerën 10,738,849 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 9,200 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,729,649 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2023	10,738,849
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	9,200
Gjendja kreditore në 31.12.2023	10,729,649

Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk janë kontabilizuar detyrimet në vlerën 3,977,574 lekë e cila i përket detyrimeve mbi shpronësimet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, funksionimi kontabël i llogarive të Klasës 4. Kjo problematikë është kontaktuar edhe në auditimin e mëparshëm nga KLSH por nga Drejtoria e Financës dhe çështjeve Sociale nuk janë marrë masat e duhura për kontabilizimin e këtij detyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, si më poshtë:

			Lekë
Nr.	Pronari	Vlera e mbetur e palikujduar deri në 31.12.2023	
1	I.H	449,920	
2	V.M	1,337,106	
3	V.M	1,581,750	
4	V.M	608,798	
Totali			3,977,574

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 61,663,958 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë
Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”		
Çelje e vitit 2023		61,111,859
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		552,099
Gjendja debitore në 31.12.2023		61,663,958

-Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,861,939,155 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 251,052,915 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,865,460 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 251,052,915 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 8,865,460 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 546,104,586 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)			
D	FONDI I KONSOLIDUAR			
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar		2,426,200,435	1,861,939,115
12	Rezultatet e mbartura		0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore		48,897,392	98,879,046
111	Rezerva		0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve		0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime		0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme		0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja		0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim		0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata		0	0
	Të tjera		0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)		2,670,565,816	2,125,422,142

					Lekë
Fondi i konoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”				
2,475,097,827	Mbyllje më datë 31.12.2023		Çelje më datë 01.01.2023		
	Debi		Kredi		
			1,861,939,115	Çelja gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” i datës 31.12.2023	
	1,758,839	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	251,052,915	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.	
	191,105,410	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	8,865,460	Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”	
Totali	192,864,249		2,121,857,490		
2,121,857,490-192,864,249 = 1,928,993,241					
2,475,097,827-1,928,993,241=546,104,586					

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 115,130,384 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 123,634,761 lekë ose

me një rritje në vlerën 8,504,377 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	123,634,761	115,130,384
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	84,760	94,265
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	84,760	94,265
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	18,899,382	18,953,614
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	18,899,382	18,953,614
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	104,650,619	96,082,505
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	104,650,619	96,082,505
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksat mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksat kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 29,942,367 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 41,459,981 lekë ose me rritje në vlerën 11,517,614 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	41,459,981	29,942,367
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	14,173,480	1,991,125
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	14,173,480	1,991,125
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	27,286,501	27,951,242
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	9,640,519	16,337,343
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	8,320,419	9,243,939
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	0	0
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatë vonesa, sekuestre dhe zhdëmtime	9,325,563	2,369,960
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 676,123,007 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 657,943,343 lekë ose me një pakësim në vlerën 18,179,664 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	657,943,343	676,123,007
720	1. Grant korent i brendshëm	657,943,343	676,123,007
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	226,797,136	241,083,796
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	370,319,572	365,970,361
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	26,465,779	8,374,973
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	28,000,700	32,147,180
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	6,360,156	28,546,697
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0

721	2. Grant korent i huaj	0	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

4. Të ardhura të tjera:

-Llogaria “Të ardhura të tjera”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 111,224,923 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 16,946,581 lekë ose me një pakësim në vlerën 94,278,342 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	VI. TË ARDHURA TË TJERA	16,946,581	111,224,923
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi	0	0
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra	0	0
783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata	0	1,170,080
784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve ardhshme	0	0
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	16,946,581	110,054,843

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 237,793,669 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 259,235,879 lekë ose me një rritje në vlerën 21,442,198 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 39,474,131 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 43,282,335 lekë ose me një rritje në vlerën 3,808,204 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	259,235,879	237,793,699
602	Paga personel i përkohshëm	0	0
603	Shpërblime	0	0
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	41,356,645	38,221,445
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	1,925,690	1,252,686
	Totali	302,518,214	277,267,830

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 108,335,476 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 88,533,205 lekë ose me një pakësim në vlerën 19,802,271 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Mallakastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	88,533,205	108,335,476
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,775,464	2,526,763
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6,944,029	5,603,886
6022	Shërbime nga të tretë	17,473,323	16,430,734
6023	Shpenzime transporti	27,037,306	29,311,846
6024	Shpenzime udhëtimi	743,956	803,646
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	12,451,847	37,051,976
6026	Shpenzime për qiramarrje	272,000	233,750
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	4,998,640	83,240
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	15,836,640	16,289,635

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Mallakastër nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 393,645,699 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 254,228,848 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	V. TRANSFERIME KORENTE	393,645,699	419,391,632
604	1. Transferita korente të brendshme	139,416,851	174,997,486
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	0	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	133,504,957	171,730,402
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	5,911,894	3,267,084
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	254,228,848	244,394,146
6060	Transferita të paguara nga ISSH e ISKSH	273,213	110,350
6061	Transferita të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	253,955,635	244,283,796

4. Shpenzime financiare:

-Llogaria **66 “Shpenzime Financiare të jashtme”**, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 28,546,697 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 6,390,156 lekë ose me një pakësim në vlerën 22,156,541 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë shpenzime financiare paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	VI. SHPENZIME FINANCIARE	6,390,156	28,546,697
65	1. Shpenzime Financiare të brendshme	0	0
650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte	0	0
651	Interesa për huamarrje të tjera Brendshme	0	0
652	Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë	0	0
656	Shpenzime nga këmbimet valutore	0	0
66	2. Shpenzime Financiare të jashtme	6,390,156	28,546,697
660	Interesa për huamarrje nga Qeveri të Huaja	0	0
661	Interesa për financime nga Institucionet Ndërkombëtare	0	0
662	Interesa për huamarrje të tjera jashtme	6,390,156	28,546,697

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 831,119,206 lekë dhe totali shpenzimeve është 782,221,814 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 48,897,392 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 48,897,392 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Numri i punonjësve dhe fondi pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitorë dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. A.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të Këshillit Bashkiak.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Mallakastër (regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

Lekë						
Periudha	Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limi
2023	Hapura	3	178,383,272	115,936,865	62,446,407	35%
	E hapur e thjeshtuar	3	13,779,156	11,910,600	1,868,556	13.56%
Shuma procedura sipas llojit		6	192,162,428	127,847,465	64,314,963	33.46%
Periudha	Procedura sipas objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndarë në lloje	
2023	Ne fushën e ndërtimeve	3	160,945,183	97,060,040	Fond limit kursyer	Kontratës
	Në shërbime/ blerje, etj	3	31,217,245	30,787,425	63,885,143	39.69%
					429,820	1.37%
Shuma procedura sipas llojit		6	192,162,428	127,847,465	64,314,963	40.97%

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë realizuar **në total 6** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën **192,162,428 lekë** pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **127,847,465 lekë** pa Tvsh nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar **3** procedura në fushën e ndërtimeve me fond limit në shumën **160,945,183 lekë** pa Tvsh dhe **3** procedura në fushën e shërbimeve dhe blerjeve etj., me fond limit në shumën **31,217,245 lekë** pa Tvsh.

Likuidimi i procedurave të prokurimeve me vlera të larta për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, paraqitet si më poshtë:

Lekë			
Periudha	Vlera e kontratave me Tvsh	Likuiduar	Realizimi në %
2023	127,847,465	61,230,086	47.89%
Totali	127,847,465	61,230,086	47.89%

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2023**, deri më **31.12.2023**, paraqiten si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)”.			
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6, datë 06.04.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:	

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur".	Nr. 6, datë 06.04.2023. 1. B.F(Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. M.M (Inxhinier Ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	Nr. 91, datë 12.04.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit) 2. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. TH.GJ , Anëtarë (Specialist/DAZH TLP)
5. Fondi Limit: 78,253,438 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: BOE "K " Shpk & "C " Shpk me vlerë oferte 49,092,600 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 29,160,838 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 17 OE b) S'kualifikuar: 3 OE 1. BOE "A " Shpk & "R " Shpk; 2. OE "L " Shpk; 3. BOE "T " Shpk & "C " Shpk; c) Kualifikuar: 14 OE 1. BOE "K " Shpk & "C " Shpk; 2. OE "SH " Shpk; 3. OE "LL " Shpk; 4. OE "S " Shpk; 5. BOE "D " Shpk & "RR " Shpk; 6. BOE "N " Shpk & "T " Shpk; 7. BOE "A " Shpk & "K " Shpk; 8. OE "SH " Shpk; 9. BOE "D " Shpk & "RR " Shpk; 10. OE "B " Shpk; 11. OE "N" Shpk; 12. OE "G " Shpk; 13. OE "B " Shpk; 14. OE "C " Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1691/14 prot., datë 12.07.2023.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 58,911,120 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)", janë siguruar fonde në vlerën totale **75,830,250 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër të miratuara me VKB-të respektive si më poshtë:

a. Me VKB-në nr. 70, datë 19.12.2022, "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025, të Bashkisë Mallakastër", në vlerën 24,400,000 lekë sipas Tabelës nr. 4, Grupi 00, Programi 04520, Kodi i Institucionit 2131001, Kodi i Projektit 1310424;

b. Me VKB-në nr. 10, datë 21.02.2023, "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023", në vlerën 10,519,130 lekë;

c. VKB-në nr. 64, datë 22.12.2023, "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe Buxhetit të vitit 2024", në vlerën 40,911,120 lekë;

Nga auditimi i fondeve të aprovuara për realizimin e kësaj procedure prokurimi konstatohet se, me VKB-në nr. 70, datë 19.12.2022, "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025, të Bashkisë Mallakastër" në të cilën është përfshirë edhe PBA-ja 2023-2025, në këtë dokument nuk përcaktohet afatet e parashikuara të likuidimit të ndara sipas viteve 2023-2024 për objektin e prokuruar (duke marrë në konsideratë faktin që realizimi i objektit që prokurohet përfshin periudhën 2023-2024) por është miratuar fondi 24,400,000 lekë.

Kësaj shume është shtuar financim shtesë në vlerën 10,519,130 lekë sipas VKB-së nr. 10, datë 21.02.2023, "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023" ku totali i financimit shkon në

vlerën 34,919,130 lekë (totali i financimit përpara nisjes së procedurës së prokurimit) ndërkohë që vlera e prokuruar është 93,904,125.60 lekë me Tvsh pra me një diferencë në vlerën 58,984,995.60 lekë mungesë financimi deri në këtë fazë.

Referuar kontratës nr. 1691/14 prot., datë 12.07.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Mallakastër përfaqësuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë dhe fituesit BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk, afati i nisjes së punimeve është 5 ditë nga lidhja e kontratës.

Në nenin 9 “Grafiku i pagesës” të kontratës përcaktohet që: “Lidhur me pagesat, palët bien dakord që financimi i këtij objekti të kryhet gjatë viteve 2023-2024 (siç është parashikuar në Dokumentet e Tenderit) sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër VKB nr. 11, datë 21.02.2023, “Për miratimin e financimit të ndarë në dy vitet investime”. VKB nr. 11, datë 21.02.2023, i përket financimit të objektit të prokurimit konkretisht për vitin 2023 në vlerën 34,919,130 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 59,480,870 lekë. Financimi i cili i përket vitit 2024 nuk rakordon me VKB apo PBA-në 2024-2026. Vlera e kontratës të sipërpërmendur është 58,911,120 lekë me Tvsh ndërkohë që fondet e miratuara deri në momentin e lidhjes së kontratës kanë qenë të pa mjaftueshme me një diferencë në vlerën 23,991,990 lekë.

Përafërsisht pas një periudhe kohore prej 5 muajve pas nisjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktor janë miratuar fonde shtesë në vlerë 40,911,120 lekë ku totali i financimit shkon në vlerën 75,830,250 lekë me një diferencë më tepër nga vlera e përcaktuar në kontratën e punimeve në vlerën 16,919,130 lekë.

Vlen të theksohet që në PBA-në e 2024-2026 (duke marrë në konsideratë faktin që një pjesë e fondeve likuidohet përgjatë vitit 2024) të miratuar me VKB nr. 37, datë 24.07.2023, “Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” janë parashikuar fonde për likuidimin e kësaj kontrate për vitin 2023 në vlerën 34,919,130 lekë ndërsa për vitin 2024 vlerën 70,000,000 lekë ndërkohë që diferenca e vlerës së kontratës së mbetur për likuidim është 23,991,990 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154, ku përcaktohet që: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijëni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit”.

Në zbatim të VKB-së nr. 70, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër” (në të cilën është parashikuar realizimi i objektit “Rikonstruksioni i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)”, nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik punonjës pranë Drejtorisë së Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçensave dhe Projekteve është hartuar dosja teknike miratuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Në dosjen e procedurës së prokurimit janë të përfshira:

- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacionin teknik;
- Specifikimet teknike dhe projekt zbatimi;
- Analiza e çmimeve.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik dhe konfirmuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Nga verifikimit në internet është konstatuar se, z. M.M dhe znj. B.V nuk janë të

pajisur me liçensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit⁴. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, ku përcaktohet që: “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçensën përkatëse”.

Me Urdhrin nr. 6, datë 06.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F , z. M.M , z. F.M .

Me Urdhrin nr. 6, datë 06.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)” me fond limit në vlerën 78,253,438 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e Hapur”.

Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 6, datë 06.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi ka mbajtur procesverbalin e datës 11.04.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 12.04.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. M.M , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 18.04.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Mallakastër, rezulton se: Për procedurën me REF-65827-04-12-2023, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)” me fond limit 78,253,438 lekë pa Tvsh, ka sygjëruar disa kriterë të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Më datën 20.04.2023, nga z. M.M është mbajtur procesverbali mbi ndryshimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik. Me shkresën nr. 1691/3 prot., datë 20.04.2023, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, miratuar nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ku është hartuar një shtojcë në Dokumentat e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kriter nuk është përfshirë edhe detyrimi ligjor konkretisht, pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjorë, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, gërma “c”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kontratë pune të vlefshme të paktën 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar, të pajisur me dëshmi/çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave ose të ketë marrëdhënie kontraktuale (kontratë të vlefshme) me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes.

⁴ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 45001:2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente**, konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen me këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci Autoritetit Kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 45 (dyzetë e pesë) punonjës të siguruar, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar:

-Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

-1 (një) inxhinier ndërtimi

-1 (një) inxhinier hidroteknik

-1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

-1 (një) inxhinier ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë;

-2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

-1 (një) teknik topograf, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

-2 (dy) muratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;

-4 (katër) punëtorë asfaltimi në rrugë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	1
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
8	Eskavator	Në pronësi ose me qira	2
9	Buldozer	Në pronësi ose me qira	1
10	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
12	Fabrikë për prodhim asfalti	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
13	Impiant për prodhim betoni dhe inerte	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
14	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
15	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

-Çertifikata e pronësisë;

-Leja e qarkullimit;

-Çertifikata e kontrollit teknik;

-Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

-Leje/çertifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

-Kontrata e qirasë;

-Çertifikata e pronësisë së qiradhënësit;

-Leja e qarkullimit;

-Çertifikata e kontrollit teknik;

-Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

-Leje/çertifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

-Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

-Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore prej 45 punonjës për një periudhë jo më pak**

se 3 muaj (janar-mars 2022) nga data e hapjes së tenderit. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për **pikën nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr. 2.3.6, nr. 2.3.7,** (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, mjetet/makineritë dhe pajisjet) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

4. Pika nr. 2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkojnë janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- 1. Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente;**
- 2. Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente;**
3. Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 ose ekuivalente;

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Kërkesa për **Certifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente**, kjo certifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)”.

Kërkesa për **Certifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi” ose ekuivalente**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është e zaturuar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e neni 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e

këtyre kritereve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 91, datë 12.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X , z. TH.GJ .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 03.05.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 17 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Më datën 16.05.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali mbi konstatimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, ku përcaktohet që: “Në rastin kur janë të vlefshme tri oferta ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme”, u kryen përllogaritjet mbi vlerësimin si anomalisht të ulëta nga BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk si më poshtë:

		Lekë
Nr.	BOE/OE të kualifikuar	Vlera e ofertës
1	OE “LL ” Shpk	52,203,300
2	OE “S ” Shpk	54,537,875
3	BOE “D ” Shpk & “RR ” Shpk	55,959,270
4	BOE “N ” Shpk & “T” Shpk	58,599,955
5	BOE “A ” Shpk & “K ” Shpk	58,621,945
6	OE “SH ” Shpk	58,846,950
7	BOE “D ” Shpk & “Rruge Sinjalistike Mirëmbajtje & H ” Shpk	61,334,647
8	OE “B ” Shpk	61,897,900
9	OE “N” Shpk	61,900,500
10	OE “G ” Shpk	68,852,390
11	OE “B ” Shpk	69,065,000
12	OE “C ” Shpk	72,772,000
Totali		734,591,732

Përllogaritja mbi vlerësimin e ofertave anomalisht të ulëta: vlera e OE të kualifikuar 734,591,732 lekë/12 numri i OE të kualifikuar*0.85 = 52,033,581.02 lekë.

Me shkresën nr. 1691/4 prot., datë 16.05.2023, dhe shkresën nr. 1691/5 prot., datë 16.05.2023, AK Bashkia Mallakastër është drejtuar BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk me kërkesë për argumentimin dhe dokumentimin me prova shkresore dhe dhënien e sqarimeve për elementin/elementët e veçanta të ofertës.

-Me shkresën nr. 190/1 prot., datë 18.05.2023, administruar në Bashkinë Mallakastër me praktikën nr. 1691/6 prot., datë 19.05.2023, OE “SH ” Shpk ka kthyer përgjigje duke dhënë informacion për ofertën anomalisht të ulët.

-Me shkresën nr. 73 prot., datë 18.05.2023, administruar në Bashkinë Mallakastër me praktikën nr. 1691/7 prot., datë 19.05.2023, OE “K ” Shpk ka kthyer përgjigje duke dhënë informacion për ofertën anomalisht të ulët. Në këtë dokument citohet se: “Mallrat e propozuara nga ana jonë janë në përputhje me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, të siguruar nga tregues dhe prodhues me përvojë në fushën e objektit të këtij tenderi. Po ashtu vlen të sqarohet edhe një fakt tjetër, për pjesën më të madhe të materialeve të preventivit kemi marrëveshje paraprake verbal/shkrim me prodhuesit për çmimin që do të ofertojmë, si dhe kemi marrëveshje ligjore me fabrikat prodhuese për këto materiale. Për rastin e ofertës pranë jush, ju sqarojmë se një pjesë relativisht e ulët e çmimeve të ofertuara, **kanë ardhur si rezultat i gjendjes në magazinë të materialeve që përdoren.** Në të gjitha objektet e realizuara nga ana e kompanisë tonë, janë përdorur materiale të cilat janë shoqëruar me certifikatat përkatëse të cilësisë dhe të origjinës, të miratuara këto nga supervisorët e punimeve të objekteve dhe të kolauduara nga ekspertët përkatës. Shoqëria jonë ka realizuar punimeve të cilat janë të ngjashme me punimet që kërkohen të realizohen te procedura juaj thuajse me të njëjtat çmime që keni ofruar autoritetit tuaj”.

Për sa trajtuar më sipër bashkëlidhur shkresës (kthim përgjigje) të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër nga BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk nuk është paraqitur lista e materialeve që disponohet gjendje në magazinë së bashku me faturat e blerjes. Mos paraqitja e dokumentacionit të pretenduar në shkresën kthim përgjigje, në opinionin e grupit të auditimit, nuk dokumentohet dhe argumentohet oferta anomalisht e ulët e ofertuar nga BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, ku përcaktohet që: “Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të **argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së**”.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 22.05.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 14 OE dhe s’kualifikuar 3 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk. **Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. BOE “K ” Shpk (me Nipt L...E) & “C ” Shpk (me Nipt L...O) me vlerë ekonomike të ofertës **49,092,600 lekë pa Tvsh.**
2. OE “SH ” Shpk (me Nipt K...Ë) me vlerë ekonomike të ofertës **50,000,000 lekë pa Tvsh.**
3. OE “LL ” Shpk (me Nipt K...K) me vlerë ekonomike të ofertës **52,203,300 lekë pa Tvsh.**
4. OE “L ” Shpk (me Nipt L...F) me vlerë ekonomike të ofertës **53,880,430 lekë pa Tvsh.**
5. BOE “A ” Shpk (me Nipt M...L) & “R ” Shpk (me Nipt J...E) me vlerë ekonomike të ofertës **54,200,900 lekë pa Tvsh.**
6. OE “S ” Shpk (me Nipt J...Q) me vlerë ekonomike të ofertës **54,537,875 lekë pa Tvsh.**
7. BOE “D ” Shpk (me Nipt L...B) & “RR ” Shpk (me Nipt K...H) me vlerë ekonomike të ofertës **55,959,270 lekë pa Tvsh.**
8. BOE “N ” Shpk (me Nipt L...L) & “I ” Shpk (me Nipt J...Ë) me vlerë ekonomike të ofertës **58,599,955 lekë pa Tvsh.**
9. BOE “A ” Shpk (me Nipt J...R) & “K ” Shpk (me Nipt J...Q) me vlerë ekonomike të ofertës **58,621,945 lekë pa Tvsh.**
10. OE “SH ” Shpk (me Nipt K...N) me vlerë ekonomike të ofertës **58,846,950 lekë pa Tvsh.**
11. BOE “D ” Shpk (me Nipt K...J) & “Rruge Sinjalistike Mirëmbajtje & H ” Shpk (me Nipt L...U) me vlerë ekonomike të ofertës **61,334,647 lekë pa Tvsh.**
12. OE “B ” Shpk (me Nipt J...V) me vlerë ekonomike të ofertës **61,897,900 lekë pa Tvsh.**
13. OE “N ” Shpk (me Nipt K...I) me vlerë ekonomike të ofertës **61,900,500 lekë pa Tvsh.**
14. BOE “T ” Shpk (me Nipt K...L) & “C ” Shpk (me Nipt J...K) me vlerë ekonomike të ofertës **67,670,350 lekë pa Tvsh.**
15. OE “G ” Shpk (me Nipt K...A) me vlerë ekonomike të ofertës **68,852,390 lekë pa Tvsh.**
16. OE “B ” Shpk (me Nipt K...N) me vlerë ekonomike të ofertës **69,065,000 lekë pa Tvsh.**
17. OE “C ” Shpk (me Nipt K...M) me vlerë ekonomike të ofertës **72,772,000 lekë pa Tvsh.**

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. BOE “A ” Shpk & “R ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-OE “A ” Shpk ka paraqitur për punë të ngjashme kontratat me objekt “Rikonstruksion i rrugës lidhëse Zharrës-Shën Maria” të lidhur me Shoqërinë “B ” në vlerën 19,473,417 lekë pa Tvsh dhe “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshat i Ri-Sheqishtë” të lidhur me Bashkinë Patos në vlerën 14,637,190 lekë pa Tvsh. Referuar dokumentacionit shoqërues të dyja kontratat, si për datat e lidhjes së tyre, afatit dhe realizimit apo dhe invenstitorëve të ndryshëm, konstatohet se ato janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të paraqiten bashkërisht në formularin e vlerësimit. Për sa trajtuar më sipër kontratat e ngjashme të paraqitura nga OE “A ” Shpk nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në gërmën “a” dhe “b” të pikën nr. 2.3.1, të DT, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme ku përcaktohet që: “a” kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që

prokurohet, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180% i vlerës limit të kontratës që prokurohet, me vlerë të barazvlefshme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim”. Si dhe nenin 83, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet që: “Secili prej anëtarë të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

-OE “R ” Shpk në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar 1 punëtor asfaltimi në rrugë dhe 1 mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton, pasi për natyrën e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë është e domosdoshme që shoqëria të ketë punëtor asfaltimi dhe mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton, në kundërshtim me nenin 83, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet që: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

2. OE “L ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për mos plotësimin e pikës nr. 2.3.6, në lidhje me stafin mbështetës së kualifikuar, pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit konstatohet se OE ka deklaruar vetëm 1 teknik ndërtimi ndërkohë që në DT janë kërkuar 2 si dhe nuk është deklaruar asnjë teknik topograf.

-Për mos plotësimin e pikës nr. 2.3.7, në lidhje me disponibilitetin e mjeteve dhe pajisjeve pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit konstatohet se OE nuk ka deklaruar asnjë rul me peshë mbi 15 ton ndërkohë që janë kërkuar 2 të tillë.

3. BOE “T ” Shpk & “C ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për mos paraqitjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik.

-Për arsy se kontratat e paraqitura për punë të ngjashme nuk i përkasin objektit të prokurimi.

Më datë 02.06.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk. Me shkresën nr. 1691/9 prot., datë 13.06.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 1691/10 prot., datë 14.06.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 1691/13 prot., datë 03.07.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Bilancet e paraqitura nga OE “K ” Shpk për vitet 2020, 2021 dhe 2022 janë depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por **nuk është marrë konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.**

2. Në pikën nr. 2.2.3. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësisia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Nga OE “K ” Shpk janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë dhe Mallakastër për

vitet 2021-2022. Për sa trajtuar më sipër nga OE “K ” Shpk nuk është përmbushur pika nr. 2.2.3, e kriterëve të veçanta për kualifikim konkretisht, **nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Durrës referuar likuidimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Durrës** ndërkohë që ka ushtruar aktivitetet në këto qytet sipas kontratës si më poshtë:

Kontrata nr. 261/1 prot., datë 29.07.2022, me objekt “Rehabilitim argjaturës Perlat “Loti II”, institucioni Bordi Rajonal i Kullimit Durrës. Fatura tatimore nr. 18/2022, datë 02.09.2022, në vlerën 4,858,270 lekë regjistruar më datë 08.09.2022, dhe likuiduar më datë 09.09.2022, nga Dega e Thesarit Durrës.

3. Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	1
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Asfaltshtruese	Në pronësi ose me qira	1
8	Eskavator	Në pronësi ose me qira	2
9	Buldozer	Në pronësi ose me qira	1
10	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
12	Fabrikë për prodhim asfalti	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
13	Impiant për prodhim betoni dhe inerte	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
14	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
15	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

-Çertifikata e pronësisë;

-Leja e qarkullimit;

-Çertifikata e kontrollit teknik;

-Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

-Leje/çertifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

-Kontrata e qirasë;

-Çertifikata e pronësisë së qiradhënësit;

-Leja e qarkullimit;

-Çertifikata e kontrollit teknik;

-Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

-Leje/çertifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

-Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

-Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën

6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Për realizimin e objektit që prokurohet ndërmjet BOE është lidhur akt-marrëveshja e bashkëpunimit për të cilën janë marrë angazhimet për zbatimin e kontratës si më poshtë:

-OE “C ” Shpk do të realizojë 25.92% të kontratës

-OE “K ” Shpk do të realizojë 74.08%

Nga auditimi i dokumentacionit mbi plotësimin e kapaciteteve të parashikuara në pikën nr. 2.3.7, konstatohet se:

3. a. Në kërkesën e pikën nr. 2.3.7, nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar **1 Grejder**. Për disponibilitetin e mjetit Grejder, është paraqitur nga një mjet i tillë nga OE “K ” Shpk dhe OE “C ” Shpk sipas kontratave përkatëse të qirasë si më poshtë:

1. Mjeti Grejder i marrë me qira sipas kontratës nr. 2550 Rep., dhe nr. 570 Kol., datë 04.08.2020, të lidhur ndërmjet OE “F ” Shpk me përfaqësues znj. Z.K dhe OE “K ” Shpk nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur akt zhdoganimi nr. R19909.

2. Mjeti Grejder i marrë me qira sipas kontratës nr. 1537 Rep., dhe nr. 309 Kol., datë 31.03.2021, të lidhur ndërmjet OE “S ” Shpk me përfaqësues z. B.M dhe OE “C ” Shpk, nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur deklarata doganore nr. R29185, datë 26.12.2003.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, ku përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”.

3.b. Në kërkesën e pikën nr. 2.3.7, nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar **1 Autobetoniere**. Për disponibilitetin e mjetit **Autobetoniere**, është paraqitur nga një mjet i tillë nga OE “K ” Shpk dhe OE “C ” Shpk sipas kontratave përkatëse të qirasë si më poshtë:

1. Më datën 30.05.2022, ndërmjet OE “S ” Shpk, përfaqësuar nga administratori z. SH.S dhe OE “K ” Shpk është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira: 1 Autobetoniere me targë TR5385P. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me nr. 2100 Rep., nr. Kol., nr. 424, datë 30.05.2022. Për mjetin Autobetoniere me targë TR5385P i cili i përket kontratës të sipërpërmendur, dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në kosideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

2. Më datën 12.01.2023, ndërmjet OE “S ” Shpk, përfaqësuar nga administratori z. SH.S dhe OE “C ” Shpk është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira: 1 Autobetoniere me targë TR4364P. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me nr. 118 Rep., nr. Kol., nr. 26, datë 12.01.2023. Për mjetin Autobetoniere me targë TR4364P i cili i përket kontratës të sipërpërmendur, dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në kosideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa liçensën përkatëse”.

3.c. Në kërkesën e pikën nr. 2.3.7, nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar **2 Eskavator**. Për disponibilitetin e mjetit Eskavator, janë paraqitur 2 mjete të tilla nga OE “C ” dhe 2 mjete të tilla nga OE “K ” Shpk sipas kontratave të qirasë si më poshtë:

1. Mjeti Eskavator i marrë me qira sipas kontratës nr. 2550 Rep., dhe nr. 570 Kol., datë 04.08.2020, të lidhur ndërmjet OE “F ” Shpk me përfaqësues znj. Z.K dhe OE “K ” Shpk, nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit,

çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Për këtë mjet është paraqitur kontrata e shit-blejes nr. 560 Rep., dhe nr. 235 Kol.,.

2. Mjeti Eskavator në pronësi të OE “K ” Shpk sipas kontratës së shit-blejes nr. 1462 Rep., dhe nr. 695 Kol., datë 20.05.2019, ndërmjet z. A.X dhe OE “K ” Shpk nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

3. Mjeti Skrep me Goma Caterollar i paraqitur si Eskavator me targë AEMT55 në pronësi të OE “C ” Shpk sipas kontratës së shit-blejes së datës 25.10.2018, ndërmjet OE “B ” Shpk dhe OE “C ” Shpk është i regjistruar në regjistrat publikë. Për këtë mjet është paraqitur fatura tatimore e blerjes së mjetit nr. 37, datë 25.10.2018.

4. Në Formularin e Vetë Deklarimit për disponibilitetin e mjeteve, janë paraqitur të dhëna për një mjet Eskavator të marrë me qira sipas kontratës nr. 1707 Rep., dhe nr. 337 Kol.,. Në dosjen fizike të BOE të shpallur fitues për këtë mjet nuk disponohet asnjë dokumentacion.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, ku përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”.

Për sa trajtuar më sipër BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte s’kualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s’kualifikimin e BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, pika 4, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”, Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41 dhe Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësisimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **49,092,600 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. E.B , z. A.X , z. TH.GJ në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1750 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.B , z. A.X dhe TH.GJ anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: BOE “K” Shpk & “C ” Shpk në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 93 “Oferta anomalisht e ulët” pika 2, nëpërmjet shkresës me nr. 73 prot., datë 18.05.2023, ka dhënë sqarimet dhe argumentimin e ofertës për:

-Anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
-Zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
-Originalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
-Pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër bashkëlidhur shkresës (kthim përgjigje nr. 73 prot., datë 18.05.2023, administruar në Bashkinë Mallakastër me praktikën nr. 1691/7 prot., datë 19.05.2023) të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër nga BOE "K" Shpk & "C" Shpk nuk është paraqitur lista e materialeve që disponohet gjendje në magazinë së bashku me faturat e blerjes. Mos paraqitja e dokumentacionit të pretenduar në shkresën kthim përgjigje, në opinionin e grupit të auditimit, nuk dokumentohet dhe argumentohet oferta anomalisht e ulët e ofertuar nga BOE "K" Shpk & "C" Shpk.

Pretendimi i subjektit: KVO ka vlerësuar të plotësuar këtë kriter nga OE "K" Shpk, si pjesë e BOE "K" Shpk & "C" Shpk, pasi në datën e zhvillimit të prokurimit OE ka dorëzuar në SPE tre bilancet e kërkuara në pikën 2.2.2, të DT, dhe më konkretisht:

-Bilanci i vitit 2020 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

-Bilanci i vitit 2021 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

-Bilanci i vitit 2022 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Pra sa më sipër bilancet e dorëzuara në SPE për objektin e prokurimit të mësipërm, janë dorëzuar të konfirmuara nga DT Fier. Në kërkesën nr. 2.2.2, të DT nuk kërkohet konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga DT, por konfirmimi i bilanceve nga Administrata Tatimore, që do të thotë se bilancet e dorëzuara në SPE janë ato të dorëzuara në Drejtorinë Tatimore. Gjithashtu theksojme se këto bilance janë kërkuar nga AK për të verifikuar ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Gjithashtu këto bilance janë të dorëzuara edhe në QKB të cilat janë lehtësisht të verifikueshme.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Pasqyrat financiare për vitet 2019-2021, të OE "K" Shpk të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik mbajnë vulën e Sekretarisë së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier pra vula vërteton se këto pasqyra janë depozituar duke marrë edhe numrin e protokollit të depozitimit të DRTF, ndërsa konfirmimi i pasqyrave kryhet në formë shkresore nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve sipas Tatim Paguesit përkatës.

Pretendimi i subjektit: OE "K" Shpk si pjesë e BOE "K" Shpk & "C" Shpk për plotësimin e kriterit nr. 2.2.3, të DT, nisur nga ekstrakti i QKB ku si qendër është në Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z. Kadastrale 1090, nr. Pasurie 7/9810/, Ndërtesë dhe vend tjetër të aktivitetit e ka në Tiranë ka paraqitur dokumentat vërtetime për pagesat e taksave vendore si më poshtë:

-Vërtetimin me nr. 351/1 prot., datë 11.02.2021, i cili ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Mallakastër për vitin 2021.

-Vërtetimin me nr. 2342/1 prot., datë 04.05.2022, i cili ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Mallakastër për vitin 2022.

-Vërtetimin datë 04.03.2021, i cili ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Tiranë për vitin 2021.

-Vërtetimin datë 22.09.2022, i cili ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Tiranë për vitin 2022.

Për sa i përket vërtetimit për pagesën e taksave lokale për Bashkinë Durrës OE "K" nuk e ka deturim pasi sipas ekstraktit Historik të QKB nuk ka dhe nuk ka pasur aktivitet në Bashkinë Durrës.

KVO vlerëson se OE "K" Shpk si pjesë e BOE "K" Shpk & "C" Shpk, me dokumentacionin e paraqitur, vërteton se është në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësuar se oferta e tij është në përzgjedhjen e një ofertë më të mirë ekonomike-teknike.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i Auditimit i është referuar trasaksioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku provohet që subjekti nuk ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatorët kanë ushtruar aktivitet për vitin 2022. Jemi në rastin kur përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, nuk rezulton i vërtetë, pra operatorët ekonomikë ndodhen në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma "a" të LPP-së.

Pretendimi i subjektit: Nga shqyrtimi i ofertës fituese Komisioni i KLSH i cili ka audituar dokumentacionin e dorëzuar në sistem dhe fizikisht, është konstatuar se:

Për mjetet Grejder të marra me qira nuk janë të regjistruara në regjistrat publik.

Për mjetin Grejder të paraqitur të paraqitur nga OE “K ” Shpk i marrë me qira është paraqitur akt zhdoganimi nr. R19909. KVO vlerëson se mjeti grejder është makineri që mund të vërtetohet nëpërmjet akt zhdoganimit, ashtu si specifikohet në DT “Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme, gjithashtu KVO ka vlerësuar se ky është një makineri që do të transportohet me rimorkiator, duke mos rënë ndesh me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998.

Nisur nga kontrata e lidhur midis palëve për mjete me qira, KVO është udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike, duke e trajtuar lehtësisht si devijim që nuk çënojnë zbatimin e kontratës.

Gjthashtu KVO vlerëson se në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” pika 4 oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Për mjetin Autobetoniere me targë TR5385P Shoqëria K e ka marrë me qira nga Subjekti “S ” Shpk, dhe mjeti disponon dokumentacion të rregullt për qarkullim. Shoqëria pas lidhjes së kontratës me AK ka të drejtë ta pajisi mjetin me leje transporti për llogari të vet.

Nisur nga kontrata e lidhur midis palëve për mjete me qira, KVO është udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike, duke e trajtuar lehtësisht si devijim që nuk çënojnë zbatimin e kontratës.

Gjthashtu KVO vlerëson se në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik “ neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” pika 4 oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Përsa u përket mjeteve eskavator për të cilën nuk janë të regjistruar në regjistrat publik, sqarojmë se ato janë mjete me zinxhirë dhe janë të shoqëruar me dokument akt zhdoganimi.

BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk për realizimin e pikës nr. 2.3.7, të kapacitetit teknik, përveç sasisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e objektit ka dorëzuar edhe dokumenta të tjera mjetesh.

Gjthashtu KVO vlerëson se në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, Neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” pika 4 Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

KVO vlerëson se BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk, me dokumentacionin e paraqitur, vërteton se është në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësuar se Oferta e tij është në për zgjedhjen e një oferte më të mirë ekonomike-teknike.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”. Për më tepër në kriter kërkohet çertifikatë pronësie, leje qarkullimit etj..

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”.

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1, datë 08.03.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 1, datë 08.03.2023. 1. B.F(Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. E.Y (Inxhinier Navigacion) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 64, datë 10.03.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit, Ekonomist) 2. N.S , Anëtarë (Jurist) 3. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”.		
5. Fondi Limit: 21,477,925 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “N ” Shpk me vlerë absolute 13.9 lekë/litër për shumën e prokuruar 21,477,925 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 0 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 31.03.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S’kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE 1. OE “N ” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: -Nr. 50/4 prot., datë 03.05.2023, për Ndërmarrjes e Shërbimeve Publike; -Nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, për Bashkinë Mallakastër.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 25,773,510 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”, janë siguruar fonde në vlerën **24,874,000 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër sipas VKB nr. 70, datë 19.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër”. Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Mallakastër në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 1, datë 08.03.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.M .

Referuar urdhrin për ngritjen e NjP konstatohet se, në përbërje të saj nuk ka asnjë specialist fushe për objektin që prokurohet. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 2, ku përcaktohet që: “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit. Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit”.

Me Urdhrin nr. 1, datë 08.03.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me fond limit në vlerën 21,477,925 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e Hapur”.

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrin nr. 1, datë 08.03.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. E.Y me detyrë Specialist pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me profesion Inxhinier Navigacioni ka mbajtur procesverbalin e datës 10.03.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 10.03.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Me Urdhrin nr. 54, datë 01.03.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ka urdhëruar Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e nevojave sasiore, afatin e lëvrimit dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet nga Bashkia Mallakastër (Organi Qendror Blerës) për nevojat e saj dhe të NSHP-së me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”.

Në zbatim të udhrit të sipërpërmendur, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike z. B.V ka nxjerrë Urdhrin nr. 19, datë 06.03.2023, për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike i përbërë nga z. F.B kryetar i komisionit (Përgjegjës i Sektorit të Transportit NSHP) dhe anëtarët z. F.A (Përgjegjës i Financës Bashkia Mallakastër), z. E.Y (Specialit Inxhinier Navigacion NSHP).

Me shkresën nr. 50/1 prot., datë 06.03.2023, nga komisioni i sipërpërmendur është mbajtur akti-technik për përllogaritjen e fondit limit, afatin e lëvrimit dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”. Duke u bazuar në procesverbalin e sipërpërmendur komisioni për caktimin e fondit limit është bazuar në metodën studim tregu dhe çmim mesatar konkretisht 164 lekë/litër diezel (naftë) pa Tvsh * 130,830 litra = 21,477,925 lekë pa Tvsh.

Ky dokumentacion është përcjellë me shkresën nr. 50/2 prot., datë 06.03.2023, pranë Bashkisë Mallakastër për nisjen e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar prej 130,830 litra diezel (naftë) konkretisht në dokumentin e mbajtur nga komisioni për përllogaritjen e fondit limit nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimet e viteve të mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet së bashku me plan shpërdarjen për mjetet e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku përcaktohet që: “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F.B , z. F.M , z. E.Y në cilësinë e anëtarëve të komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Më datë 16.03.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Mallakastër, rezulton se: Për procedurën me REF-62334-03-13-2023, me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me fond limit 21,477,925 lekë pa Tvsh, ka sygjerruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Me shkresën nr. 1149/3 prot., datë 20.03.2023, nga NjP është publikuar njoftimi për ndryshimin e DT, miratuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ku është hartuar një shtojcë në Dokumentat e Tenderit si më poshtë:

I. Kërkesa e përcaktuar sipas shkoronjës “a”, të pikës 2, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, te kriteret e veçanta të kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave të Tenderit, ndryshohet dhe bëhet: **a.** Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve financiare (2019, 2020, 2021) ose (2020, 2021, 2022 nëse e disponojnë), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben

Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

II. Te Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, e Dokumentave të Tenderit pranohen edhe standarde ekuivalente që plotësojnë treguesit/parametrat dhe që janë brenda kufijve të lejuar sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e kësaj shtojce.

III. Në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 75, pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, duke qenë se ndryshimi i dokumentave të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, nuk do të aplikohet zgjatja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

Pra, afati i fundit i paraqitjes dhe hapjes së ofertave mbetet data 31.03.2023, ora 09:00.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtimit dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.b. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kriter nuk është përfshirë edhe detyrimi ligjor konkretisht, pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjore, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, gërma “c”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2. Në pikën nr. 3.b. Me qëllim reduktimit të shpenzimeve dhe kursimit të kohës për Autoritetin Kontraktor, operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë minimalisht një stacion furnizimi me karburant në një distancë jo më të largët se 10 (dhjetë) kilometra në vijë rrugore nga godina e Bashkisë Mallakastër, të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit në njërin prej formave të disponimit sipas Kodit Civil (çertifikatë për vërtetim pronësie me destinacion të përcaktuar si pikë karburanti ose kontratë huapërdorje/qiraje noteriale të vlefshme, shoqëruar detyrimisht me çertifikatën për vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit me destinacion të përcaktuar si pikë karburanti) dhe e regjistruar si pikë aktive për ushtrim aktiviteti në QKB.

Lidhur me kriterin se operatori ekonomik duhet të disponojë një stacion furnizimi jo më larg se 10 km, duke marrë shkas nga fakti se ky kriter mund të sjell kufizimin e pjesëmarrjes apo s’kualifikim të ofertuesve, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e tjera dhe mund të kenë një pikë furnizimi me distancë më të largët.

3. Në pikën nr. 3.f. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar jo më parë se viti 2022, nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i çertifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike.

Për sa i përket kërkesës se operatori ekonomik duhet të paraqesi “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar jo më parë se vitin 2022, nga ISHT ose nga një

organ/subjekt i çertifikuar/autorizuar/akredituar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, fletë analiza ose raporti i testimi vlen për gjendjen në depozitë të sasisë së karburantit dhe jo për gjendjen e depozitës së muajit janar të vitit 2022 si afat maksimal i kërkuar në këtë kërkesë për të cilën sasia e karburantit mund të jetë shitur.

Në lidhje me kriterin për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel) vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesëmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHT-i (Inspektoriati Shtetëror Teknik), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburant siaps standardeve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. Ky kriter bazohet në nenin 36, dhe nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe nenin 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

4. Në shtojcën nr. 5, “ Formulari i specifikimeve teknike”.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Shënim: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator specifik ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Të dhënat teknike të naftës i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Lëndë djegëse për automjete-Karburant Gazoil (Diezel) sipas S SH EN 590:2013/ A1:2017.

Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimumi	Maksimumi
1	Numri i cetanit		51,0	-
2	Indeksi i cetanit		46,0	-
3	Densiteti në 15 ^o C	kg/m ³	820,0	845,0
4	Hidrokarburet aromatikë policiklike	% m/m	-	8,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Pika e flakërimit	^o C	55	-
7	Mbetja e karbonit (në 10% mbetje distilimi)	% m/m	-	0,30
8	Përmbajtja e hirit	% m/m	-	0,010
9	Pika e bllokimit të filtrit në të ftohtë CFPP	^o C	-	-
10	Korrozioni në shufër bakri (3 orë në 50 ^o C)	Vlerësim	Klasa 1	
11	Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0
12	Viskoziteti në 40 ^o C	mm ² /s	2,00	4,50
13	Përmbajtja e ujit	%m/m	-	0.020
14	Lubriciteti, diametri i korrektuar i gërvishtjes (ësd 1,4) në 60 ^o C	µm	-	460
15	Pika e turbullimit	^o C	-	-
16	Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24
17	Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25
18	Distilimi:			
	Distilati që vlon deri në 250 ^o C, % (v/v)	% v/v	-	65
	Distilati që vlon deri në 350 ^o C, % (v/v)	% v/v	85	
	95 % (v/v) distilon në	^o C		360

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi do të realizohet në distributor nëpërmjet kartave elektronike.

Kostoja për pajisjen me karta elektronike duhet të përballohet nga kontraktuesi.

Operatori ekonomik fitues bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së

Përgjithshme”, në përfundim të procedurave të prokurimit do të marrë një listë të mjeteve të Autoriteteteve Kontraktore përkatëse me qëllim pajisjen e tyre me kartë elektronike të personalizuar, sipas kërkesave për limitin mujor të tyre.

Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme dhe të përdorshme deri në ekzekutimin e plotë të vlerës së përgjithshme të kontratës.

Kontraktuesi duhet të marrë përsipër ofrimin e furnizimit me karburant 24 orë në çdo ditë të javës. Furnizimi me karburant do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në lidhje kërkesën për disponimin nga operatori ekonomik të Çertifikatës 590:2013+A1:2017, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër nuk është vendosur në këtë kriter edhe mundësia e disponimit të çertifikatës ekuivalente (të rinovuar) të njohur nga Standardet Shqiptare SSH EN 590:2022.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.F , z. E.Y , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 64, datë 10.03.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. N.S , z. A.X .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 31.03.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 operatorë ekonomik ka marrë pjesë me vlerë ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 04.04.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 operatorë ekonomikë është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “N ” Shpk.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “N ” Shpk (me Nipt J...C) me vlerë ekonomike të ofertës me normë fitimi të shprehur me vlerë absolute 13.9 lekë/litër për shumën e prokuruar 21,477,925 lekë pa Tvsh.

Më datë 07.04.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “N ” Shpk. Me shkresën nr. 1149/6 prot., datë 18.04.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 1149/7 prot., datë 18.04.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 1149/5 prot., datë 07.04.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “N ” Shpk.

1. Në pikën nr. 2.b. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Bilancet e paraqitura nga OE “N ” Shpk për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por **nuk është marrë konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.**

Për sa trajtuar më sipër OE “N ” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte s’kualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE “N ” Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s'kualifikimin e OE "N" Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "N" Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 3, "Parimet të përgjithshme", neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2, pika 4, neni 67 "Klasifikimi i ofertave" pika 2, neni 83 "Njoftimi i fituesit".

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE "N" Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **21,477,925 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. B.F, z. E.Y, z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. E.B, z. N.S, z. A.XH në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1710 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. F.B, z. E.Y dhe z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Përlllogaritjes së Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Duke mos qenë dakord me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH, paraqesim këtë observacion, pasi gjatë përgatitjes së dokumentacionit teknik të hartimit të specifikimeve teknike, përcaktimin e nevojave sasiore dhe përlllogaritjes së fondit limit, jemi bazuar në informacionin e disponuar paraprakisht për kontratat e mëparshme të realizuara. Nga ky informacion komisioni ka marrë të dhëna sasiore të harxhuara gjatë këtyre kontratave (për periudha 12 mujore) dhe pasi ka identifikuar konsumin e mëparshëm (12 mujor) të secilit prej mjeteve, ka përcaktuar edhe sasinë e nevojshme për 12 mujorin në vazhdim. Pra praktikisht komisioni e ka ezauruar këtë procedurë edhe pse ajo nuk është reflektuar në mënyrë analitike për secilin mjet të akti teknik. Nëpërmjet aktit teknik nr. 50/1 regj., datë 06.03.2023, komisioni ka bërë parashikimin sasiore, si përlllogaritja e fondit limit për një periudhë 12 mujore. Në aktin teknik nr. 50/1 regj., datë 06.03.2023, komisioni ndër të tjera ka cilësuar:

Bazuar në përcaktimet e bëra në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 12, pika 9, neni 13, dhe 76 pika 1/b, komisioni duke u referuar në të dhënat sasiore të furnizimeve të mëparshme të realizuara dhe duke marrë parasysh numrin relativisht të madh të automjeteve, proceset e shërbimeve dhe punëve që priten të realizohen si dhe paraprirjes së ndryshimeve që mund të ndodhin në bursë gjatë ekzekutimit të kontratës, konkludon se sasia e nevojshme (e pritshme) që do të duhet për një periudhë 12 mujore është si më poshtë:

Për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike sasia e pritshme është:

119,664 litra karburant diezel;

Për Bashkinë Mallakastër 11,166 litra karburant diezel

Sasia totale e pritshme:

130,830 litra karburant diezel.

Pra, konstatimi Juaj se nuk argumentohet sasia e kërkuar nuk qëndron, pasi sasia e kërkuar është referuar në të dhënat sasiore të furnizimeve të mëparshme të realizuara. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në nenin 13 pika 9 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku citohet se:

9. Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit, që kanë natyrë të vazhdueshme ose me mundësi ripërtëritje brenda një periudhe të caktuar, përlllogaritja e vlerës së kontratës bazohet:

a) në vlerën e përgjithshme reale të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit kalendarik ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur; në është e mundur; në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose në vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare; ose

b) në vlerën e përgjithshme të kontratave të njëpasnjëshme të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e ngritur nga grupi i auditimit ka të bëjë me sasinë, nuk argumentohet sasia e karburantit naftë të kërkuar për nevojat e institucionit. Në argumentin Tuaj referuar bazës ligjore të sipërpërmendur Bashkia mund të marrë karburant vlerën dhe sasinë e vitit të mëparshëm pa kryer asnjë analizë mbi gjendjen e mjeteve (cilat janë në gjendje pune dhe të dëmtuara), normativave (apo ndryshimet e normativave për arsye se mjetet kanë amortizim vjetor) dhe shërbimet që jep institucioni (në rast kur ka shtohen shërbime të tjera apo pakësohen) me një kontratë 1 vjeçare deri sa ta përfundojë atë dhe në qoftë se ajo del përtej afatit të parashikuar në kontratë (deri në përfundim të sasisë), por kur jemi në rastin e përfundimit të karburantit përpara afatit sepse nevojat e institucionit janë më të mëdha nga sasia e kontratës. Vlera është e parashikuar në buxhetin vjetor, vlera duhet të kthehet në sasi dhe sasia duhet të jetë e argumentuar për secilin mjet. Vlera e parashikuar në buxhet nuk është e njëjta me atë të kontratës së mëparshme. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1710/1 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.Y në cilësinë specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: I. Lidhur me për procedurën “Blerje karburant (Diezel) viti 2023” (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike):

Në pikën 3.2. të DST është përcaktuar kërkesa me përmbajtje:

“3.2. Me qëllim reduktimin e shpenzimeve dhe kursimin e kohës për Autoritetin Kontraktor, Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të kenë minimalisht një stacion furnizimi me karburant në një distancë jo më të largët se 10 (dhjetë) kilometra në vijë rrugore nga godina e Bashkisë Mallakastër, të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit në njërin prej formave të disponimit sipas Kodit Civil (çertifikatë për vërtetim pronësie me destinacion të përcaktuar si pikë karburanti ose kontratë huapërdorje/qiraje noteriale të vlefshme, shoqëruar detyrimisht me certifikatën për vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit me destinacion të përcaktuar si pikë karburanti) dhe e regjistruar si pikë aktive për ushtrim aktiviteti në QKB”. **Për këtë kërkesë është bërë edhe argumentimi përkatës si më poshtë:**

“Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të evituar kosto të shtuara për Autoritetin Kontraktor në lidhje me procesin e furnizimit të automjeteve me karburant dhe për këtë arsye është kërkuar që stacioni i propozuar për shitjen e karburantit të jetë në një distancë jo më të largët se 10 (dhjetë) kilometra në vijë rrugore nga godina e Bashkisë Mallakastër, vërtetuar me dokumentacionin përkatës të kërkuar, dokumentacion i cili është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe jep garancinë e nevojshme që aktiviteti ushtrohet në objekte të destinuara për tregtim karburantesh, duke kaluar të gjitha hallkat e miratimit për ushtrimin e një aktiviteti të tillë, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të ulë koston e furnizimit të automjeteve, sipas parimit të ekonomisë së kursimit, për shkak se automjetet do të furnizohen në stacionin e karburantit dhe në rast se ky stacion do të ishte më larg, kjo do të ndikonte direkt në rritjen e koston, pasi mjetet do të harxhonin më tepër karburant për shkak të itinerarit që do të përshkojnë. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kriteri, synohet edhe kursimi i kohës që do të duhet për të realizuar procesin e furnizimit në stacionin e karburantit, për shkak të numrit relativisht të madh dhe larmishmërisë së automjeteve të AK.”

Sqaroj se ky kriter nuk është aspak kufizues, pasi brenda rrezes 10 km ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të karburanteve një numër i konsiderueshëm subjektesh. Të gjitha grupet e mëparshme të auditimit nuk e kanë konsideruar si kriter kufizues këtë distancë, madje na kanë bërë me dije se shumica e autoriteteve kontraktore vendosin distanca edhe më të shkurtra, deri aty sa të jenë brenda qytetit apo të kenë edhe jo më pak se 2 pika karburantesh.

Siç edhe është përcaktuar në argumentimin e dhënë më sipër, nëpërmjet kësaj kërkesë, përveç sa u përmend më sipër, synohet dhe i jepet fokus parimit të ekonomisë së kursimit.

Pra, kjo është një kërkesë normale, aspak kufizuese dhe tepër favorizuese për autoritetin kontraktor sa i përket minimizimit të kostos dhe përdorimit me efektivitet të karburantit.

Mendoj se nuk mund të bëhet paralelizëm distancash për kontrata që nuk janë të së njëjtës natyrë (furnizimi dhe shërbimi), pasi kanë specifika të ndryshme. Kontrata e furnizimit me karburant është e shpeshtë, e vazhdueshme (ditore, javore) dhe ka kosto/konsum të shkosh shpesh herë në distanca të largëta, ndërsa kontrata e shërbimit të servisit të mjeteve nuk ka të njëjtën veçori.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me kriterin se operatori ekonomik duhet të disponojë një stacion furnizimi jo më larg se 10 km, duke marrë shkas nga fakti se ky kriter mund të sjell kufizimin e pjesëmarrjes apo s'kualifikim e ofertuesve, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e tjera dhe mund të kenë një pikë furnizimi me distancë më të largët.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pretendimi i subjektit: Në pikën 3.6. të DST është përcaktuar kërkesa me përmbajtje:

“3.6. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin “Fletë Analizë”/“Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar jo më parë se viti 2022, nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i certifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike”.

Për këtë kërkesë është bërë edhe argumentimi përkatës si më poshtë:

“Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorëve Ekonomikë ofertues dhe shërben njëkohësisht si një garanci për Autoritetin Kontraktor, sa i përket cilësisë së karburantit. Pra, nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që parametrat dhe karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara”.

Lidhur me këtë kriter, sqaroj se ky është një kriter i vendosur gjerësisht në procedurat e prokurimit që zhvillohen thuajse nga të gjitha autoritetet kontraktore. Gjithashtu nga investigimi paraprak që kemi bërë dhe nga informacioni që kemi marrë gjatë testimit nga subjektet tregtuese na është bërë me dije se “Fletë Analizë”/“Raport Testimi” është një dokument që bëhet në mënyrë të detyrueshme çdo vit nga ISHTI kundrejt një pagese të konsiderueshme. Gjithashtu, u vu re se të gjitha subjektet i kishin “Raportet e Testimit” që lëshon ISHTI në periudha të ndryshme të vitit përkatës.

Pra, nisur nga informacioni i marrë, duke qenë se ky dokument lëshohet 1 herë në vit është parë e arsyeshme të kërkohet me qëllim provimin e përmbushjes së specifikimeve teknike nga operatorët ekonomikë të interesuar.

Gjithashtu, në interpretim të asaj që ju citoni më poshtë këtij konstatimi, dhe nga informacioni verbal i marrë nga specialistë të ISHTI-t, rezulton se edhe vërtetimi për tregtimin e karburanteve sipas standardeve dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë, që e lëshon po ISHTI, bazohet në sondazhet dhe kampionimet e kryera nëpërmjet “Fletë Analizës”/“Raport Testimit”.

Pra, në këtë kuptim gjykoj se ky kriter gjen vend për aplikim në procedurën e mësipërme.

Sa i përket konstatimit tuaj lidhur me “Formularin e specifikimeve teknike” sipas Shtojcës 5, ku ju citoni se nuk është vendosur ekuivalenti, ju sqaroj se:

Ky konstatim nuk qëndron, pasi referuar shtojcës së hartuar dhe publikuar në SPE nga ana jonë, sipas rekomandimeve të APP, kjo gjë është reflektuar dhe në shtojcë është cituar:

“II. Te Shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, e Dokumentave Standarte të Tenderit pranohen edhe standarde ekuivalente që plotësojnë treguesit/parametrat dhe që janë brenda kufijve të lejuar sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e kësaj shtojce”.

Madje, këtë gjë e keni cituar edhe vetë në akt konstatim, ku keni thënë se bazuar në asistencën që APP jep....

....është hartuar një shtojcë në Dokumentat e Tenderit si më poshtë:

II. Te Shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, e Dokumentave Standarte të Tenderit pranohen edhe standarde ekuivalente që plotësojnë treguesit/ parametrat dhe që janë brenda kufijve të lejuar sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e kësaj shtojce.

Sa më sipër, gjykoj se ky kriter është aplikuar konform legjislacionit të prokurimit.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me kriterin për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel) vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1750 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.B , z. A.X dhe TH.GJ anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: KVO ka vlerësuar të plotësuar këtë kriter nga OE “N ” Shpk pasi në datën e zhvillimit të prokurimit OE ka dorëzuar në SPE tre bilanci e kërkuara në pikën 2.2.2 të DT, dhe më konkretisht:

-Bilanci i vitit 2019 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me nr. 7022 prot., datë 24.05.2021.

-Bilanci i vitit 2020 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me nr. 7022 prot., datë 24.05.2021.

-Bilanci i vitit 2021 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me nr. 9274 prot., datë 21.04.2022.

Pra sa më sipër bilanci e dorëzuara në SPE për objektin e prokurimit të mësipërm, janë dorëzuar të konfirmuara nga DT Fier.

Në kërkesën nr. 2.2.2, të DT nuk kërkohet konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga DT, por konfirmimi i Bilanceve nga Administrata Tatimore, që do të thotë se bilanci e dorëzuara në SPE janë ato të dorëzuara në Drejtorinë Tatimore.

Sa më sipër KVO vlerëson se OE e ka përmbushur këtë kriter dhe se vlerësimi është bërë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. KVO vlerëson se OE “N ” Shpk, me dokumentacionin e paraqitur, vërteton se është në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësuar se oferta e tij është në për zgjedhjen e një oferte më të mirë ekonomike-teknike.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Pasqyrat financiare për vitet 2019-2021, të OE “N ” Shpk të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik mbajnë vulën e Sekretarisë së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier pra vula vërteton se këto pasqyra janë depozituar duke marrë edhe numrin e protokollit të depozitimit të DRTF, ndërsa konfirmimi i pasqyrave kryhet në formë shkresore nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve sipas Tatim Paguesit përkatës.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 22, datë 22.08.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 22, datë 22.08.2023. 1. B.F(Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. M.M (Inxhinier Ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 230, datë 22.08.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit) 2. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. TH.GJ , Anëtarë (Specialist/DAZHTLP)
5. Fondi Limit: 4,039,835.83 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “SH ” Shpk me vlerë oferte 2,601,100 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 1,438,735.83 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 08.09.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 8 OE b) S’kualifikuar: 3 OE 1. OE “C ” Shpk;

		2. OE "N" Shpk; c) Kualifikuar: 6 OE 1. OE "SH" Shpk; 2. OE "S" Shpk; 3. OE "S" Shpk; 4. OE "A" Shpk; 5. OE "Z" Shpk; 6. OE "K" Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 4020/9 prot., datë 09.10.2023.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 3,121,320 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla "Hajredin Fratari" Damës Mallakastër", janë siguruar fonde në vlerën **5,294,750 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër sipas VKB-së nr. 39, datë 24.07.2023, "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, Shkolla "Hajredin Fratari" Damës, Mallakastër". Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Mallakastër në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 154.

Në zbatim të VKB-së nr. 39, datë 24.07.2023, "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për ndërhyrjen e menjëhershme në pronën publike, Shkolla "Hajredin Fratari" Damës, Mallakastër", nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik pranë Drejtorisë së Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçensave dhe Projekteve është hartuar dosja teknike miratuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Në dosjen e procedurës së prokurimit janë të përfshira:

- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacionin teknik;
- Specifikimet teknike dhe projekt zbatimi;
- Analiza e çmimeve.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik dhe konfirmuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Nga verifikimit në interenet është konstatuar se, z. M.M dhe znj. B.V nuk janë të pajisur me liçensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit⁵. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 5, ku përcaktohet që: "Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse".

Me Urdhrin nr. 22, datë 22.08.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F, z. M.M, z. F.M.

Me Urdhrin nr. 22, datë 22.08.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: "Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla "Hajredin Fratari" Damës Mallakastër" me fond limit në vlerën 4,039,835.83 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar".

Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 22, datë 22.08.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi ka mbajtur procesverbalin e datës 25.08.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

⁵ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Më datën 25.08.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. M.M , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kriter nuk është përfshirë edhe detyrimi ligjor konkretisht, pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, gërma “c”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2. Në pikën nr. 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kontratë pune të vlefshme të paktën 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar, të pajisur me dëshmi/certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave ose të ketë marrëdhënie kontraktuale (kontratë të vlefshme) me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 45001:2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente**, konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci Autoritetit Kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, të figurojë në liçensën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

-1 (një) inxhinier ndërtimi;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

-4 (katër) karpentierë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi profesional/diplomë/certifikatë (të vlefshme), lëshuar nga institucione/subjekte kompetente të akredituara/autorizuara/ngarkuara me ligj (shtetërore ose private) për certifikimin e punonjësve, sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

-3 (tre) punëtor ndihmës, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton	Në pronësi ose me qira	1
2	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

- Certifikata e pronësisë;

- Leja e qarkullimit;

- Certifikata e kontrollit teknik;

- Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

- Leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

- Foto/pamje ku të evidentohet qartësisht targa e mjetit;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

- Kontrata e qirasë;

- Certifikata e pronësisë së qiradhënësit;

- Leja e qarkullimit;

- Certifikata e kontrollit teknik;

- Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

- Leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

- Foto/pamje ku të evidentohet qartësisht targa e mjetit;

- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.3, dhe **nr. 2.3.5,** mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore të përcaktuara në kriteret e**

sipërpërmendura për një periudhë jo më pak se 3 muaj nga data e hapjes së tenderit. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Në lidhje me kërkesën se operatori ekonomikë duhet të disponojë **një Gjenerator të përcaktuar në pikën nr. 2.3.6**, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve dhe specifikimeve teknike), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e së cilës do të ishte i nevojshëm gjeneratori. Referuar preventivit të punimeve, çatia është me kapriata druri dhe jo me kapriata metalike për të cilën do të ishte i nevojshëm gjeneratori. Ndërsa zëri tjetër i preventivit ullaqet janë të gatshme dhe nuk saldohen në vend. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh për të cilën do të ishte i nevojshëm disponibiliteti i gjeneratorit. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për pikën **nr. 2.3.3, nr. 2.3.5, nr. 2.3.6**, (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, mjetet/makineritë dhe pajisjet) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

4. Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- 1. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente;**
- 2. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente;**
- 3. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente;**

Çertifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente**, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi” ose ekuivalente**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në

rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 230, datë 22.08.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X , z. TH.GJ .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 08.09.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 8 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Më datën 11.09.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali mbi konstatimin e ofertës anomalisht të ulët.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, ku përcaktohet që: “Në rastin kur janë të vlefshme tri oferta ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme”, u kryen përlllogaritjet mbi vlerësimin si anomalisht të ulëta nga OE “SH ” Shpk si më poshtë:

Nr.	BOE/OE të kualifikuar	Lekë Vlera e ofertës
1	OE “SH ” Shpk	2,601,100
2	OE “S ” Shpk	3,299,900
3	OE “S ” Shpk	3,581,316
4	OE “A ” Shpk	3,658,600
5	OE “Z ” Shpk	3,830,000
6	OE “K ” Shpk	3,836,440
Totali		

Përlllogaritja mbi vlerësimin e ofertave anomalisht të ulëta: vlera e OE të kualifikuar 20,807,356 lekë/6 numri i OE të kualifikuar*0.85 = 2,947,708.77 lekë.

Me shkresën nr. 4020/3 prot., datë 11.09.2023, AK Bashkia Mallakastër është drejtuar OE “SH ” Shpk me kërkesë për argumentimin dhe dokumentimin me prova shkresore dhe dhënien e sqarimeve për elementin/elementët e veçanta të ofertës.

-Me shkresën nr. 86 prot., datë 12.09.2023, OE “SH ” Shpk ka kthyer përgjigje duke dhënë informacion për ofertën anomalisht të ulët. Në këtë dokument citohet në mënyrë të përmbledhur, se nga OE “SH ” Shpk janë realizuar me sukses kontrata për punime të ngjashme në Bashkinë Kamëz me objekt “Ndërtim Rruga Deja, Babrru Qendër, Paskuqa”, “Sistemim Asfaltim i Rrugës Ura e Serbinit-Shtushaj Bashkia Bulqizë”. Gjithashtu oferta e paraqitur, ka të bëjë me faktin se selia e OE “SH ” Shpk është në qytetin e Fierit si dhe në vijim të kthim të përgjigjes evidentohet një paragraf në lidhje me kapacitete dhe aftësinë profesionale të stafit.

Për sa trajtuar më sipër bashkëlidhur shkresës (kthim përgjigje) të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër nga OE “SH ” Shpk, kontratat të cilat janë paraqitur si punë të ngjashme nuk i përkasin objektit që prokurohet si dhe aftësia profesionale e stafit apo qendra në të cilën ka OE selinë në të cilën ushtron aktivitet nuk përbëjnë argument për paraqitje të një oferte anomalisht të ulët. Në opinionin e grupit të auditimit nuk dokumentohet dhe argumentohet oferta anomalisht e ulët e ofertuar nga OE “SH ” Shpk.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, ku përcaktohet që: “Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së”.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 14.09.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 6 OE dhe s’kualifikuar 2 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “SH ” Shpk.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “SH ” Shpk (me Nipt K...N) me vlerë ekonomike të ofertës **2,601,100 lekë pa Tvsh.**
2. OE “N ” Shpk (me Nipt J...S) me vlerë ekonomike të ofertës **2,942,400 lekë pa Tvsh.**
3. OE “C ” Shpk (me Nipt L...O) me vlerë ekonomike të ofertës **3,242,160 lekë pa Tvsh.**
4. OE “S ” Shpk (me Nipt J...F) me vlerë ekonomike të ofertës **3,299,900 lekë pa Tvsh.**
5. OE “S ” Shpk (me Nipt K...H) me vlerë ekonomike të ofertës **3,581,316 lekë pa Tvsh.**
6. OE “A ” Shpk (me Nipt M...L) me vlerë ekonomike të ofertës **3,658,600 lekë pa Tvsh.**
7. OE “Z ” Shpk (me Nipt J...K) me vlerë ekonomike të ofertës **3,830,000 lekë pa Tvsh.**
8. OE “K ” Shpk (me Nipt J...Q) me vlerë ekonomike të ofertës **3,836,440 lekë pa Tvsh.**

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE “C ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për mos plotësimin e kërkesës së pikës nr. 2.3.1, në lidhje me punët e ngjashme të mëparshme. Nga OE “C ” në SPE është publikuar kontrata me objekt “Rikonstruksion i Kopshtit 1 Maj” të lidhur me Bashkinë Durrës me vlerë kontrate 18,011,496 lekë me TVSH zbatuar nga BOE “C ” Shpk & “N ” Shpk & “S ” Shpk. Referuar akt-marrëveshjes me nr. 2181 Rep., nr. Kol., nr. 431, datë 07.05.2019, konstatohet se OE “C ” Shpk ka marrë përsipër realizimin e punimeve në masën 18.13% të kontratës, punime të cilat nuk janë punime çatie (punime të parashikuara në objektin e prokurimit) por punime prishje, punime izolimi, shtresa niveluese, punime dyer dhe dritare alumini.

2. OE “N ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për mos plotësimin e Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës nr. 7, të DT, pasi në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për konfliktin e interesit” ortaku A.S. nuk mund të përfitojë kontrata me Bashkinë Mallakastër, pasi është i punësuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të Bashkisë Mallakastër.

Më datë 18.09.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “SH ” Shpk. Me shkresën nr. 4020/5 prot., datë 27.09.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 4020/6 prot., datë 28.09.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 4020/4 prot., datë 18.09.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “SH ” Shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “SH ” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Bilancet e paraqitura nga OE “SH ” Shpk për vitet 2020, 2021 dhe 2022 janë depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por **nuk është marrë konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.**

2. Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton	Në pronësi ose me qira	1
2	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm si vijon:
 - Çertifikata e pronësisë;
 - Leja e qarkullimit;
 - Çertifikata e kontrollit teknik;
 - Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);
 - Leje/çertifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Foto/pamje ku të evidentohet qartësisht targa e mjetit;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm si vijon:
 - Kontrata e qirasë;
 - Çertifikata e pronësisë së qiradhënësit;
 - Leja e qarkullimit;
 - Çertifikata e kontrollit teknik;
 - Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);
 - Leje/çertifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Foto/pamje ku të evidentohet qartësisht targa e mjetit;
- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Më datën 25.01.2023, ndërmjet z. B.M (Person fizik) dhe OE “SH ” Shpk është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira: 1 Kamion me targë AB875BR. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me nr. 496 Rep., nr. Kol., nr. 102, datë 30.05.2022. Për mjetin Kamion me targë AB875BR i cili i përket kontratës të sipërpërmendur, dokumentacioni shoqëruar për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa liqensën përkatëse”.

Për sa trajtuar më sipër OE “SH ” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte s’kualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE “SH ” Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s’kualifikimin e OE “SH ” Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “SH ” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi

i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, pika 4, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit” dhe Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “SH ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **2,601,100 lekë**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. E.B , z. A.X , z. TH.GJ në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1750 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.B , z. A.X dhe TH.GJ anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: KVO ka vlerësuar të plotësuar këtë kriter nga OE “SH ” Shpk pasi në datën e zhvillimit të prokurimit OE ka dorëzuar në SPE tre bilancet e kërkuara në pikën nr. 2.2.2, të DT, dhe më konkretisht:

-Bilanci i vitit 2020 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

-Bilanci i vitit 2021 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nr. 9469 prot., datë 27.04.2022.

-Bilanci i vitit 2022 është i vulosur dhe i firmosur në çdo fletë nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nr. 2274 prot., datë 11.04.2023.

Pra sa më sipër bilancet e dorëzuara në SPE për objektin e prokurimit të mësipërm, janë dorëzuar të konfirmuara nga DT Fier.

Në kërkesën nr. 2.2.2, të DT nuk kërkohet konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga DT, por konfirmimi i bilanceve nga Administrata Tatimore, që do të thotë se bilancet e dorëzuara në SPE janë ato të dorëzuara në Drejtorinë Tatimore. Po ashtu këto bilance janë kërkuar nga AK për të verifikuar se bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu këto bilance janë të dorëzuara edhe në QKB të cilat janë lehtësisht të verifikueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pasqyrat financiare për vitet 2020-2022, të OE “SH ” Shpk të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik mbajnë vulën e Sekretarisë së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier pra vula vërteton se këto pasqyra janë depozituar duke marrë edhe numrin e protokollit të depozitimit të DRTF, ndërsa konfirmimi i pasqyrave kryhet në formë shkresore nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve sipas Tatim Paguesit përkatës.

Pretendimi i subjektit: Sqarojme se mjeti i marrë me qira me targë AB875BR nga OE “SH ” Shpk është i pajisur me Çertifikatë me nr. 0213/11, datë 10.01.2021, nga Bashkia Mallakastër në emër të Subjektit juridik OE “SH ” Shpk. Ky dokument ndodhet fizikisht në dosjen e tenderit. Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopjen e dokumentit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit konfirmohet edhe nga Ju në observacion pra çertifikata për transport mallrash e paraqitur në observacion është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet. Ndërkohë që në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licensën përkatëse”.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 15, datë 12.06.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 15, datë 12.06.2023. 1. B.F(Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. E.Y (Inxhinier Navigacioni) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 159, datë 13.06.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit) 2. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. TH.GJ , Anëtarë (Specialist/DAZHTLP)
5. Fondi Limit: 1,666,550 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “E ” Sha me vlerë oferte 1,559,000 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 107,550 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 11.07.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 6 OE b) S’kualifikuar: 4 OE 1. OE “B ” Sha 2. OE “C ” Shpk 3. OE “E ” Sha 4. OE “K” Sha c) Kualifikuar: 2 OE 1. OE “E ” Sha 2. OE “A.P” PF
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 1,870,800 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”, janë siguruar fonde në vlerën **2,000,000 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, miratuar me VKB nr. 70, datë 19.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër”.

Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Mallakastër në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 26, datë 01.06.2023, të z. B.V me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është ngritur komisioni për përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe afatin e lëvrimin të përbërë nga z. E.Y kryetar i komisionit (Inxhinier Navigacioni) dhe anëtarët z. E.H (Mekanik), z. L.K (Manovrator).

Me shkresën nr. 76/1 prot., datë 02.06.2023, nr. 76/2 prot., datë 02.06.2023, nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur procesverbalet përkatëse ku janë hartuar specifikimet teknike, relacioni teknik dhe preventivi së bashku me analizën e çmimeve (për caktimin e çmimeve komisioni është bazuar një kontratën e mëparshme me nr. 125/5 prot., datë 27.09.2022, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, gërma “c”). Ky dokumentacion është përcjellës me shkresën nr. 76/3 prot., datë 20.06.2023, pranë Bashkisë Mallakastër për nisjen e procedurës së prokurimit.

Me Urdhrin nr. 15, datë 12.06.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.M .

Me Urdhrin nr. 15, datë 12.06.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë,

alkool frenash viti 2023” me fond limit në vlerën 1,666,550 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar”.

Hartimi i kriterëve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 15, datë 12.06.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. E.Y me detyrë Specialist pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me profesion Inxhinier Navigacioni ka mbajtur procesverbalin e datës 29.06.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 29.06.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për: Çertifikatë cilësie të vlefshme ISO 9001:2015 (Sistemi menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente.

Kërkesa për Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Y specialist i fushës në Njësinë e Prokurimit i cili më datë 29.06.2023, ka mbajtur procesverbalin për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrit nr. 159, datë 13.06.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X , z. TH.GJ .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 11.07.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 6 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 17.07.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 2 OE dhe s’kualifikuar 4 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga **OE “E ” Sha.**

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “E ” Sha (me Nipt L...T) me vlerë ekonomike të ofertës **1,235,640 lekë pa Tvsh.**
2. OE “E ” Sha (me Nipt K...E) me vlerë ekonomike të ofertës **1,559,000 lekë pa Tvsh.**
3. OE “C ” Shpk (me Nipt M...V) me vlerë ekonomike të ofertës **1,598,000 lekë pa Tvsh.**
4. OE “K” Sha (me Nipt J...L) me vlerë ekonomike të ofertës **1,620,895 lekë pa Tvsh.**
5. OE “A.P” PF (me Nipt L...F) me vlerë ekonomike të ofertës **1,635,302 lekë pa Tvsh.**
6. OE “B ” Sha (me Nipt K...H) nuk ka ngarkuar në SPE ofertë ekonomike.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE “B ” Sha për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për arsye se nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre, si dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. OE “C ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për arsye se në vërtetimin e ngarkuar në SPE me nr. T08663496, datë 07.07.2023, nuk pasqyrohet xhirua vjetore për asnjë prej viteve 2020, 2021 dhe 2022 të kërkuar në kriterin nr. 2.2.1, të Dokumentave të Tenderit..

-Zërat e paraqitura në faturat e ngarkuara në SPE nuk janë të natyrës së mallrave të kërkuara në objektin e prokurimit.

3. OE “E ” Sha për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për arsye se në Ekstraktin e QKB-së konstatohet se, z. M.P (në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës) nuk është cilësuar dhe deklaruar se ai nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1, të LPP-së, ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Në kushte të tilla nga OE “E ” Sha nuk ka përmbushur pikën nr. 1, gërma “ç”, të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit.

4. OE “K” Sha për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për arsye se në Ekstraktin e QKB-së konstatohet se, z. A.B dhe znj. R.K (në cilësinë e anëtarëve të Këshillit të Administrimit) nuk është cilësuar dhe deklaruar se ata nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1, të LPP-së, ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Në kushte të tilla nga OE “K” Sha nuk ka përmbushur pikën nr. 1, gërma “ç”, të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit.

Më datë 20.07.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “E ” Sha. Me shkresën nr. 2916/4 prot., datë 03.08.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 2916/5 prot., datë 04.08.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 2916/6 prot., datë 04.08.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “E ” Sha.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1710/1 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.Y në cilësinë specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me procedurën “Blerje filtra, vaj motori, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”:

Në pikën 2.3.3. të DST është përcaktuar kërkesa me përmbajtje:

“2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për: certifikatë cilësie të vlefshme ISO 9001:2015 (Sistemi menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente”.

Për këtë kërkesë është bërë edhe argumentimi përkatës si më poshtë:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenin 40 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Me anë të kësaj kërkesë, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përmbushja e standardit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për mallrat e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë”.

Lidhur me këtë kriter, sqarohet se ky është një kriter i vendosur gjerësisht në procedurat e prokurimit që zhvillohen thuajse nga të gjitha autoritetet kontraktore.

Standardi ISO 9001:2015 ose ekuivalent me të, është një certifikim që e marrin kompanitë kur përmbushin standardin e menaxhimit të cilësisë, që do të thotë se aktiviteti i tyre në përgjithësi dhe tregtimi i mallrave në veçanti pajtohet dhe është në përputhje me standardet në fuqi, e që në fakt kjo përkethehet si një garanci e shtuar për autoritetin kontraktor, duke krijuar bindjen se ofertuesit e interesuar i tregëtojnë mallrat objekt kontrate konform standardeve të cilësisë.

Për më tepër, fakti që vetë shteti, nëpërmjet institucioneve kompetente ka licencuar kompani që lëshojnë certifikime sipas këtij standardi, do të thotë se këto certifikime duhen kërkuar nga blerësit e mallrave apo shërbimeve, për të patur në një farë mënyre një garanci për blerjen e tyre.

Jo vetëm për këtë kriter, por as për kriteret e tjera të kësaj procedure, nuk ka pasur rekomandime nga APP-ja për heqjen ose ndryshimin e tij, pra të gjitha kriteret e kësaj procedure janë konsideruar në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Kërkesa për Certifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente, kjo certifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarde të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësisë të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 31, datë 20.11.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 31, datë 20.11.2023. 1. B.F (Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. E.Y (Inxhinier Navigacioni) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 338, datë 20.11.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit) 2. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. TH.GJ , Anëtarë (Specialist/DAZH TLP)
5. Fondi Limit: 8,072,770 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “F ” Shpk me vlerë oferte 7,750,500 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 322,270 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.12.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE b) S’kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE 1. OE “F ” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

14. Lidhja e kontratës: -Nr. 10/3 prot., datë 19.01.2024, për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike; -Nr. 6117/6 prot., datë 17.01.2024, për Bashkinë Mallakastër;	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 9,300,600 lekë	
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------	--

A. PROCEDURA E ANULUAR

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit vitit 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”, janë siguruar fonde në vlerën 9,700,000 lekë si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër të miratuara me VKB-në nr. 70, datë 19.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025, të Bashkisë Mallakastër”.

Urdhri i prokurimit është i vulosur në Degën e Thesarit Mallakastër në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154.

Me Urdhrin nr. 40, datë 11.10.2023, të z. F.SH me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është ngritur komisioni për përlogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe afatin e lëvrimin i përbërë nga z. E.Y kryetar i komisionit (Specialit Inxhinier Navigacioni në NSHP) dhe anëtarët z. E.H (Mekanik në NSHP), z. F.A (Përgjegjës Finance Bashkia Mallakastër), z. A.B (Shofer Policia Bashkiake në Bashkinë Mallakastër), z. Q.L (Shofer në NSHP).

Me shkresën nr. 124/1 prot., datë 12.10.2023, nr. 124/2 prot., datë 12.10.2023, nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur procesverbalet përkatëse ku janë hartuar specifikimet teknike, relacioni teknik dhe preventivi së bashku me analizën e çmimeve (për caktimin e çmimeve komisioni është bazuar në studimin e tregut bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, gërma “b”).

Ky dokumentacion është përcjellës me shkresën nr. 124/3 prot., datë 12.10.2023, pranë Bashkisë Mallakastër për nisjen e procedurës së prokurimit.

Me Urdhrin nr. 31, datë 20.11.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.M .

Me Urdhrin nr. 31, datë 20.11.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me fond limit në vlerën 8,072,770 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar”.

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 31, datë 20.11.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. E.Y me detyrë Specialist pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me profesion Inxhinier Navigacioni ka mbajtur procesverbalin e datës 21.11.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 21.11.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. E.Y , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 338, datë 20.11.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X , z. TH.GJ .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 04.12.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 05.12.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë s'kualifikuar të 2 OE pjesëmarrës.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "A" Shpk (me Nipt K...B) nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. OE "M" Shpk (me Nipt K...Ë) me vlerë ekonomike të ofertës **8,999,900 lekë pa Tvsh.**

Janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. OE "A" Shpk për mos plotësimin e kritereve si më poshtë:

-Për arsye se ka ngarkuar në SPE dokumenta as ofertë në emrin e tij. Në llogarinë e tij në SPE figurojnë të ngarkuara dokumenta të një subjekti tjetër.

2. OE "M" Shpk

-Për arsye se oferta ekonomike e paraqitur prej tij është mbi vlerën e fondit limit.

Me shkresën nr. 5772/3 prot., datë 05.12.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të anulimit. Me shkresën nr. 5772/4 prot., datë 13.12.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës i anulimit të Procedurës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 5772/5 prot., datë 13.12.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës për anulimin e procedurës.

B. RIFILLIMI I PROCEDURËS

Me Urdhrin nr. 366, datë 14.12.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për rifillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)" me fond limit në vlerën 8,072,770 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar". Në këtë urdhër cilësohet se **NjP dhe KVO do të jetë të njëjtës** sipas Urdhrit nr. 31, datë 20.11.2023.

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 366, datë 14.12.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. E.Y me detyrë Specialist pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me profesion Inxhinier Navigacioni ka mbajtur procesverbalin e datës 14.12.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 14.12.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F, z. E.Y, z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.2. Për të operuar me efikasitet lidhur me zbatimin e kontratës objekt prokurimi, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ambient/pikë servisi në një distancë jo më të largët se 30 kilometër nga qyteti i Ballshit, vërtetuar sipas adresës/adresave të pasqyruar/a në ekstraktin e QKB-së.

Lidhur me kriterin se operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient/pikë servisi jo më larg se 30 km, duke marrë shkas nga fakti se ky kriter mund të sjell kufizimin e pjesëmarrjes apo s'kualifikim e ofertuesve, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e tjera dhe mund të kenë një pikë servisi me distancë më të largët.

Konkluzion: Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", si dhe nenet 39 "Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike" dhe neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e

këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Y specialist i fushës në Njësinë e Prokurimit i cili më datë 14.12.2023, ka mbajtur procesverbalin për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 26.12.2023, i hapjes së procedurës së rishpallur nga ku ka rezultuar se 1 operatorë ekonomik ka marrë pjesë me vlerë ekonomike përkatëse të ofertuar.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 27.12.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së rishpallur për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga **OE “F” Shpk.**

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “F” Shpk (me Nipt K...I) me vlerë ekonomike të ofertës 7,750,500 lekë pa Tvsh.

Më datë 29.12.2024, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “F” Shpk. Me shkresën nr. 6117/3 prot., datë 03.01.2024, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 6117/4 prot., datë 04.01.2024, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 6117/5 prot., datë 04.01.2024, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “F” Shpk.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1710/1 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.Y në cilësinë specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me procedurën “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe NSHP)”:

Në pikën 2.3.2. të DST është përcaktuar kërkesa me përmbajtje:

“2.3.2. Për të operuar me efikasitet lidhur me zbatimin e kontratës objekt prokurimi, Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ambient/pikë servisi në një distancë jo më të largët se 30 kilometër nga qyteti i Ballshit, vërtetuar sipas adresës/adresave të pasqyruar/a në ekstraktin e QKB-së”.

Për këtë kërkesë është bërë edhe argumentimi përkatës si më poshtë:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim eliminimin e kostove të shtuara, operimin me shpejtësi dhe efikasitet, si dhe për të monitoruar sa më mirë zbatimin e kontratës”.

Sqarohet se ky kriter nuk është aspak kufizues, pasi brenda rrezes 30 km ushtrojnë aktivitetet në fushën e shërbimeve për mirëmbajtjen e automjeteve një numër i konsiderueshëm subjektësh. Grupet e mëparshme të auditimit nuk e kanë konsideruar si kriter kufizues këtë distancë, madje na kanë bërë me dije se shumica e autoriteteve kontraktore vendosin distanca edhe më të shkurtra, deri aty sa të jenë brenda qytetit.

Siç edhe është përcaktuar në argumentimin e dhënë më sipër, nëpërmjet kësaj kërkesë, përveç sa u përmend më sipër, synohet dhe i jepet fokus parimit të ekonomisë së kursimit.

Për më tepër, brenda kësaj rrezeje përfshihen qytetet Patos dhe Fier, ku përveç pjesës së brendshme të këtyre qyteteve, vlen të theksohet fakti se vetëm në aksin e rrugës nacionale Ballsh-Fier ka një numër jashtëzakonisht të madh subjektësh që ofrojnë shërbime për mirëmbajtjen e automjeteve.

Pra, kjo është një kërkesë normale, aspak kufizuese dhe tepër favorizuese për autoritetin kontraktor sa i përket minimizimit të kostos, operimin me shpejtësi dhe efikasitet, si dhe për të monitoruar sa më mirë zbatimin e kontratës.

Procedura është shpallur dhe zhvilluar normalisht dhe nuk ka pas rekomandime për heqje apo ndryshim kriteresh nga APP-ja, pra të gjitha kriteret e kësaj procedure janë konsideruar në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Mendoj se nuk mund të bëhet paralelizëm distancash për kontrata që nuk janë të së njëjtës natyrë (furnizimi dhe shërbimi), pasi kanë specifika të ndryshme. Kontrata e furnizimit me karburant është e shpeshtë, e vazhdueshme (ditor, javore) dhe ka kosto/konsum të shkosh shpesh herë në distanca të largëta, ndërsa kontrata e shërbimit të servisit të mjeteve nuk ka të njëjtën veçori.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me kriterin se operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient/pikë servisi jo më larg se 30 km, duke marrë shkas nga fakti se ky kriter mund të sjell kufizimin e pjesëmarrjes apo s'kualifikim e ofertuesve, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e tjera dhe mund të kenë një pikë servisi me distancë më të largët.

Theksojmë se, në lidhje me vendosjen e kriterit për distancat ju bëjmë se në rastin e parë 10 km mund të konsiderohet si distancë e largët largë ndërsa në rastin e dytë 30 km mund të quhet si distancë e afërët nga NjP, në opinionin e grupit të auditimit nuk qëndron për arsye se distanca është kufizim dhe penalizon operatorët ekonomikë që kanë pikë ushtrimi aktiviteti me distancë më të largët.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)” zhvilluar në vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër.

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 7, datë 12.04.2023.	2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Nr. 7, datë 12.04.2023. 1. B.F(Jurist/Personi Përgjegjës i Prokurimeve) 2. M.M (Inxhinier Ndërtimi) 3. F.A (Ekonomist)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 92, datë 12.04.2023. 1. E.B , Kryetar (Drejtor i Kabinetit) 2. A.XH , Anëtarë (Kryeinspektor IVMT, Inxhinier Ndërtimi) 3. TH.GJ , Anëtarë (Specialist/DAZH TLP)
5. Fondi Limit: 78,651,909 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: OE “LL ” Shpk me vlerë oferte 45,366,340 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 33,285,569 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 04.05.2023.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër + fonde nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 16 OE b) S'kualifikuar: 4 OE 1. BOE “G ” Shpk & “SH ” Shpk & “F ” Shpk; 2. OE “L ” Shpk; 3. BOE “A ” Shpk & “R ” Shpk; 4. BOE “T ” Shpk & “C ” Shpk; c) Kualifikuar: 12 OE 1. OE “LL ” Shpk; 2. OE “SH ” Shpk; 3. BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk; 4. BOE “RR ” Shpk & “D ” Shpk; 5. OE “S ” Shpk; 6. BOE “A ” Shpk & “K ” Shpk; 7. OE “B ” Shpk; 8. BOE “I” Shpk & “N ” Shpk; 9. OE “N” Shpk; 10. BOE “D ” Shpk & “RR ” Shpk; 11. OE “B ” Shpk; 12. OE “C ” Shpk;
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës: Nr. 1785/13 prot., datë 14.07.2023.	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 54,439,608 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”, janë siguruar fonde në vlerën totale **71,358,738 lekë** si rezultat i bashkë financimit nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër të miratuara me VKB-të respektive si më poshtë:

a. Me VKB-në nr. 70, datë 19.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025, të Bashkisë Mallakastër”, në vlerën 24,400,000 lekë sipas Tabelës nr. 4, Grupi 00, Programi 04520, Kodi i Institucionit 2131001, Kodi i Projektit 1310425;

b. Me VKB-në nr. 10, datë 21.02.2023, “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023”, në vlerën 10,519,130 lekë;

c. VKB-në nr. 64, datë 22.12.2023, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe Buxhetit të vitit 2024”, në vlerën 36,439,608 lekë;

Nga auditimi i fondeve të aprovuara për realizimin e kësaj procedure prokurimi konstatohet se, me VKB-në nr. 70, datë 19.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025, të Bashkisë Mallakastër” në të cilën është përfshirë edhe PBA-ja 2023-2025, në këtë dokument nuk përcaktohet afatet e parashikuara të likuidimit të ndara sipas viteve 2023-2024 për objektin e prokuruar (duke marrë në konsideratë faktin që realizimi i objektit që prokurohet përfshin periudhën 2023-2024) por është miratuar fondi 24,400,000 lekë.

Kësaj shume është shtuar financim shtesë në vlerën 10,519,130 lekë sipas VKB-së nr. 10, datë 21.02.2023, “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023” ku totali i financimit shkon në vlerën 34,919,130 lekë (totali i financimit përpara nisjes së procedurës së prokurimit) ndërkohë që vlera e prokuruar është 94,382,290.80 lekë me Tvsh pra me një diferencë në vlerën 59,463,160.80 lekë mungesë financimi deri në këtë fazë.

Referuar kontratës nr. 1785/13 prot., datë 14.07.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Mallakastër përfaqësuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë dhe fituesit OE “LL ” Shpk, afati i nisjes së punimeve është 5 ditë nga lidhja e kontratës.

Në nenin 9 “Grafiku i pagesës” të kontratës përcaktohet që: “Lidhur me pagesat, palët bien dakord që financimi i këtij objekti të kryhet gjatë viteve 2023-2024 (siç është parashikuar në Dokumentet e Tenderit) sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër VKB nr. 11, datë 21.02.2023, “Për miratimin e financimit të ndarë në dy vitet investime”. VKB nr. 11, datë 21.02.2023, i përket financimit të objektit të prokurimit konkretisht për vitin 2023 në vlerën 34,919,130 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 59,480,870 lekë. Financimi i cili i përket vitit 2024 nuk rakordon me VKB apo PBA-në 2024-2026. Vlera e kontratës të sipërpërmendur është 54,439,608 lekë me Tvsh ndërkohë që fondet e miratuara deri në momentin e lidhjes së kontratës kanë qenë të pa mjaftueshme me një diferencë në vlerën 19,520,478 lekë.

Përafërsisht pas një periudhe kohore prej 5 muajve pas nisjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktor janë miratuar fonde shtesë në vlerë 36,439,608 lekë ku totali i financimit shkon në vlerën 71,358,738 lekë me një diferencë më tepër nga vlera e përcaktuar në kontratën e punimeve në vlerën 16,919,130 lekë.

Vlen të theksohet që në PBA-në e 2024-2026 (duke marrë në konsideratë faktin që një pjesë e fondeve likuidohet përgjatë vitit 2024) të miratuar me VKB nr. 37, datë 24.07.2023, “Për miratimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” janë parashikuar fonde për likuidimin e kësaj kontrate për vitin 2023 në vlerën 34,919,130 lekë ndërsa për vitin 2024 vlerën 70,000,000 lekë ndërkohë që diferenca e vlerës së kontratës së mbetur për likuidim është 19,520,478 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku përcaktohet: “Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijëni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë

shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhërin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit”.

Në zbatim të VKB-së nr. 70, datë 20.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Mallakastër” (në të cilën është parashikuar realizimi i objektit “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”, nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik punonjës pranë Drejtorisë së Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçensave dhe Projekteve është hartuar dosja teknike miratuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Në dosjen e procedurës së prokurimit janë të përfshira:

- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;
- Relacionin teknik;
- Specifikimet teknike dhe projekt zbatimi;
- Analiza e çmimeve.

Për sa trajtuar më sipër preventivi është hartuar nga z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi dhe znj. B.V me profesion inxhinier hidroteknik dhe konfirmuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Nga verifikimit në internet është konstatuar se, z. M.M dhe znj. B.V nuk janë të pajisur me liçensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit⁶. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, ku përcaktohet që: “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçensën përkatëse”.

Me Urdhrin nr. 7, datë 12.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga z. B.F , z. M.M , z. F.M .

Me Urdhrin nr. 7, datë 12.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)” me fond limit në vlerën 78,651,909 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e Hapur”.

Hartimi i kritereve të DT:

Në zbatim të Urdhrit nr. 7, datë 12.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, z. M.M me profesion inxhinier ndërtimi ka mbajtur procesverbalin e datës 12.04.2023, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Më datën 12.04.2023, nga NjP e përbërë nga z. B.F , z. M.M , z. F.A është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në të cilën janë miratuar Dokumentet e Tenderit.

Më datë 19.04.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Mallakastër, rezulton se: Për procedurën me REF-65835-04-12-2023, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)” me fond limit 78,651,909 lekë pa Tvsh, ka sygjerruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Më datën 20.04.2023, nga z. M.M është mbajtur procesverbali mbi ndryshimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik. Me shkresën nr. 1785/3 prot., datë 20.04.2023, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit

⁶ <https://infrastruktura.gov.al/regjistrat-2/>

Publik, miratuar nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, ku është hartuar një shtojcë në Dokumentat e Tenderit.

Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtimit dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s'kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në këtë kriter nuk është përfshirë edhe detyrimi ligjor konkretisht, pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, gërma “c”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kontratë pune të vlefshme të paktën 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar, të pajisur me dëshmi/çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave ose të ketë marrëdhënie kontraktuale (kontratë të vlefshme) me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 45001:2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente**, konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci Autoritetit Kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën **45 (dyzetë e pesë) punonjës** të siguruar, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;

-Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e

shoqërisë për të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë;
- 2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 1 (një) teknik topograf, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 2 (dy) muratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë”;
- 4 (katër) punëtorë asfaltimi në rrugë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.7. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	1
6	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
7	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
8	Eskavator	Në pronësi ose me qira	2
9	Buldozer	Në pronësi ose me qira	1
10	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1
12	Fabrikë për prodhim asfalti	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
13	Impiant për prodhim betoni dhe inerte	Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi	1
14	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
15	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:

- Çertifikata e pronësisë;
 - Leja e qarkullimit;
 - Çertifikata e kontrollit teknik;
 - Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);
 - Leje/çertifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:
- Kontrata e qirasë;

-Çertifikata e pronësisë së qiradhënësit;

-Leja e qarkullimit;

-Çertifikata e kontrollit teknik;

-Polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);

-Leje/çertifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;

Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/akt-zhdoganimi/faturë tatimore/çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit e vlefshme.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore prej 45 (dyzetë e pesë) punonjës të siguruar, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.** Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për **pikën nr. 2.3.3, nr. 2.3.4, nr. 2.3.6, nr. 2.3.7,** (në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, mjetet/makineritë dhe pajisjet) nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, orëve të punës sipas analizës teknike të çmimeve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

4. Pika nr. 2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

1. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente;

2. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente;

3. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 ose ekuivalente

Çertifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente**, kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “Shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Për menaxhim mjedisi” ose ekuivalente**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 92, datë 12.04.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. E.B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.X , z. TH.GJ .

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 04.05.2023, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 16 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuar.

Më datën 16.05.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali mbi konstatimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, ku përcaktohet që: “Në rastin kur janë të vlefshme tri oferta ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme”, u kryen përlllogaritjet mbi vlerësimin si anomalisht të ulëta nga OE “LL ” Shpk dhe OE “SH ” Shpk si më poshtë:

		Lekë
Nr.	BOE/OE të kualifikuar	Vlera e ofertës
1	OE “LL ” Shpk	45,366,340
2	OE “SH ” Shpk	48,987.150
3	BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk	49,999,996
4	BOE “RR ” Shpk & “D ” Shpk	52,834,170
5	OE “S ” Shpk	55,719,350
6	BOE “A ” Shpk & “K ” Shpk	57,789,290
7	OE “B ” Shpk	59,971,600
8	BOE “T ” Shpk & “N ” Shpk	62,016,940
9	OE “N” Shpk	62,996,900

10	BOE "D" Shpk & "RR" Shpk	63,214,087
11	OE "B" Shpk	66,506,180
12	OE "C" Shpk	72,360,730
Totali		697,762,733

Përlllogaritja mbi vlerësimin e ofertave anomalisht të ulta: vlera e OE të kualifikuar 697,762,733 lekë/12 numri i OE të kualifikuar*0.85 = 49,424,860 lekë.

Me shkresën nr. 1785/4 prot., datë 16.05.2023, dhe shkresën nr. 1785/5 prot., datë 16.05.2023, AK Bashkia Mallakastër është drejtuar OE "LL" Shpk dhe OE "SH" Shpk me kërkesë për argumentimin dhe dokumentimin me prova shkresore dhe dhënien e sqarimeve për elementin/elementët e veçanta të ofertës.

-Me shkresën nr. 760 prot., datë 19.05.2023, administruar në Bashkinë Mallakastër me praktikën nr. 1785/6 prot., datë 19.05.2023, OE "LL" Shpk ka kthyer përgjigje duke dhënë informacion për ofertën anomalisht të ulët.

Në këtë dokument citohet se: "Lidhur me kërkesën tuaj më datë 16.05.2023, për argumentim të çmimeve të ofertuara, në përgatitjes jemi bazuar në sa më poshtë:

a. Në analizën e çmimeve të manualeve teknike, me një marzh fitimi të reduktuar.

b. Në ofertat e operatorëve ekonomikë lokalë, çka ndikon drejtëpërdrejtë në uljen e kostos për lëndët e para. Falë marrëdhënieve të gjata kontraktore me disa operatorë ekonomik, të shtrira në disa fushë veprime, kemi përfituar oferta me çmime të reduktuara nga tregu lokal lidhur me furnizimin me materiale. Përkatësisht në zërat e punimeve si:

1. Materiale inerte (rërë, çakëll, zhavor, çimento)

2. Materiale për lëndë të parë për punime asfaltike (binder, bitum, emulsion)

Theksojmë që të gjitha materialet dhe lëndët e para që do të furnizohen nga prodhues të licencuar lokal janë konform standardeve europiane dhe konform specifikimeve teknike dhe njëkohësisht të shoqëruara me certifikatë cilësie të secilit produkt. Për vlerësimin e analizave të çmimeve të ofertuara në ofertën tonë financiare janë përdorur si referencë çmimet e ofertuara nga grupi jonë i furnitorëve. Zërat të cilët janë përfshirë në preventivin e punimeve janë zëra të cilët janë përfshirë në Manualin Teknik të çmimeve të punimeve të ndërrimit dhe të analizave teknike të tyre të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Ofertuesi "LL" Shpk bazuar mbi normat e parashikuara në manualin e çmimeve ka rishikuar paraprakisht kostot vetjake të përlllogaritur si një mesatare e eksperiencave të mëparshme si edhe duke bërë sondazhe mbi çmimet që ofrohen në treg, apo duke konsideruar gjithë zhvillimet teknologjike të viteve të fundit, siç mund të përmendet efijensa në ndërrtimin e kallëpit të armaturës nëpërmjet paneleve të gatshëm me dimensione të përshtatshëm të cilat shoqëria jonë ka në zotërim, duke sjell rritje të rendimentit të punës në ndërrtim".

Për sa trajtuar më sipër bashkëlidhur shkresës (kthim përgjigje) të paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër nga OE "LL" Shpk nuk është paraqitur fatura tatimore e blerjes së materialeve të pretenduara, por paraqitet një ofertë e datës 01.05.2023, e OE "F" Shpk me Nipt L...D dhe ftesë ofertë e datës 01.05.2023, nga OE "A" Shpk. Mos paraqitja e dokumentacionit të pretenduar në shkresën kthim përgjigje, në opinionin e grupit të auditimit, nuk dokumentohet dhe argumentohet oferta anomalisht e ulët e ofertuar nga OE "LL" Shpk.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4, ku përcaktohet që: "Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesën e nenit 93, të LPP-së".

-Me shkresën e datës 17.05.2023, e cila ndodhet në dosjen e procedurës së prokurimit e pa protokolluar në Bashkinë Mallakastër OE "SH" Shpk ka kthyer përgjigje duke dhënë informacion për ofertën anomalisht të ulët.

Procesverbali i mbajtur nga KVO i datës 23.05.2023, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të operatorëve ekonomik pjesëmarrë, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 12 OE dhe s'kualifikuar 4 OE, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE "LL" Shpk.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “LL ” Shpk (me Nipt K...K) me vlerë ekonomike të ofertës **45,366,340 lekë pa Tvsh.**
2. OE “SH ” Shpk (me Nipt K...N) me vlerë ekonomike të ofertës **48,987,150 lekë pa Tvsh.**
3. BOE “G ” Shpk (me Nipt L...T) & “SH ” Shpk (me Nipt K...Ë) & “F ” Shpk (me Nipt K...C) me vlerë ekonomike të ofertës **49,000,000 lekë pa Tvsh.**
4. BOE “K ” Shpk (me Nipt L...E) & “C ” Shpk (me Nipt L...O) me vlerë ekonomike të ofertës **49,999,996 lekë pa Tvsh.**
5. BOE “RR ” Shpk (me Nipt K...H) & “D ” Shpk (me Nipt L...B) me vlerë ekonomike të ofertës **52,834,170 lekë pa Tvsh.**
6. OE “L ” Shpk (me Nipt L...F) me vlerë ekonomike të ofertës **54,021,530 lekë pa Tvsh.**
7. BOE “A ” Shpk (me Nipt M...L) & “R ” Shpk (me Nipt J...E) me vlerë ekonomike të ofertës **54,616,820 lekë pa Tvsh.**
8. OE “S ” Shpk (me Nipt J...Q) me vlerë ekonomike të ofertës **55,719,350 lekë pa Tvsh.**
9. BOE “A ” Shpk (me Nipt J...R) & “K ” Shpk (me Nipt J...Q) me vlerë ekonomike të ofertës **57,789,290 lekë pa Tvsh.**
10. OE “B ” Shpk (me Nipt J...V) me vlerë ekonomike të ofertës **59,971,600 lekë pa Tvsh.**
11. BOE “I” Shpk (me Nipt J...Ë) & “N ” Shpk (me Nipt L...L) me vlerë ekonomike të ofertës **62,016,940 lekë pa Tvsh.**
12. OE “N” Shpk (me Nipt K...I) me vlerë ekonomike të ofertës **62,996,900 lekë pa Tvsh.**
13. BOE “D ” Shpk (me Nipt K...J) & “RR ” Shpk (me Nipt L...U) me vlerë ekonomike të ofertës **63,214,087 lekë pa Tvsh.**
14. OE “B ” Shpk (me Nipt K...N) me vlerë ekonomike të ofertës **66,506,180 lekë pa Tvsh.**
15. BOE “T ” Shpk (me Nipt K...L) & “C ” Shpk (me Nipt J...K) me vlerë ekonomike të ofertës **65,883,710 lekë pa Tvsh.**
16. OE “C ” Shpk (me Nipt K...M) me vlerë ekonomike të ofertës **72,360,730 lekë pa Tvsh.**

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. BOE “A ” Shpk & “R ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-OE “A ” Shpk referuar deklaratës ë bashkëpunimit ka marrë përsipër për realizimin 79% të kontratës. Referuar dokumentacionit të publikuar në SPE ka paraqitur kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugës lidhëse Zharrës-Shën Maria” e lidhur me Shoqërinë “B ” në vlerën 19,473,417 lekë pa Tvsh dhe kontratën “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshat i Ri-Sheqishtë” e lidhur me Bashkinë Patos në vlerën 14,637,190 lekë pa Tvsh. Referuar dokumentacionit shoqërues të të dyja këtyre kontratave, si për datat e lidhjes së tyre, afatit të realizimit apo edhe investitorëve të ndryshëm, rezulton se ato janë kontrata të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të paraqiten bashkarisht në formularin e vlerësimit.

-Anëtari i BOE “R ” Shpk (pjesëmarrës në raportin 21% sipas deklaratës së bashkëpunimit) nuk plotëson pikat 2.3.6. dhe 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit minimalisht 1 punëtor asfaltimi në rrugë dhe 1 mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton, pasi për natyrën e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë është e domosdoshme që shoqëria të ketë punëtor asfaltimi dhe mjet transporti me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton.

2. BOE “G ” shpk & “SH ” Shpk & “F ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për mos paraqitje në SPE Formularin e Sigurimit të Ofertës sipas Shtojcës nr. 3.

3. OE “L ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar 1 punonjës teknik ndërtimi ndërkohë që në DT janë kërkuar 2 të tillë.

-Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar asnjë Rul me peshë mbi 15 ton ndërkohë që në DT janë kërkuar 2 të tillë.

4. BOE “T ” Shpk & “C ” Shpk për mos plotësimin e kriterëve si më poshtë:

-Për arsye se asnjë nga kontratat e paraqitura në SPE nuk është e ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi.

Më datë 29.05.2023, nga KVO është mbajtur procesverbali për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike nga ofertuesi i kualifikuar i pari OE “LL ” Shpk. Me shkresën nr. 1785/8 prot., datë 08.06.2023, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 1785/9 prot., datë 09.06.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 1785/12 prot., datë 04.07.2023, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e OE “LL ” Shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “LL ” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

1. Në pikën nr. 2.2.2. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Bilancet e paraqitura nga OE “LL ” Shpk për vitet 2020, 2021 dhe 2022 janë depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por **nuk është marrë konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.**

Për sa trajtuar më sipër OE “LL ” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte s’kualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues OE “LL ” Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s’kualifikimin e OE “LL ” Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “LL ” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, pika 4, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “LL ” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **45,366,340 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. B.F , z. M.M , z. F.A në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. E.B , z. A.X , z. TH.GJ në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1712 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. B.F Person Përgjegjës për Prokurimin NjP dhe z. F.A anëtar i Njësisë së Prokurimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (segmenti Panahor-Subashaj) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (segmenti depo e ujit-shkolla)”, “Blerje karburant (Diezel) viti 2023” (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike), “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratar”, Damës, Mallakastër” dhe “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagjja Tabakaj), rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës”.

Pasi u njohëm me Projekt Raportin e Auditimit, riparaqesim edhe një herë objeksionet tona për aq sa na takon në procedurat që kemi marrë pjesë.

Legjislacioni i prokurimit publik ka parashikuar dhe ka bërë një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi që kanë personat që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik. Konkretisht në pikën 3, të nenit 57, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet qartësisht detyrat e personit përgjegjës për prokurim.

Ndërsa në pikën 2, të nenit 61, të VKM nr. 914, përcaktohet qartësisht detyrat e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, detyra e të cilit lidhet me hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, të cilat argumentohen dhe dokumentohen me procesverbal dhe i vihen në dispozicion personit përgjegjës për prokurimin për t'i bërë pjesë të dosjes së tenderit.

Thujse në të gjitha procedurat e zhvilluara nga ana jonë është vendosur kërkesa lidhur me paraqitjen e bilanceve, e konkretisht e përcaktuar si më poshtë:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiar (2020, 2021, 2022) të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë ka edhe argumentimin përkatës të pasqyruar në DT si më poshtë:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Lidhur me këtë kërkesë, ju keni cituar:

Në këtë kriter nuk është përfshirë edhe detyrimi ligjor konkretisht, pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Sa i përket mospërfshirjes në kërkesën për bilancet edhe të akt-ekspertizës së ekspertit kontabël të autorizuar, ju bëjmë me dije se kërkesa për bilancet jo domosdoshmërisht mund të kërkohej, pasi vetë legjislacioni i prokurimit publik e lë në diskrecion të AK vendosjen ose jo të saj.

Konkretisht, në paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Pra, siç shihet, ky përcaktim i bërë nga legjislacioni i prokurimit publik limitohet deri këtu, pa shkuar më tej me plotësimin ekstra, e që për më tepër është i shoqëruar me togfjalëshin “mund të kërkojnë” dhe jo duhet të kërkojnë.

Në fakt, thelbi i kësaj kërkesë, gjithmonë nëse vendoset nga autoritetet kontraktore, është mospasja e raporteve negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit për dy vite të njëpasnjëshme, gjë e cila reflektohet edhe në argumentimin e kërkesës.

Mosvendosja e akt ekspertizës së ekspertit kontabël të autorizuar, nuk e bën aspak të cënueshme pjesëmarrjen në garë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Përkundrazi, e bën atë më të lirë për të marrë pjesë, pasi kërkohen më pak dokumente.

Mosvendosja e akt ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar, nuk e bën këtë kriter as të paligjshëm dhe as të pavlefshëm dhe për më tepër nuk e kufizon aspak pjesëmarrjen e OE.

Sa më sipër, mendojmë se nuk kemi asnjë përgjegjësi për pjesën që ma përket në cilësinë e anëtarëve të NjP si person përgjegjës për prokurimin dhe anëtar i NjP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër është detyrim ligjor që pasqyrat financiare duhet të jenë të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimit të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, gërma “c”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Projekt Raportit të Auditimit.**

Për sa i përket pretendimit nga ana Juaj në lidhje, se kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga specialisti i fushës dhe nga pjesa e tjetër e NjP-së është vendosur vetëm kriteri për paraqitjen nga OE rë pasqyrave financiare ju bëjmë me dijeni se, **observacioni për këtë çështje merret në konsideratë pjesërisht dhe do të kryhen reflektimet përkatëse në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit duke mos ju ngarkuar me përgjegjësi në procedurën me objekt “Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023” dhe “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”. Ndërsa për 4 procedurat e tjera Ju jeni ngarkuar me përgjegjësi për vendosjen e kriterit jo sipas parashikimeve ligjore në lidhje kërkesën mbi pasqyrat financiare, trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raportin Përfundimtar të Auditimit.**

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1750 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. E.B , z. A.X dhe TH.GJ anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: KVO ka vlerësuar të plotësuar këtë kriter nga “LL ” Shpk pasi në datën e zvillimit të prokurimit OE ka dorëzuar në SPE tre bilancet e kërkuara në pikën nr. 2.2.2, të DT, dhe më konkretisht:
-Bilanci i vitit 2020 është i vulosur dhe i firmosur nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
-Bilanci i vitit 2021 është i vulosur dhe i firmosur nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
-Bilanci i vitit 2022 është i vulosur dhe i firmosur nga Sekretaria e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
Pra sa më sipër bilancet e dorëzuara në SPE për objektin e prokurimit të mësipërm, janë dorëzuar të konfirmuara nga DT Fier.

Në kërkesën nr. 2.2.2, të DT nuk kërkohet konfirmimi me shkresë dhe me vulë nga DT, por konfirmimi i bilanceve nga Administrata Tatimore, që do të thotë se bilancet e dorëzuara në SPE janë ato të dorëzuara në Drejtorinë Tatimore. Gjithashtu theksojmë se këto bilance janë kërkuar nga AK për të verifikuar ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu këto bilance janë të dorëzuara edhe në QKB të cialt janë lëhtesisht të verifikueshme.

Sa më sipër KVO vlerëson se OE e ka përmbushur këtë kriter dhe se vlerësimi është bërë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. KVO vlerëson se OE “LL ” Shpk, me NIPT K...K me dokumentacionin e paraqitur, vërteton se është në përputhje me kërkesat për kualifikim dhe vlerësuar se Oferta e tij është në përputhje me një ofertë më të mirë ekonomike-teknike.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pasqyrat financiare për vitet 2020-2022, të OE “LL ” Shpk të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik mbajnë vulën e Sekretarisë së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier pra vula vërteton se këto pasqyra janë depozituar duke marrë edhe numrin e protokollit të depozitimit të DRTF, ndërsa konfirmimi i pasqyrave kryhet në formë shkresore nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve sipas Tatim Paguesit përkatës.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1741 prot., datë 15.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. M.M Specialist i Fushës në Njësinë e Prokurimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në observacion janë paraqitur të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim për objektin “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (segmenti Panahor-Subashaj) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (segmenti depo e ujit-shkolla)”; “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj), rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës”; “Ndërrhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër; të cilat janë pjesë e Dokumenteve të Tenderit së bashku me argumentimet përkatëse për secilën kërkesë....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana Juaj ju bëjmë me dije se, në thelb nuk kundërshtoni problematikën e ngritura nga grupi i auditimit por keni paraqitur procesverbalin mbi argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Të gjitha problematikën e ngritura nga grupi i

auditimit për secilin kriter sipas procedurave përkatëse i gjeni të trajtuara në mënyrë të hollësishme në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për zbatimin e dispozitave ligjore mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik të blerjeve me vlera të vogla.

a. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër ka realizuar në total 29 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 13,026,184 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 10,417,436 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje nga 29 procedura të realizuara me fond limit 13,026,184 lekë pa Tvsh janë audituar 15 procedura me fond limit 10,239,248 lekë pa Tvsh ose në masën 78.6% të vlerës totale të fondit limit, ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Refeuar procedurave të realizuara nga Bashkia Mallakastër dhe të publikuara në Sistemin Prokurimit Elektronik për vitin 2023 në dy raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëruar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim konkretisht:

-Procedura me objekt “Blerje materiale kancelarie” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “Blerje tonera për fotokopje dhe printera” me fond limit 833,333 lekë pa Tvsh ku totali i fondit limit shkon 1,833,333 lekë pa Tvsh dhe të dyja procedurat i përkasin objektit materiale kancelarie.

-Procedura me objekt “Blerje produkte shtazore (Nevoja për çerdhe dhe kopsht)” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “Blerje ushqime për kopshtin dhe çerdhen Ballsh” me fond limit 833,333 lekë pa Tvsh ku totali i fondit limit shkon 2,000,000 lekë pa Tvsh dhe të dyja procedurat i përkasin objektit blerje ushqime.

-Në 6 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla është hartuar një preventiv i cili i referohet studimit të tregut por në këtë dokument nuk evidentohet ku janë marrë ofertat për studimin e tregut.

-Në 5 raste nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.

-Në 15 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit.

-Në 3 raste në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë), pra kalimi nga një operatorë ekonomik tek tjetri në rastet e s’kualifikimit apo të tyre.

-Në 6 raste fatuarat tatimore nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 1 rast për procedurën e prokurimit me objekt “Transport i veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve” viti 2023 me fond limit 471,000 lekë me operatorë ekonomik të shpallur fitues “E.-B.” me vlerë oferte 400,000 lekë pa Tvsh, nuk disponohet një procesverbal i cili duhej të mbahej nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla ku bashkëlidhur të evidentohet lista e nënshkruar nga të gjithë personat që kanë marrë këtë shërbim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. A.R , z. N.S , z. A.M , znj. A.M , znj. M.SH në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla sipas periudhave respektive, z. I.Y , z. A.Z , znj. L.Z , z. H.L , znj. N.D , z. F.M , znj. Z.A , në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për Përllogaritjen e Fondit Limit.

b. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka realizuar në total 7 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 4,436,710 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 3,720,125 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje nga 7 procedura të realizuara me fond limit 4,436,710 lekë pa Tvsh janë audituar 5 procedura me fond limit 3,781,358 lekë pa Tvsh ose në masën 85.2% të vlerës totale të fondit limit, ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Në 1 rast nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla është hartuar një preventiv i cili i referohet studimit të tregut por në këtë dokument nuk evidentohet ku janë marrë ofertat për studimin e tregut.

-Në 3 raste nuk dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 3 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit.

-Në 1 rast në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë), pra kalimi nga një operatorë ekonomik tek tjetri në rastet e s'kualifikimit apo të tyre.

-Në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë për procedurën “Blerje materjale elektrike dhe hidraulike” viti 2023 me fond limit 799,972 lekë pa Tvsh dhe “Blerje veshje për punonjësit” viti 2023 me fond limit 799,550 lekë pa Tvsh.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.V , z. V.M , z. F.SH Drejtorë të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor sipas periudhave respektive dhe **znj. N.O , znj. E.T, z. A.S** në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimeve me Vlera të Vogla.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56, pika 1, 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36 dhe 42, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 7 dhe pikat 11-12.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1760 prot., datë 16.04.2024, nr. 1788 prot., datë 17.04.2024, nr. 1789 prot., datë 17.04.2024, nr. 1790 prot., datë 18.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga znj. N.D , z. F.M , znj. Z.A z. I.Y , z. A.Z , z. L.Z , znj. A.M , znj. M.SH , z. A.M dhe z. H.L anëtarë të Komisionit të Prokurimeve me Vlera të Vogla ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur observacionet e mësipërme kanë të bëjnë meargumentat mbi përlllogaritjen e fondit limit, kriterëve të veçanta dhe specifikimeve të publikuara në SPE, urdhrat për ngritjen e komisioneve për marrjen në dorëzim të mallrave, për mos respektimin e afateve në SPE nga kalimi tek një OE tek tjetri. Për arsye se observacionet e paraqitura nga Ju janë voluminoze nuk janë shkruar përmbajtja e tyre sipas shkresave por është bërë një përmbledhje e shkurtër më sipër, ndërsa kthimi i përgjigjes nga grupi i auditimit mbi observacionin është trajtuar sipas çdo shkrese në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1760 prot., datë 16.04.2024, ju bëjmë me dije se:

*Për sa i përket procedurës së prokurimit me objekt “Transport i veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve” viti 2023 me fond limit 471,000 lekë me operatorë ekonomik të shpallur fitues “E” me vlerë oferte 400,000 lekë pa Tvsh, ju bëjmë me dije se në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36, shprehet qart se cilat janë dokumentet justifikues për të vërtetuar shpenzimin dhe një prej tyre është edhe procesverbali i realizimit të këtij shërbimi. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.***

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1788 prot., datë 17.04.2024, ju bëjmë me dije se:

*Në përlllogaritjen e fondit limit kur kryhet me anë të metodës “Studim tregu” pjesë e procesverbalit duhet të jenë edhe treguesit e çmimeve të operatorëve ekonomikë tek të cilët është marrë oferta ekonomike. Në të gjitha rastet e konstatuara kjo problematikë në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla në Bashkinë Mallakastër ndodhet një preventiv çmimesh por nuk dokumentohen treguesit e çmimeve duke u bërë edhe mesatarja e tyre për të dal në konkluzionin përfundimtar për përlllogaritjen e fondit limit. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.***

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1789 prot., datë 17.04.2024, ju bëjmë me dije se:

Së pari: Në përlllogaritjen e fondit limit kur kryhet me anë të metodës “Studim tregu” pjesë e procesverbalit duhet të jenë edhe treguesit e çmimeve të operatorëve ekonomikë tek të cilët është marrë oferta ekonomike. Në të gjitha rastet e konstatuara kjo problematikë në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të

vogla në Bashkinë Mallakastër ndodhet një preventiv çmimesh por nuk dokumentohen treguesit e çmimeve duke u bërë edhe mesatarja e tyre për të dal në konkluzionin përfundimtar për përlllogaritjen e fondit limit. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Së dyti: Në asnjë rast për të gjitha problematikat e konstatuara nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla në Bashkinë Mallakastër, grupi i auditimit nuk shprehet se nuk ka specifikime teknike apo kritere të veçanta të pranimit të publikuara në SPE, por në sistem nuk është publikuar procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Së treti: Referuar udhrave të paraqitura në observacion për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të mallrave konkretisht Urdhrin nr. 344, datë 22.11.2023, me objekt “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të materialeve sipas procedurës me objekt “Blerje tonera për fotokopje dhe printera”, **observacioni merret në konsideratë dhe do të kryhen reflektimet përkatëse në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

Së katërti: Për sa i përket vonesave për tejkalimin e afatit 30 ditor për likuidim, është një problematikë e cila nuk ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Prokurimeve me Vlera të Vogla.

Së pesti: Grupi i auditimit nuk referohet tërheqjes së operatorit ekonomik, por mos respektimi i afatit të kalimit nga një OE tek tjetri dhe konkretisht për procedurën e prokurimit. Gjithashtu edhe për problematikën e konstatuar se në një rast OE është njoftuar dy herë në SPE, Ne i referohemi të dhënave të publikuara në sistem. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1790 prot., datë 18.04.2024, ju bëjmë me dije se:

Në përlllogaritjen e fondit limit kur kryhet me anë të metodës “Studim tregu” pjesë e procesverbalit duhet të jenë edhe treguesit e çmimeve të operatorëve ekonomikë tek të cilët është marrë oferta ekonomike. Në të gjitha rastet e konstatuara kjo problematikë në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla në Bashkinë Mallakastër ndodhet një preventiv çmimesh por nuk dokumentohen treguesit e çmimeve duke u bërë edhe mesatarja e tyre për të dal në konkluzionin përfundimtar për përlllogaritjen e fondit limit. Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

1. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës “Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush”.

Objekti i kontratës “Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush” me nr. REF-34714-06-28-2022, me nr. 3408/9 prot., datë 27.09.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, e përfaqësuar nga z. Z.M person i autorizuar me porosi të titullarit dhe Kontraktorit OE “C ” Shpk, përfaqësuar nga Administrator z. A.P . Vlera e kontratës është 109,498,855.68 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 (shtatë) muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4471/2 prot., datë 21.09.2022, midis AK Bashkia Mallakastër dhe Mbikëqyrësit “D ” Shpk me përfaqësues Administrator z. N.XH , me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 2010/6. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 01.10.2022. Procesverbali i piketimit të objektit dhe njoftimi i fillimit të punimeve, janë realizuar më datë 01.10.2022. Kanë ndodhur dy zgjatje afati të kontratës respektivisht me 1 (një) dhe 3 (tre) muaj. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 30.08.2023. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur mes palëve më datë 30.08.2023.

-Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, si dhe rikontrollit në terren pas takimit ballafaques në KLSH u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:

1. Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorush” dhe segmentin “Diga e Rezervuarit-Kutë” u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës. Sipas detajit teknik në projektin e

zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm; në terren ky përcaktim nuk është respektuar në disa pjesë të rrugës.

-Sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave për segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorrush” sasia totale e zërave “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makieri” dhe zërit “Shtresë asfaltobetonit me grani gur kave 4 cm, me makineri” është raportuar 17,550 m² binder dhe 17,550 m² asfalt.

$17,550 \text{ m}^2 \text{ asfalt} * 930 \text{ lekë/m}^2 = 16,321,500 \text{ lekë}$

$17,550 \text{ m}^2 \text{ binder} * 1080 \text{ lekë/m}^2 = 18,954,000 \text{ lekë}$

$16,321,500 \text{ lekë} + 18,954,000 \text{ lekë} = 35,275,500 \text{ lekë}$ pa Tvsh, kësaj vlere i zbritet 30% për shkak zvogëlimit të lartësisë totale (binder + asfalt) nga 10 cm sipas projektit në 7 cm sipas mesatares së matjeve të kryera në terren.

Pra kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit të punimeve dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik 30% * 35,275,500 lekë pa tvsh = 10,582,650.00 lekë pa Tvsh.

-Sipas preventivit të rishikuar për segmentet rrugore “Diga e Rezervuarit-Kutë” sasia totale e zërave “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makieri” dhe zërit “Shtresë asfaltobetonit” është raportuar 9,243 m² binder dhe 9,243 m² asfalt.

$9,243 \text{ m}^2 \text{ asfalt} * 930 \text{ lekë/m}^2 = 8,595,990 \text{ lekë}$

$9,243 \text{ m}^2 \text{ binder} * 1,080 \text{ lekë/m}^2 = 9,982,440 \text{ lekë}$

$8,595,990 \text{ lekë} + 9,982,440 \text{ lekë} = 18,578,430 \text{ lekë}$, kësaj vlere i zbritet 10% për shkak zvogëlimit të lartësisë totale (binder + asfalt) nga 10 cm sipas projektit në 9 cm sipas vlerës mesatare së matjeve të kryera në terren.

Pra kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit të punimeve dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik 10% * 18,578,430 lekë = 1,857,843 lekë pa Tvsh.

Në total për segmentet rrugore “Diga e Rezervuarit-Çorrush” dhe “Diga e Rezervuarit-Kutë” për zërat “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makieri” dhe zërin “Shtresë asfaltobetonit” vlera e dëmit ekonomik shkon **12,440,493 lekë pa Tvsh.**

2. Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Kutë” dhe “Diga e Rezervuarit-Çorrush” u vunë re disa çedime në rrugë në disa pjesë të sajë me një sipërfaqe totale 50 m², të cilat kanë efektin ekonomik **128,100 lekë pa Tvsh.**

3. Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorrush” në disa pjesë të tijë u vu re se nënshtresa e rrugës nuk ishte realizuar me mbushje me çakëll 30 cm sipas projektit; por ajo ishte realizuar 10 cm në një gjatësi rreth 150 ml me efekt ekonomik **99,750 lekë pa Tvsh.** Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **12,668,343 pa Tvsh** (12,440,493 + 128,100 + 99,750), e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “C” Shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa trajtuar më sipër situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 3.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Mbikëqyrësi i Punimeve me përfaqësues Administrator z. N.XH .

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Mbikëqyrësi i punimeve administrator Ing. Z. N.XH i OE “D”, me datë 16.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/11 prot., datë 18.04.2024, si dhe nga Kontraktori i punimeve OE “C” Shpk me datë 18.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/12 prot., datë 19.04.2024, shprehen pretendimet e tyre për projekt raportin e auditimit për objektin e mësipërm:

Pretendimi i subjektit: Mbikëqyrësi dhe Kontraktori i punimeve, sqarojnë se:

-Në lidhje me mungesën në dojse të librezave të masave të situacioneve pjesore “...ato janë dërguar pranë autoritetit kontraktor në rrugë postare/protokollare në varësi të situatave dhe është detyrë e autoritetit kontraktor që të administrojë...”.

-Në lidhje me mungesën e amendamentit të parë në dosje “ ...nuk mund të japim shpjegim pse nuk gjendet në dosje...bashkëngjitur gjeni kopjo të këtij Amendamenti”.

-Në lidhje me mungesën e projektit të zbatimit në dosjen “...nuk dimë të themi se çfarë është administruar dhe vënë në dispozicion grupit auditues nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër... bashkëngjitur gjeni kopjo të këtij projekt zbatimi”.

-Në lidhje me mungesën e shkresave të Kontraktorit dhe Mbikqyrësit për rishikimin e preventivit “...nuk mund të japim shpjegim pse nuk administrohet në dosje.. bashkëngjitur gjeni gjeni kopjo të shkresave mbi kërkesën për rishikim të preventivit fillestar”.

-Në lidhje me devijimet nga projekti i tenderuar “...Ky projekt ka qenë i fragmentarizuar në lote për shkak të pamundësisë së fondeve të vëna në dispozicion që të përmbylej i gjithë projekti.... Gjatë fragmentarizimit të projektit në lote segmenti “Diga e Rezervuarit-Çorrush” gabimisht ishte lënë segmenti me popullësi më të madhe e pa përfshirë në këto rehabilitime dhe... zgjatja e këtij segmenti është kryer me kërkesë të AK ...”.

-Në lidhje me mos respektimin e detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës ...” kemi ndjekur si vizualisht ashtu dhe me matje sporadike aq sa të lejon dhe procesi i asfaltimit gjatë fazës së aplikimit të shtresave rrugore asaj binder dhe asfaltobeton.... është kyerr karrotazhi në disa progresiva ... dhe na ka rezultuar në mesataren e tyre sipas projektit K.T.Z dhe gabimeve të lejuara për këto tipe procesesh. ... Bashkëngjitur gjeni kopjo të testeve të kryera në këto segmente dhe foto gjatë marrjes së këtyre kampjoneve”.

-Në lidhje me çedimet në rrugë “Jemi në dijeni të këtij fenomeni pasi kemi bërë dhe riparime të tjera Nuk mund të konsiderohet dëm ekonomik për sa kohë që objekti është në fazën 24 mujore të garancisë së punimeve”.

-Në lidhje me mos realizimin e shtresës së çakëllit “...janë nxjerrë kuotat nga topografi i firmës zbatuese dhe pasi janë kontrrolluar me projektin e miratuar është bërë mbushja dhe nivelimi ... duke qenë punime për të cilat nuk ka ndonjë laborator të specializuar për matjen e trashësisë së këtyre shtresave ose ne nuk jemi në dijeni ku mund të realizohet ky testim pa dëmtuar shtresat e tjera rrugore... kërkojmë që argumentet tona të merren parasysh”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Mbikqyrësi dhe Kontraktori në observacion, sqarojmë se:

-Në lidhje me mungesat e dokumentave në dojsen tekniko-ligjore si:

1. Librezave të masave të situacioneve pjesore,
2. Amendamentit të kontratës,
3. Projektit të zbatimit,
4. Shkresave për rishikimin e projekt/preventivit.

Mund të themi se administrimi i dokumentacionit dhe korrespondencës ndërmjet palëve nuk është vetëm detyrë e Autoritetit Kontraktor pasi çdo dokument si dhe dosja tekniko-ligjore duhet mbajtur në 3 kopje respektivisht nga 1 kopje për Autoritetin Kontraktor, Kontraktorin dhe 1 kopje për Mbikqyrësin.

-Në lidhje me mos respektimin e detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës tek projekti i zbatimit (asfalt+binder në total 10 cm) sqarojmë se:

Gjatë vizitës fillestare në terren më datë 08.02.2024, u kryen verifikime në disa progresiva të rrugëve të objektit dhe u vu re se nuk ishin respektuar përcaktimet e shtresave rrugore (asfalt + binder në total 8 cm). Më pas u njohëm me dokumentacionin teknik shtesë të paraqitur në observacione si testet laboratorike nga laborator “ A ” Shpk dhe karrotazhet e shtresave asfaltike të shoqëruara dhe me material fotografik, të cilat mungonin fillimisht në dosjen tekniko-ligjore; sipas materialeve të sjella nga ana e laboratorit citohet se: “shtresa totale (asfalt + binder është në total 10 cm) dhe karrotazhet plotësojnë kushtet dhe përcaktimet në detajet teknike të projektit”.

-Më datë 02.05.2024 është zhvilluar Takimi Përmbyllës në ambientet e KLSH ndërmjet grupit të auditimit dhe strukturave drejtuese të KLSH-së si dhe përfaqësuesi i OE “C ” Shpk z. A.L . Nga ana e përfaqësuesit të OE “C ” Shpk janë ngritur pretendimet mbi korrigjimin e akt konstatimit dhe se karrotazhet e sjella nga laborator plotësojnë kushtet dhe përcaktimet në projekt. OE “C ” Shpk gjatë takimit ka bërë kërkesë për kryerjen e testeve të reja me qëllim evidentimin e saktë të shtresave në këto dy segmente rrugore.

-Më datë 16.05.2024 u vendos të kryhej rikontrolli i punimeve në terren për të verifikuar pretendimet e Kontraktorit me pjesmarrës: përfaqësuesit e Kontraktorit OE “C ” Shpk z. A.L dhe përfaqësuesit e KLSH-së z. K.GJ Drejtor i Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, z. M.H Përgjegjës i Grupit dhe z. A.S anëtarë i grupit të auditimit (audituesit që ka trajtuar çështjen). Në këtë verifikim nuk morën pjesë mbikqyrësi i punimeve OE “D ”shpk dhe laborator “ A ”shpk Shpk edhe pse ishin njoftuar zyrtarisht nëpërmjet përfaqësuesve të Bashkisë Mallakastër. Pasi u kryen një sërë matjesh në terren rezultoi se

mesatarja e matjeve për shtresat rrugore (asfalt+binder në total shkon 9 cm). Rezultatet e këtij rikontrrolli nuk u pranuan nga ana e Kontraktorit OE “C” shpk me argumentimin se matjet u kryen pa pjesëmarrjen e laboratorit.

-Më datë 28.05.2024 u vendos të kryhej rikontrrolli i punimeve në terren për të verifikuar prentedimet e Kontraktorit me pjesëmarrës: Mbikqyrësi i punimeve punimeve OE “D” Shpk, përfaqësuesit e Kontraktorit OE “C” Shpk z. A.L , përfaqësuesi i Bashkisë Mallakastër z. A.X , Laboratori “A” Shpk përfaqësuesit e KLSH-së z. K.GJ Drejtor i Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, z. M.H Përgjegjës i Grupit dhe z. A.S anëtarë i grupit të auditimit (audituesit që ka trajtuar çështjen). Pasi u kryen disa karrotazhe në terren rezultoi se mesatarja e matjeve laboratorike për shtresat rrugore për rrugën “Diga e Rezervuarit-Çorrush” (asfalt+binder në total shkon 7 cm) dhe për rrugën “Diga e Rezervuarit-Kutë” (asfalt+binder në total shkon 9 cm). Rezultatet e këtij rikontrrolli të kryer nga laboratorit u firmosën me procesverbal të mbajtur në vend nga: Kontraktori OE “C” Shpk, Mbikqyrësi OE “D” Shpk, Laboratori “A”shpk, përfaqësuesi i Bashkisë Mallakastër dhe përfaqësuesit e KLSH-së.

-Në lidhje me çedimet në rrugë dhe me mos realizimin e shtresës së çakëllit observacionet e sjella nuk janë të shoqëruara me dokumentacion teknik argumentues nuk sjellin fakte të reja dhe nuk kanë mbështetje teknike-ligjore, rrjedhimisht observacionet për to nuk merren në konsideratë. Gjithashtu edhe pas rikontrrollit të kryer në datën 16.05.2024, Kontraktori u bind mbi faktin e pranisë së çedimeve në rrugë të cilat ishin ende evidente.

2. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës “**Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj**”.

Objekti i kontratës “Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj” me nr. REF-35560-07-06-2022, me nr. 3486/13 prot., datë 05.10.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, e përfaqësuar nga z. Z.M person i autorizuar me porosi të titullarit dhe Kontraktorit OE “S” Shpk, përfaqësuar nga Administrator z. L.S . Vlera e kontratës është 129,202,020 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 (shtatë) muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr. 4472/2 prot., datë 21.09.2022, midis AK Bashkia Mallakastër dhe Mbikëqyrësit “M” Shpk me përfaqësues Administrator z. M.A , me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 3752/3. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 24.10.2022. Procesverbali i piketimit të objektit dhe njoftimi i fillimit të punimeve, janë realizuar më datë 24.10.2022. Ka ndodhur një zgjatje afati të kontratës respektivisht me 45 ditë, amendament i cili nuk ndodhet në dosjen tekniko-ligjore. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga kontraktori dhe mbikëqyrësi më datë 07.07.2023.

-Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:

1. Në segmentin rrugor fshati Dukas u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës në (Segmentin 3’). Sipas detajit teknik në projektin e zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm. Në terren ka ndodhur një shmangie nga projekti i zbatimit, u vu re se ishte realizuar vetëm shtresa binder me një lartësi totale 6 cm dhe jo shtresa e asfaltit, duke patur efektin ekonomik 656,640 lekë pa Tvsh. 2. Nga kontrolli në terren dhe i dokumentacionit tekniko-ligjor të dosjes së objektit pjesa “Materiali fotografik për punimet e kryera në objekt” u vu re se muret mbajtëse ishin kryer duke mos respektuar vizatimet teknike, nga dy fije vertikale shpërndarëse në projekt në një fije shpërndarëse vertikale; duke patur një efekt ekonomik 227,500 lekë. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **884,140 lekë pa Tvsh** (656,640 lekë + 227,500 lekë) e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “S” Shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa trajtuar më sipër situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi” i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Mbikëqyrësi i Punimeve me përfaqësues Administrator z. M.A .

3. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)”.

Objekti i kontratës “*Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)*”, me nr. 777/7 prot., datë 06.07.2021, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga titullari i sajë z. Q.I dhe Kontraktorit BOE“*A* ” Shpk & “*E* ” Shpk & “*K* ” Shpk, përfaqësuar nga Administratorët e Shoqërive z. N.Ç , z. A.I dhe z. Q.K . Vlera e kontratës 568,485,331.72 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 11 muaj, për këtë objekt ka ndodhur një zgjatje afati e kontratës me 8 muaj. Në amendamentin e kontratës përcaktohet se afati i ri i përfundimit të punimeve është data 12.02.2023; ndërsa përfundimi faktik i punimeve është kryer në datë 13.06.2023 pra kemi rreth 4 muaj vonesë nga amendamenti i kontratës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 790/8/ prot., datë 09.06.2021, midis AK Bashkia Mallakastër dhe Mbikqyrësit BOE “*G* ” Shpk & “*I* ” Shpk, me përfaqësues administrator z. G.B me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 2812/4. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 12.07.2021. Procesverbali i piketimit të objektit dhe njoftimi i fillimit të punimeve, janë realizuar më datë 12.07.2021. Njoftimi i përfundimit të punimeve nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nuk ndodhen në dosjen tekniko-ligjore të objektit. Data e përfundimit të punimeve 13.06.2023, përmendet vetëm në relacionin përfundimtar të mbikqyrësit.

-Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:

1. Për zërin e punës “*F.V.Tub cel. Ø(355.6 x δ=8,5)mm i h/izoluar ne fabrike L= 5710m*” ka një pasaktësi në llogaritjen e peshës së tubit të çelikut. Kontraktori këtë zë e ka raportuar 429.91 ton ndërsa sipas llogaritjeve analitike referuar skedës teknike të prodhuesit ky zë shkon 392.91 ton; pra kemi një diferencë me efekt financiar prej 6,232,650 lekë pa tvsh. **2.** Referuar kapitullit “*Depo 200 m³*” në situacionin përfundimtar kemi futjen e disa zërave të rinj pune midis tyre kemi dhe zërin “*F.V.Mates E.M. Dn 300mm PN-40*” me çmimin 996,072 lekë/copë. Po të shihet me vëmendje ky zë pune ekziston në preventivin e ofertuar fitues të tenderit me çmimin 779,984 lekë/copë. Ky zë i ri me çmimin 996,072 lekë/copë nuk duhet të ishte pranuar në preventivin e rishikuar si nga ana e Mbikëqyrësit dhe nga ana e AK. Pra kemi një diferencë e që ka një efekt financiar 432,167 lekë pa tvsh. **3.** Referuar kapitullit “*Tubacionet e transmetimit*” në situacionin përfundimtar zëri “*F.V.Stafe EF Dn (350 x110)mm*” është raportuar 24 copë ndërsa në librezën e masave ky zë është raportuar 10 copë. Pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 219,856 lekë pa tvsh. **4.** Referuar kapitullit “*Fuqia puntore Kabina*” zëri i punës “*Montim Transformatori fuqie 750kVA, 20/0.4kV*” në situacionin përfundimtar është raportuar 30 copë, ndërkohë tek pjesa e pajisjeve ky zë është lënë 0 sepse transformatorët janë vendosur të tipit (1000kVA, 6/0.4 kV.) Pra kemi një diferencë me efekt financiar 28 copë x 9,450 lekë/copë = 264,600 lekë pa tvsh. **5.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “*Germim shkemb i coptuar me ekskavator 0.5 m³, shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shk ne toke*” është raportuar 20,003.49 m³ sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m³, pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 1,491,644 lekë pa tvsh. **6.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “*Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri*” është raportuar 22,824 m² sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m², pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 3,831,750 lekë pa tvsh. **7.** Sipas kapitullit “*Depo V=Rrethi i depos Klos*” në situacionin përfundimtar zëri “*Rrethim me zgarë metal.galv(zgar komplet)*” është raportuar 167.20 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky rrethim ishte realizuar me një lartësi më të vogël me efekt financiar 122,569.04 lekë pa tvsh. **8.** Sipas kapitullit “*Depo V=Rrethi i depos Klos*” në situacionin përfundimtar zëri “*Hidroizolim me emulsion me 2 duar bitum(nga jashtë)*” është raportuar 119.27 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky zë nuk ishte kryer me bitum, me efekt financiar 66,791.2 lekë pa tvsh. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet në total vlera

prej **12,662,028 lekë pa Tvsh** (6,232,650 + 432,167 + 219,856 + 264,600 + 1,491,644 + 3,831,750 + 122,569.04 + 66,791.2); e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori BOE "A" Shpk & "E" Shpk & "K" Shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa trajtuar më sipër situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, pika 3.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Mbikëqyrësi i Punimeve me përfaqësues Administrator z. G.B .

Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve Ing. z. G.B për BOE "G" Shpk & "I" Shpk me datë 29.03.2023, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/10 prot., datë 02.04.2024, mbi pretendimet ndaj projekt raportit të auditimit.

Pretendimi i subjektit:

- Mbikëqyrësi i punimeve, sqaron se:

-Në lidhje pasaktësinë në llogaritjen e peshës së çelikut për zërin "F. V.Tub cel. Ø(355.6 x <5=8,5) mm i h/izoluar në fabrikë L= 5710m"; "...në projektin zyrtar, i cili ka kaluar edhe oponencën teknike të AKUM, pesha e tubit të çelikut është llogaritur 83.8 kg/ ml, ndërsa në sipas llogaritjeve tona.... Pesha e llogaritur për këtë zë është 76.5 kg/m, referuar dokumentave zyrtare të doganës shqiptare {dokumentat bashkëlidhur më poshtë.... Nga të gjitha faturat doganorene kemi marrë vlerën më të vogël e cila është 76.53 kg/ml {e kemi llogaritur 76.5). Në përllogaritjen e peshës së tubave konsiderohet edhe faktori "mbetje teknologjike" të cilat sipas manualit KTZ llogaritet në masën 2%....

-Në lidhje me zërin e ri të punës "F. V. Matës. E.M Dn 300mm PN-40" kemi "...Zëri i ri i pranuar me çmim 996,072 Lekë/copë nuk është matës F.V. Matë s E.M. Dn 300 mm PN-40 por është F.V. Matës E.M. Dn 350mm PN-40. Po të shihet me vëmendje dimensionin e tubit është 355.6 mm dhe një matës DN300mm ngushton seksionin (standartet e matësve më të përparët që janë përdorur në rastin tonë janë DN 300 dhe Dn 350)".

-Lidhur me zërin "Montim transformatori fuqie 750 kVA, 20/0.4kV" Pompat kanë disa muaj që janë në punë. Çka do të thotë që edhe transformatorët janë në punë, pra transformatorët janë montuar. Transformatorët në objekt janë vendosur 1000 kVA për shkak të llogaritjeve të nevojshme për të mbajtur dy pompa në punë. Gabimisht, në situacionin përfundimtar këta dy transformator kane dalë me vlerë 0 lekë për shkak të një gabimi në veprime (veprime në excel), por kjo nuk do të thotë që edhe vlera e punës së montimit të tyre do të konsiderohet 0 lekë, pasi transformatorët janë të rinj dhe në punë. (konstatuar edhe në terren, gjatë inspektimit të përbashkët).

-Lidhur me zërin zëri "Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m³ shkëmb, në themele gjerësi >2 m, me shkarkim në tokë" dhe zëri "Shtresë zhavori lumi t=30 cm, përhapur e ngjeshur me makineri" ... Në llogaritjen e bërë nga ju, është marrë një gjerësi 1.5 m, ku në standartet e projektimit të rrugëve për mjete e rënda duhet të jetë minimalisht 4m pasi nuk futen dot mjetet. Për këtë objekt janë përdorur mjete të rënda ku gërmimi është bërë me ekskavator 60 ton me gjerësi 3 m dhe gjerësia e hapjes së trasesë së tubacionit është 1.9 m e cila është në kundërshtim me llogaritjen 1.5 m...".

-Lidhur me zërin "Rrethim me zgareëmetal.galv(zgar komplet)" kemi "... Rrethimi siç shihet edhe në foto është H=1.9 m (në librezë është llogaritur 1.8 m). Rrjetat janë standarte 1.5 m, dhe për këtë arsye, pjesa e sipërme është rrethuar në formë tjetër, kjo edhe për të mbrojtur nga hyrje të pautorizuara të personave të ndryshëm, duke u bërë me tel me gjëmba....".

-Lidhur me zërin "Hidroizolim me emulsion me 2 duar bitumi nga jashtë)", referuar pretendimit të hidroizolimit të depos nga jashtë është lyer me prajmer disponojme çertifikatën dhe skedën teknike të materialit të përdorur....".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga mbikëqyrësi në observacionin e projekt raportit të auditimit, pas u pa me kujdes dokumentacioni shtesë i shoqëruar me fotografi do të merren në konsideratë llogaritjet analitike për zërat si: "Gërmim dheu kanal esk.gj.2m,t.z.sh.mjet", "Nënshtresë Çakëll", "Shtresë rëre", "Hedhje, mbushje dheu kat III", "Transport dheu me auto deri 5km". Ndërsa për zërat e tjerë grupi i auditimit sqaron si më poshtë:

-Në lidhje me zërin "F. V.Tub cel. Ø(355.6 x <5=8,5) mm i h/izoluar ne fabrike L= 5710m" sqarojmë se: a) në librezat e masave të dosjes tekniko-ligjore pesha e tubave çelikut është llogaritur 80kg/ml pra më e

madhe nga skeda teknike e prodhuesit të tubave (72.6kg/ml); b) në lidhje me faturat doganore sqarojmë se: faturat doganore tregojnë se çfarë malli vjen në Shqipëri dhe ato nuk mund të merren për bazë për llogaritjen e peshës së tubave të çelikut pasi tubat janë të veshur me material hidroizolues dhe rrisin artificialisht peshën e tubave të çelikut;

c) në lidhje me referencat e sjella nga “Manuali i preventivimit për punime tektonogjike dhe të montimit” i vitit 1981-1985 lidhur me “mbetjet tektonogjike” dhe saldimet, mund të themi se ky manual nuk është më në fuqi pasi aktualisht në fuqi është manuali i çmimeve të vitit 2015, ku sipas tij dhe analizës së çmimit 4.60/1 “F. V.Tub cel. Ø.355.6...” saldimet janë të përfshira në çmim.

Nga sa më sipër argumentimet e përdorura nuk qëndrojnë dhe nuk do të merren në konsideratë.

-Në lidhje me futjen zërin e ri të punës “F. V.Mates.E.M Dn 300mm PN-40” me çmim më të lartë 996,072 lekë/copë ndërkohë që ky zë pune ekziston në preventivin e ofertuar fitues të tenderit me çmimin 779,984 lekë/copë sqarojmë se: ky zë pune është futur me çmim më të lartë në kapitullin “Depo 200 m³”. Pra nuk jemi duke folur për kapitujt “Aksesoret e stacionit të pompimit dhe depo grumbulluese” dhe kapullin “Punime hidraulike në tubacionet e dergimit të pompave” siç i referohet mbikqyrësi. Në kapitujt e përmendur nga mbikqyrësi nuk ka probleme në lidhje me çmimet e zërave por ky zë është futur gabimisht me çmim më të lartë në kapitullin “Depo 200 m³”. Pra argumentimet e mbikqyrësit për këtë zë nuk qëndrojnë dhe nuk do të merren në konsideratë.

-Në lidhje me zërin e punës “Montim Transformatori fuqie 750kVA, 20/0.4kV” sqarojmë se: në situacionin përfundimtar ky zë është raportuar 30 copë, ndërkohë që në fakt janë montuar 2 transformatorë pra kemi një diferencë me efekt financiar 28 copë; argumentimet e mbikqyrësit nuk merren në konsideratë.

-Në lidhje me zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në toke” dhe zërin “Shtresë zhavori lumi t=30cm, përhapur e ngjeshur me makineri” sqarojmë se: në dosjen tekniko-ligjore librezat e masave për këto zëra nuk ishin të zbërthyer analitikisht dhe ishin të pashoqëruara me vizatim (profilet gjatësore dhe tërthor) për këtë arsye është bërë një llogaritje e përafërt referuar seksionit tërthor të projektuesit; ndërsa librezat e reja të sjella nga mbikqyrësi nuk mund të merren parasysh sepse ndryshojnë nga librezat që janë pjesë e dosjes tekniko-ligjore. Rrjedhimisht observacioni për këto zëra nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me zërin “Rrethim me zgarë metal galv (zgarë komplet) sqarojmë se: sipas matjeve faktike ky zë është realizuar me lartësi më të vogël 1.5 m sesa është raportuar në librezat 1.8 m, faktet janë të qarta dhe observacioni në lidhje me këtë zë nuk merret parasysh.

-Në lidhje me zërin “Hidroizolim me 2 duar bitum nga jashtë” risqarojmë se: në terren u vu re se depoja nuk ishte hidroizoluar me dy duar bitum si dhe në dosjen tekniko-ligjore nuk gjendej skeda teknike e materialit të përdorur; rrjedhimisht observacioni për këtë zë nuk merret në konsideratë.

4. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”.

Kontrata:

a. Furnizimi i Bashkisë Mallakastër me karburant naftë (diezel) për vitin 2023 është kryer sipas kontratës me nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, me vlerë **2,199,702 lekë me Tvsh** të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër përfaqësuar nga z. Q.I Kryetar i Bashkisë dhe OE “N ” Shpk përfaqësuar nga z. G.M Administrator i Kompanisë.

Zbatimi i kontratës do të fillojë menjëherë pas ezaurimit të vlerës së kontratës së furnizimit me nr. 1934/9 prot., datë 23.05.2023, sipas konsumit të karburantit nga AK. Kohëzgjatja e kontratës është parashikuar 12 muaj nga fillimi i zbatimit të saj, por kohëzgjatja do të jetë e vlefshme deri në ezaurimin e të gjithë vlerës së kontratës në varësi të çmimit të diktuar nga bursa. Sasia e karburantit paraprakisht e përlllogaritur nga struktura përkatëse për Bashkinë Mallakastër është **11,166 litra naftë (diezel).**

b. Furnizimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me karburant naftë (diezel) për vitin 2023 është kryer sipas kontratës me nr. 50/4 prot., datë 03.05.2023, me vlerë **23,573,808 lekë me Tvsh** të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor NSHP përfaqësuar nga z. B.V Drejtor i NSHP dhe OE “N ” Shpk përfaqësuar nga z. G.M Administrator i Kompanisë.

Zbatimi i kontratës do të fillojë menjëherë nga nënshkrimi i kontratës. Kohëzgjatja e kontratës është parashikuar 12 muaj por kohëzgjatja do të jetë e vlefshme deri në ezaurimin e të gjithë vlerës së

kontratës në varësi të çmimit të diktuar nga bursa. Sasia e karburantit paraprakisht e përllogaritur nga struktura përkatëse për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike është **130,830 litra naftë (diezel)**.

Zbatimi i kontratës:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se tërheqja e sasisë së karburantit nga Bashkia Mallakastër ka filluar në muajin Gusht të vitit 2023 ndërsa nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka filluar në muajin Maj të vitit 2023, sipas fletë-daljeve dhe faturave tatimore të trajtuara në vijim të këtij materiali. Auditimi i zbatimit të kësaj kontrate ka përfshirë periudhën Gusht-Dhjetor të vitit 2023 për Bashkinë Mallakastër dhe Maj-Dhjetor të vitit 2023 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Me Urdhrin nr. 120, datë 17.05.2023, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të kontratës së furnizimit, z. F.A me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Me Urdhrin nr. 22, datë 03.05.2023, të z. B.V Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është caktuar personi përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të kontratës së furnizimit, z. F.B me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transportit.

Mënyra e mbatjes së dokumentacionit ligjor për lëvizjen e mjeteve:

Në total mjetet të cilat do të furnizohen me karburant naftë (diezel) referuar kontratave me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, dhe nr. 50/4 prot., datë 03.05.2023, janë 29 të llojit autoveturë, kamion, eskavator, skrep, traktor me goma, zjarrëfikëse, kamionçinë, autobot uji, auto fshirëse, transportier, rul etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Mjetet dhe Makineri që disponohen sipas institucioneve
1	Bashkia Mallakastër + Sektori i MZSH-së	5
2	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	24
Totali		29

-Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.,. Këto shpenzime nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje konstatohet se, 26 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Nr.	Mjeti	Targa	Nuk është i pajisur me çertifikatën e kontrollit teknik	Nuk është pajisur me siguracion
Bashkia Mallakastër				
1	Fouristradë Mitsubishi	AA780EU	Jo	Po
2	Fouristradë Toyota	AA603SG	Jo	Po
3	Furgon Citroen	AA608SG	Jo	Po
4	Mercedez Benz Zjarrëfikëse	AA443VP	Jo	Po
5	Fouristradë Nissan	AB151DM	Jo	Po
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike				
1	Mercedez Benz	AA063PE	Jo	Po
2	Mercedez Benz	AA788CI	Jo	Po
3	Iveco Magirus	AA871XP	Jo	Po
4	Iveco Magirus	AA872XP	Jo	Po
5	Skrep Neë Holland	AFMT84	Jo	Po
6	Kamion Vetëshkarkues Iveco Fiat	AA194TF	Jo	Po
7	Makinë Teknologjike Daf	AA143PE	Jo	Po
8	KamionçinëToyota Hilux	AA602SG	Jo	Po
9	Mercedez Benz	AA423DR	Jo	Po
10	Mercedez Benz	AA255BZ	Jo	Po
11	Traktor me goma Lamborghini	AHMB37	Jo	Po
12	Kamionçinë me kosh Nissan	AA953TK	Jo	Po
13	Autobot uji Iveco	AA327TF	Jo	Po
14	Auto Fshirëse	AFMT61	Jo	Po
15	Makinë Teknologjike	AB736BH	Jo	Po
16	Autoveturë	AB339BI	Jo	Po
17	Transportier Golghover	ADR391	Jo	Po

18	Kamion Man	AA895DH	Jo	Po
19	Kamion Man	AB540DP	Jo	Po
20	Kamionçinë Nissan Navara	AB460DN	Jo	Po
21	Kamion	FR1915B	Jo	Po
Totali			26	26

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje konstatohet se, për 3 mjete të tipit Eskavator Volvo me numër shasje VC220DH00280406, Skrep Fai me numër shasje 96DTE12208043 dhe Eskavator Mini Cat me numër shasje CAT0308CKKCX02052, pjesë të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nuk janë të regjistruar në regjistratat publike pra nuk disponojnë çertifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimit.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22, Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, neni 4, gërma “a”, Ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 2, pika 1, gërma “a”, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58, neni 113 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36.

Normativat mbi konsumin e karburantit:

Me Urdhrin nr. 6, datë 02.02.2022, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. A.H , z. F.B dhe z. E.H për caktimin e normativave për konsumin e karburantit për mjetet e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur grupi i punës më datë 10.02.2023, është mbajtur procesverbali për miratimin e normativave mbi konsumin e karburantit për mjetet e flotës së Bashkisë Mallakastër (i vetmi dokumentacion i cili disponet nga institucioni për miratimin e normativave).

Nga grupi i punës i sipërpërmendur nuk është kryer një analizë mbi konsumin e karburantit për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin apo orët/volumet e punës konkretisht nuk janë kryer testime në rrugë nacionale dhe urbane apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit) në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km) si dhe nuk janë kryer testime duke u ndërthurur orët e punës me volumet e punës si gërmime, pastrime, shtrim rruge etj., (në varësi të përdorimit të mjetit/makinerive) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5, 10, 19 dhe 35-36.

Mbi mënyrën e përllogaritjes së kilometrave apo orëve të punës:

Nga auditimi konstatohet se për të gjitha mjetet që kanë si njësi matëse orët mbi kryerjen e volumeve të punës, në to nuk disponohet i instaluar asnjë orë matës dhe me zgjedhje për shtatë mjete që njësi matëse kanë kilometrazhin, kjo pajisje është jashtë funksionit të punës.

Furnizimi i mjeteve:

Për të gjitha mjetet që janë parashikuar sipas kushteve të kontratës së furnizimit me karburant naftë të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike furnizimi i tyre është kryer nëpërmjet kartave elektronike. Bashkëlidhur faturës tatimore përmbledhëse mujore e cila lëshohet nga operatori ekonomikë dhe fletë-hyrjeve, fletdaljeve nga magazina pjesë e dokumentacionit justifikues janë kuponat tatimore dokument i cili përmban targën e mjetit, datën dhe sasinë mbi furnizimin e realizuar.

-Me shkresën nr. 50/1 prot., datë 03.05.2023, të z. B.V Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është dërguar pranë OE “N ” Shpk, miratimi i listës së mjeteve të NSHP-së që do të furnizohen me karburant naftë në zbatim të kontratës me nr. 50/4 prot., datë 03.05.2023.

-Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk është paraqitur në formë shkresore pranë OE “N ” Shpk lista e mjeteve së bashku me limit mujor të miratuar që do të furnizohen me karburant. Veprime këto në kundërshtim me kontratën nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, “Blerje karburant (Diezel) viti 2023”, neni 8 “Mënyra, modalitetet dhe rakordimet e furnizimeve”, pika 8.3, ku përcaktohet që:

8.3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë porosinë dhe të pajisë Kontraktuesin me një listë të mjeteve dhe përdoruesve të tyre, ku do të përcaktohet limiti mujor i karburantit (diezel) për secilin mjet.

Likuidimi:

Për periudhën nga data 01.08.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër ka konsumuar karburant naftë 3,834 litra në vlerën 729,534 lekë dhe likuiduar në vlerën 603,354 lekë si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka konsumuar naftë 57,473 lekë në vlerën 10,673,716 lekë dhe likuiduar në vlerën 10,673,716 lekë.

Realizimi i kontratës:

-Në kontratën me nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, me objekt "Blerje karburant (Diezel) Bashkia Mallakastër viti 2023", është parashikuar furnizimi me karburant 11,166 litra naftë ku deri më datën 31.12.2023, realizimi është 3,834 litra naftë ose në masën 34.3% si dhe vlera e parashikuar është 2,199,702 lekë me Tvsh dhe realizimi është 729,534 lekë ose në masën 33.1%.

-Në kontratën me nr. 50/1 prot., datë 03.05.2023, me objekt "Blerje karburant (Diezel) Ndërmarrja e Shërbimeve Publike viti 2023", është parashikuar furnizimi me karburant 130,830 litra naftë ku deri më datën 31.12.2023, realizimi është 57,473 litra naftë ose në masën 43.9% si dhe vlera e parashikuar është 23,573,808 lekë me Tvsh dhe realizimi është 10,673,716 lekë ose në masën 45.2%.

I. Auditim me zgjedhje i shpenzimeve mbi konsumin e karburantit për mjetet e Bashkisë Mallakastër:

-Për periudhën nga data 01.08.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Bashkisë Mallakastër duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **3,834 litra naftë në vlerën 729,534 lekë**. Nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej 3,834 litra naftë konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër në cilësinë e nëpunësit autorizues, **z. A.R** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues, **z. F.A** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe **z. A.B , z. SH.Y, z. A.Z , z. SH.K, z. A.K** me detyrë drejtues të mjeteve.

II. Auditim me zgjedhje i shpenzimeve mbi konsumin e karburantit për mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike:

-Për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **57,473 litra naftë në vlerën 10,673,716 lekë**. Nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej **30,937 litra naftë në vlerën 5,671,104 lekë** konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Për mjetet që njësi matëse kanë volumet dhe orët e punës në fletët e udhëtimit nuk ndodhet i përcaktuar vendi i punës (sipas rrugëve apo kanaleve etj., për çdo ditë pune), objekt i punës, orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësi/distanca e rrugë apo kanaleve në të cilën është kryer punimi apo pastrimi, fotot e punimeve të realizuara por ndodhet vetëm përmbledhsja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave të bashku me vendin e punës (emërtimi sipas njësive administrative) për secilin mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

-Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për shtrimin e rrugëve me çakull kryesisht në fshatrat e Mallakastrës ka angazhuar gjashtë mjete të llojit kamion për realizimin e këtyre punimeve. Në lidhje me këtë situatë grupi i auditimit ka kryer rakordimin e të dhënave nga kontratat e mëparshme të furnizimit me çakull ku konstatohet se ndërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike përfaqësuar nga z. B.V Drejtor i NSHP-së dhe OE "E" Shpk përfaqësuar nga z. SH.E Administrator i Kompanisë është lidhur kontrata me nr. 58/6 prot., datë 27.06.2022, me objekt "Blerje materiale të ndryshme,

çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh” në vlerën 29,989,068 lekë me Tvsh me afat 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Sasia e çakullit e përcaktuar për furnizim në kontratë është 5,513.68 m³ çakull guror në vlerën 4,920,944 lekë me Tvsh.

Furnizimi i kësaj kontrate ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë. Kjo kontratë i përket vitit 2022, ndërsa për vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër nuk ka nënshkruar kontratë të re për furnizimi me çakull. **Pra nuk dokumentohet dhe argumentohet ku është gjendur sasia e çakullit e cila është përdorur shtrimin e rrugëve në fshatrat e Mallakastrës.**

Për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit **23,195 litra naftë në vlerën 4,265,080 lekë** për shtrimin e rrugëve me çakull.

-Për nga data 01.09.2023, deri më 31.12.2023, për kryerjen e transportit të çakullit për shtrimin e rrugëve janë përdorur pesë mjete të llojit kamion me targë AA871XP me drejtues mjete z. F.M , AA872XP me drejtues mjete z. P.L , AA895DH me drejtues mjete z. F.E , AB540DN me drejtues mjete L.J dhe FR1915B me drejtues mjete z. E.XH , **për të cilat është konsumuar karburant 4,492 litra naftë në vlerën 861,149 lekë jashtë afateve të përcaktuara në urdhrat e titullarit të institucionit për realizimin e punimeve (pra para nisjes së punimeve apo pas përfundimit të punimeve).** Ndërsa për sasinë e konsumuar për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.07.2023, të karburantit **10,565 litra naftë në vlerën 1,843,550 lekë nga NSHP nuk disponohet urdhër për fillimin e punimeve.**

Gjithashtu nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues për sasinë e konsumuar të karburantit prej **23,195 litra naftë në vlerën 4,265,080 lekë** konstatohet se, në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhsja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. B.V ish-Drejtor i NSHP-së, z. V.M ish-Drejtor i Komanduar i NSHP-së, z. F.SH Drejtor i NSHP-së në cilësinë e nëpunësve autorizues, znj. N.O me detyrë Përgjegjës i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, z. F.B me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transportit dhe z. H.H, z. V.M , z. M.M z. B.B, z. A.B, z. B.A, z. T.Ç, z. E.J, z. L.K, z. A.Ç, z. E.H, z. A.I, z. F.M , z. P.L , z. F.E , z. L.J, z. E.XH me detyrë drejtues të mjeteve.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5, 10, 19 dhe 35-36.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën nr. 42/2 prot., datë 18.04.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 33/13 prot., datë 22.04.2024, nga z. B.V Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Mjetet që janë në inventarin e NSHP janë të pajisur me siguracion për përgjegjësinë ndaj personave të tretë, me përjashtime të dy eskavatorëve me zinxhir, tip “Volvo” dhe mini eskavatori model “CAT”, të cilët nuk targohen pasi nuk lejohen të lëvizin në rrugët automobilistike, pasi e dëmtojnë atë. Lëvizja e këtyre lloje mjeteve nga njeri kantjer ndërtimi tek tjetri behet me rimorkiator, që është i pajisur me siguracion për përgjegjësinë ndaj të tretëve.

Po kështu edhe mjete FAI i cili i është shtuar inventarit të Bashkisë Mallakastër në kuadrin e bashkimit të njërive vendore në një të vetme, nga ish-Komuna Hekal ka ardhur me këtë gjendje dokumentacioni. Për të shmangur përgjegjësinë ndaj personave të tretë levizja e tij mjete nga njeri kantjer në tjetrin bëhet me rimorkiator.

Mjetet e tjera janë të pajisura me leje qarkullimi dhe siguracion, siç edhe citohet në Projekt Raportin Tuaj në faqen 152 si dhe respektivisht edhe me leje qarkullimi.

Shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e secilit mjet transportit janë të planifikuara në kontratën e nënshkruar me OE. Ndërsa për të gjitha shërbimet e tjera të kryera ka dokumentacion ligjor siç, janë fletë hyrjet dhe fletë daljet në momentin e kryerjes së shërbimeve, të pasqyruara në kontabilitet në ditarin e daljeve të cilat në vazhdim pasqyrohen në Bilancin e Ndërmarrjes.

Pretendimi se nuk janë evidentuar Km që kanë përshkruar mjete, ne mendojmë se forma e llogaritjes së distancës është më e sakt se sa leximi i km të mjeteve, pasi ekziston mundësia e pa saktësisë nga aparatet

matëse të instaluara në mjete, që për distanca të njëjta mjete të ndryshme nxjerin distanca të ndryshme. Ndërsa tabela e km të hartuara nga Bashkia është më e sakt sepse krijon mundësinë e kontrollit në çdo kohë pasi janë distanca që nuk ndryshojnë.

Ju pretendoni se këto shpenzime nuk mund të llogariten, pa pasqyruar elementin bazë i cili është km, ky problem është i zgjidhur. Automjetet kanë të shënuara për çdo rrugë gjatësinë e rrugës të përshkruar në fletë udhëtimitin dhe jo siç pretendohet që në fletë udhëtimi është shënuar përmbledhsja ditore e km të përshkruara, të paktën për NSHP.

Shuma mujore e distancave të përshkruara duke u mbledhur me 12 muajt e vitit përbën shumën vjetore të km që ka përshkruar në vite. Kjo shumë mbahet në konsiderat për kryerjen e shërbimeve të planifikuara. Siç theksuam edhe më lartë mjete Eskavator me zinxhir i markës "Volvo" dhe mini eskavatori "Cat" nuk pajisjen me Leje Qarkullimi dhe pasojë nuk mund edhe të tregohen, të cilat nuk mund të pajisen me siguracion për përgjegjësi ndaj të tretëve.

Nuk është e vërtetë që këto mjete nuk janë të rregjistruara në rregjistrat publik. Këto mjete figurojnë në inventarin NSHP Mallakastër dhe janë të rregjistruara si AQT të ndërmarjes.

Për paisjen e mjeteve me zinxhire i jemi drejtuar edhe DRTSH Fier e cils ka konfirmuar se këto mjete nuk tregohen, për shkak të natyrës së punës që kryejnë.

Kontrolli për normat e harxhimit të karburantit është bërë çdo muaj për çdo mjet i cili është i pasqyruar në fletë udhëtimet e çdo mjete, ka rezultatit e harxhimit të karburantit.

Sasia e karburantit të furnizuar, e cila është e barabartë me kuponat tatimor për çdo mjet, sasia e km të përshkruara për muajin, gjendja e karburantit në sarbator nëse ka dhe llogaritet norma e harxhimit.

Mjetet që punojnë stacioner, eskavatori Volvo dhe Cat janë të pajisur me orë matës për kohën e punës që ata punojnë.

Dokumentimi se ku është marrë materiali inert për vitin 2023 është i deklaruar në fletë udhëtimitin e mjeteve që transportojnë këto materiale, në destinacionin e shënuar për çdo rrugë.

Për tejkalimin e afateve të përcaktuara në urdhërat e titullarëve, sqarojme se në tejkalimin e afateve ndikojnë përveç anëve organizative edhe kushtet meteorologjike të cilat nuk janë në dorën tonë. Rënia e shirave e shtynë disa ditë vazhdimin e punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Së pari: Ne i referohemi plotësimin me dokumentacion të praktikës mbi justifikimin e sasisë së karburantit të konsumuar dhe një prej elementëve kryesorë janë fletët e udhëtimit. Në këtë dokument nuk janë të evidentuara kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin apo për mjetet që kanë njësi orëmatësin nuk janë të evidentuara orët në fillim dhe në fund të punimeve. Pretendimi që ngrihet nga Ju që disa mjete e kanë të dëmtuar kilometrazhin apo orëmatësin dhe disa të tjerë e kanë në funksion është jashtë kontekstit për arsye se:

Në rastin e parë si janë evidentuar në fletët e udhëtimit kilometrat e përmbledhur ditore kur kilometrazhi apo orëmatësi nuk janë në gjendje pune (pra cila është njësi matëse e kilometrave të përshkruara apo orët e punës) apo e kundërta kur kanë qenë në gjendje pune (në disa raste që konfirmohet nga Ju në observacion) cila është arsyeja që nuk janë evidentuar kilometrat në fillim dhe në përfundim të lëvizjes apo orëve të punës.

Së dyti: Në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike", përcaktohen qartë cilat mjete duhen të pajisen me targë regjistrimi.

Së treti: Sasia e çakullit e cila pretendohet që është marrë në Poçem apo si mbetje të rrugës së përfunduar Levan-Fier nuk dokumentohet me dokumentacion konkretisht nuk ka një program pune apo urdhër për furnizimin me çakull. Kjo situatë nuk evidentohet në fletët e udhëtimit.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkol frenash viti 2023".

Ndërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike përfaqësuar nga z. V.M Drejtor i NSHP-së dhe OE "E" Sha përfaqësuar nga z. D.D Administrator i Kompanisë është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023, me objekt "Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkol frenash viti 2023", me vlerë 1,870,800 lekë me Tvsh.

Me Urdhrin nr. 32, datë 30.08.2023, të z. V.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga z. E.Y , z. E.H dhe z. E.XH . Nga OE “E ” Sh.a është lëshuar fatura tatimore me nr. 174/2023, datë 19.09.2023, në vlerën 1,870,800 lekë likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 212, datë 09.11.2023. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 27, datë 19.09.2023, e cila përfshin secilin mjet referuar preventivit. Nga komisioni i sipërpërmendur është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim i datë 11.09.2023.

Për sa trajtuar më sipër mallrat janë sjell pranë Bashkisë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike **6 ditë me vonesë** nga OE “E ” Sh.a duke u bazuar në fletë-hyrjen në magazinë dhe faturën tatimore përkatëse. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike **nuk janë aplikuar penalitetet në vlerën 44,899 lekë në momentin e likudimit të kontratës** (Data e lidhjes së kontratës 30.08.2023, + 15 ditë afati i lëvrimit të mallrave shkon në datën 13.09.2023; Formula e përlllogaritjes së penaltetit $4/1000 * 1,870,800 \text{ lekë} = 7,483 \text{ lekë}$ penaltitet për 1 ditë vonesë; $6 \text{ ditë penaltitet} * 7,483 \text{ lekë} = 44,899 \text{ lekë}$ penaltitet) **ndaj OE “E ” Sh.a.**

Veprime këto në kundërshtim me Kontratën nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023, në nenin 5 “Dorëzimi” dhe nenin 17 “Dëmet e likuiduara”, gërma “a” dhe DT Stojca nr. 6, ku përcaktohet që:

Neni 5: Dorëzimi i mallrave dhe përfundimi i shërbimeve të lidhur me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit.

Neni 17. Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Shtojca 6: Sasia e mallit që kërkohet: Sipas preventivit sasior të ngarkuar në skedarët e SPE

Afatet e lëvrimit: 15 ditë nga lidhja e kontratës.

Në mënyrë të hollësishme paraqiten të dhënat si më poshtë:

Nr.	Fletë-Hyrje		Targa e mjetit	Vlera	Fatura	Urdhër Shpenzimi	Vlera e likuiduar
	Nr.	Datë					
1	27	19.09.2023	AA151DM	29,400	Nr. 174/2023, Datë 19.09.2023	Nr. 212, datë 09.11.2023	1,870,800
2	27	19.09.2023	AB540DP	84,360			
3	27	19.09.2023	AB895BH	88,284			
4	27	19.09.2023	AB339BI	90,024			
5	27	19.09.2023	Rul Cat	74,940			
6	27	19.09.2023	AB736BH	107,280			
7	27	19.09.2023	AFMT84	135,900			
8	27	19.09.2023	Cat	87,240			
9	27	19.09.2023	AA872XP	99,684			
10	27	19.09.2023	AA603SG	23,436			
11	27	19.09.2023	AA871XP	95,184			
12	27	19.09.2023	AA608SG	18,516			
13	27	19.09.2023	AA602SG	27,528			
14	27	19.09.2023	AA780EU	20,016			
15	27	19.09.2023	AA255BZ	36,408			
16	27	19.09.2023	AA953TK	46,776			
17	27	19.09.2023	AHMB37	35,832			
18	27	19.09.2023	AA143PE	85,824			
19	27	19.09.2023	AA063PE	39,000			
20	27	19.09.2023	AA788CI	69,024			
21	27	19.09.2023	Skrep FAI	77,940			
22	27	19.09.2023	AA327TF	52,800			
23	27	19.09.2023	FR1915B	74,244			
24	27	19.09.2023	ES Volvo	150,384			
25	27	19.09.2023	AA423DR	19,728			
26	27	19.09.2023	AA194TF	37,488			
27	27	19.09.2023	AB460DN	29,400			
28	27	19.09.2023	Vaj zinxhiri	108,000			
			Vaj mishel				
			Korëse bari				
			Filtër vaji				
29	27	19.09.2023	Vaj	5,760			
Totali				1,870,800			1,870,800

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F.SH Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. N.O me detyrë Përgjegjës i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Veprime këto në kundërshtim me Kontratën me nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023, neni 5 “Dorëzimi” dhe neni 17 “Dëmet e likuiduara”, gërma “a” dhe DT Stojca nr. 6.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rilloaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj..

Bashkia Mallakastër ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 7, datë 14.10.2020, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik;
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUdhËN nga DATA 01.01.2023, DERI MË 31.12.2023

Referuar të dhënave në sistemin elektronik **e-lejet** për Bashkinë Mallakastër rezulton se, për periudhën objekt auditimi nga data **01.01.2023, deri në 31.12.2023**, ka pasur **41 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh**, më konkretisht, ka pasur **3 aplikime për pajisje me leje zhvillimi (miratuar 1/refuzuar 2); 1 aplikim për pajisje me leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² (miratuar 1/refuzuar 0); 3 aplikime për pajisje me leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m² (miratuar 3/refuzuar 0); 16 aplikime për pajisje me deklaratë paraprake për kryerje punimesh (miratuar 13/refuzuar 3); 5 aplikime për pajisje me çertifikatë përdorimi (miratuar 4/refuzuar 1); 2 aplikime për pajisje me leje infrastrukture (miratuar 2/refuzuar 0)**. Informacioni i mësipërm është evidentuar i detajuar në tabelën përmbledhëse në **Tabelën nr. 1**.

Tabela nr. 1.

Viti 2023			
Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	3	1	2
Leje ndërtimi mbi 250m ²	1	1	0
Leje ndërtimi deri 250m ²	3	3	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	16	13	3
Rikonstruksion	2	1	1
Çertifikatë përdorimi	5	4	1
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	0	0	0
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	3	1	2
Ndryshim funksioni	0	0	0
Njoftim fillim punimesh	7	7	0
Shtyrje afati leje ndërtimi	2	2	0
Leje infrastrukture	2	2	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve (këtu e në vazhdim DAZHTLP), Bashkia Mallakastër, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të madhe se 250 m² është miratuar **1 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m² janë miratuar **3 leje**, ndërsa certifikata përdorimi janë miratuar **4 të tilla**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m² dhe certifikata përdorimi:

Nr.	Kategoria	Objekti	Zhvilluesi	Vendimi i lejes	Preventivi
a	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Ndërtim godine banimi 2 kate +1 kat podrum	F.L	Vendim nr. 5, datë 09.08.2023	10,284,401
b	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m ²	Ndërtim magazine grumbullimi për produkte bujqësore	S.T	Vendim nr. 4; datë 06.06.2023	5,202,381
c	Çertifikatë përdorimi	Shtesë kati (banim) mbi objekt ekzistues	B.P	Vendim nr. 1, datë 07.03.2023	-
ç	Çertifikatë përdorimi	Magazinë 1+2 kate me podrum për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore	A.Z	Vendim nr. 4, datë 01.11.2023	-

Nga auditimi i rasteve të përzgjedhura, janë konstatuar problematikat si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i distancave nga objektet e tjera. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në:

a. Leje ndërtimi për ndërtim godine banimi 2 kate +1 kat podrum, me adresë në fshatin Hekal, Nj. Adm. Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues znj. F.L , për të cilën është marrë Vendimi nr. 05, datë 09.08.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga objektet e tjera, më konkretisht, nga objekti në pjesën lindore, pasi, referuar nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2, distanca minimale që këto objektet duhet të ruajnë nga njëri tjetri është 6 metra (2k + 2k + 2m), ndërsa distanca e miratuar është 5.5 metra.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. Q.I, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër; **Z. M.M**, në cilësinë e drejtorit të DAZHTLP; **Znj. B.V**, në cilësinë e specialist-inxhinier projektsh pranë DAZHTLP.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën 1816 prot; datë 18.04.2024, protokolluar në KLSH me shpresën nr. 33/13, datë 22.04.2024, nga z. M.M, në cilësinë e ish-drejtorit të DAZHTLP dhe znj. B.V, në cilësinë e specialist-inxhinier projektsh pranë DAZHTLP, ku kanë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mosrespektimin e distancave urbane midis objekteve, shprehen se: “Në lidhje me qëndrimin e grupit të auditimit në objektin e sipërshënuar për të cilin ju ngrini pretendimin se nuk plotësohet kushti i distancës minimale në pjesën lindore prej 6 m (2k + 2k + 2m) midis objekteve, nga objekti i pajisur me leje, pasi kjo distancë është 5.5 m, ju sqarojmë se nëse kryejmë një matje të thjeshtë në planvendosje të distancës së këtij objekti nga objekti tjetër në pjesën lindore rezulton që distanca të jetë 1.5 cm në shkallë 1:500, për të cilën rezulton të jetë distanca prej 7.5 m në terren. Edhe nëse distancën midis tyre do ta masim nga veranta e objektit, distanca midis tyre do të jetë 6 m. Më të detajuar matjet janë paraqitur në fragmentin e planvendosjes së strukturës paraqitur në figurën e mëposhteme.”

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se verifikimi i përmasave është kryer në dokumentin në formatin DWG, nga i cili rezulton se distanca e skajit më lindor të objektit të miratuar nga objekti ekzistues në lindje është 5.5 metra, edhe jo 6 metra, sipas pretendimit tuaj. Për sa më sipër, **argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.**

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mosrespektimin e Intensitetit maksimal të lejuar, shprehen se: “ju sqarojmë se intesiteti i ndërtimit për këtë objekt është në rregull, pasi llogaritja e tij është bërë në raport me parcelën totale të zhvilluar të objektit prej 4264 m² në fazën e aplikimit për leje zhvillimi. Në fazën e aplikimit për leje ndërtimi është certifikuar vetëm trualli prej 1000 m², por intesiteti është llogaritur në raport me parcelën me numër pasurie44/13, me sipërfaqe prej 4264 m².”

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se pas ri-llogaritjes së Intensitetit faktik, pretendimi juaj merret në konsideratë dhe gjetja e mësipërme nuk do të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shënim: Për të gjitha observacionet dhe argumentimet e dërguara nga ana e funksionarëve të DAZHTLP, Bashkia Mallakastër, mbi Projekt Raportin e Auditimit, të cilat janë të njëjta me ato të dërguara mbi akt-konstatimet, qëndrimi i Grupit të Auditimit do të jetë i njëjtë dhe nuk do të trajtohen së dyti.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **4 raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në

dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për ndërtim godine banimi 2 kate +1 kat podrum, me adresë në fshatin Hekal, Nj. Adm. Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues znj. F.L , për të cilën është marrë Vendimi nr. 05, datë 09.08.2023, me problematika si më poshtë vijon:

-Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB për audituesin e efencës së energjisë, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Deklaratat e përgjegjësive profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik dhe atij elektrik nuk janë të nënshkuara elektronikisht nga personat përgjegjës, por nga aplikanti, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç) dhe e);

-Mungon licenca profesionale personale e hartuesve të projektit arkitektonik dhe elektrik, që të vërtetohet e drejta e ushtrimit të aktivitetit nga këta profesionist, pasi në sistemin elektronik të lejeve është ngarkuar vetëm licenca profesionale e subjektit “D”, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë dy prerjet teknike dhe detaje teknike, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

-Polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale e hartuesit të raportit të auditimit të efencës energjitike është jashtë afati, pasi aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datën 20.06.2023, ndërsa afati i mbulimit të policës është nga data 31.05.2022 – 30.05.2023, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika g);

-Rilevimi topografik, pjesë e planvendosjes së miratuar, nuk është i plotë, pasi nuk janë shënuar lartësitë e objekteve kufitare të parcelës në zhvillim, me qëllim evidentimin e distancës urbane minimale që këto objekte duhet të ruajnë nga njëri-tjetri, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika c).

-Referuar Ligjit Nr. 111/2018 “*Për kadastrën*”, Neni 17 “*Certifikatat*”, pika 4 dhe 6, Vendimit Nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, Neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartelat janë rifreskuar në datën 08/10/2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 20.06.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë grumbullimi për produkte bujqësore, me adresë në fshatin Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. S.T , për të cilën është marrë Vendimi Nr. 04, datë 06.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

-Deklaratat e përgjegjësive profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik dhe rilevimit topografik nuk janë të nënshkuara elektronikisht nga personat përgjegjës, por nga aplikanti, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç) dhe e);

-Mungon licenca profesionale personale e hartuesit të projektit arkitektonik, që të vërtetohet e drejta e ushtrimit të aktivitetit nga këta profesionist, pasi në sistemin elektronik të lejeve është ngarkuar vetëm licenca profesionale e subjektit “D”, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë dy prerjet teknike dhe detaje teknike, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).

c. Çertifikatë përdorimi për shtesë kati (banim) mbi objekt ekzistues, me adresë në fshatin Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. B.P , për të cilën është marrë Vendimi nr. 01, datë 07.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

-Mungojnë fotografitë të objektit në të gjitha orientimet, pasi mungojnë fotot e fasadës lindore, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika j).

-Mungon akti përkatës (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), i lëshuar nga institucionet kompetente për menaxhimin e mbetjeve urbane, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

-Hartimi i akteve të kontroleve nuk është kryer në rendin e saktë kronologjik, pasi, duke qenë se objekti i lejes së ndërtimit është “shtesë në objekt ekzistues”, të vetmet akte kontrolli që aplikanti dhe zhvilluesi do të duhej të dorëzonin janë: së pari, “Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin”, i përpiluar në datën 22.05.2022; së dyti, “Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik”, i përpiluar në datën 20.07.2022; së treti, “Përfundimi i sistemit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese”, i përpiluar në datën 06.03.2020. Pra, akti i cili do të duhej të përpilohej i fundit, është hartuar i pari, duke ngritur dyshime mbi vërtetësinë e tyre. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhshmëri me nenin 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1.

ç. Çertifikatë përdorimi për magazinë 1+2 kate me podrum për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, me adresë në fshatin Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. A.Z , për të cilën është marrë Vendimi nr. 04, datë 01.11.2023, me problematika si më poshtë vijon:

-Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë të plota, pasi nuk përmbajnë datën e përpilimit të tyre, duke mos dhënë informacion dhe siguri mbi kohën e hartimit, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. Q.I , në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër; **Z. M.M** , në cilësinë e drejtorit të DAZHTLP; **Znj. B.V** , në cilësinë e specialist-inxhinier projektsh pranë DAZHTLP.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën 1816 prot; datë 18.04.2024, protokolluar në KLSH me shpresën nr. 33/13, datë 22.04.2024, nga z. M.M, në cilësinë e ish-drejtorit të DAZHTLP dhe znj. B.V , në cilësinë e specialist-inxhinier projektsh pranë DAZHTLP, ku kanë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe rregjistrimin në QKB për audituesin e eficiencës së energjisë, shprehen se: “Ju informojmë se statusi aktiv i audituesit të energjisë apo i kujdo subjekti vërtetohet lehtësisht nga punonjësit e administratës, duke kërkuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në zbatim edhe të pikës a (Autoriteti përgjegjës shqyrton a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është personi i legjitimuar për të paraqitur kërkesën) të nenit 20 të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ndryshuar. Në këto kushte vërtetimi i statusit aktiv të hartuesit të raportit të eficiencës energjitike është bërë duke kontrolluar në QKB nga vetë autoriteti i planifikimit në kohën kur është bërë aplikimi për leje ndërtimi”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehemi se, së pari, dispozita ligjore e përmendur nga ana juaj ka të bëjë me të dhënat e aplikantit dhe jo të hartuesve të projekteve ndërtimore. Aplikanti është personi përgjegjës për të paraqitur kërkesë (në këtë rast, për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për t’u pajisur me leje ndërtimi). Hartuesi i raportit të auditimit të eficiencës së energjisë nuk paraqet asnjë kërkesë. Gjithashtu, shqyrtimi i legjitimitetit të personit që paraqet kërkesën ka të bëjë me faktin nëse aplikanti është person i autorizuar nga zhvilluesi nëpërmjet një prokure të posaçme midis palëve, ose nëse aplikanti është vetë zhvilluesi. Së dyti, sistemi elektronik i lejeve është një platformë në të cilën duhet të jetë prezent i gjithë dokumentacioni i nevojshëm edhe i detyrueshëm për shqyrtimin e një kërkesë për pajisje me leje ndërtimi. Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe

Projekteve (DAZHTEP), Bashkia Mallakastër, nuk është e vetmja strukturë që ka akses në praktikën të cilat aplikohen në këtë sistem. Në këto kushte, DAZHTLP ka detyrimin t'i kërkojë aplikantit, nëpërmjet dritares "Kërkesë për plotësim dokumentacioni", të plotësojë praktikën me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, edhe jo të kryejë hulumtime individuale mbi legjitimitetin e hartuesve të projektit ndërtimor. Për t'a paralelizuar, në rast se në planvendosjen e objektit, aplikanti dhe arkitekti nuk kanë paraqitur të gjitha dimensionet e nevojshme, DAZHTLP i kërkon atyre plotësimin e saj, edhe pse aplikanti ka dorëzuar/ngarkuar projektin në formatin DĒG, nga i cili ekziston mundësia e kryerjes së matjeve. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin se deklaratat e përgjegjësive profesionale të hartuesëve të projektit arkitektonik dhe atij elektrik nuk janë të nënshkruara nga personi përgjegjës, por nga aplikanti, shprehen se: "Ju informojmë se deklaratat e përgjegjësive profesionale ashtu sikurse edhe projektet arkitektonike dhe elektrike janë të nënshkruara nga S.K në cilësinë e drejtuesit ligjor, jo të aplikantit, të shoqërisë projektuese "D" ShPK, në të cilën bëjnë pjesë edhe nënshkruesit e këtyre projekteve."

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se, referuar nenit 26 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 5, i gjithë dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, për kërkesat nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, duhet të jetë i nënshkruar me firmë elektronike nga personat përkatës. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin se mungon licenca profesionale personale e hartuesëve të projektit arkitektonik dhe elektrik, shprehen se: "Ju informojmë se arkitekti dhe inxhinieri elektrik janë pjesë e shoqërisë projektuese "D" shpk, dhe projektet arkitektonik dhe elektrik janë hartuar dhe nënshkruar në cilësinë e kësaj shoqërie, prandaj nuk është kërkuar licenca profesionale personale e arkitektit dhe inxhinierit elektrik."

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se, licenca profesionale personale e hartuesëve të projektit arkitektonik dhe elektrik është një dokument i nevojshëm, pasi jep siguri mbi formimin profesional të hartuesit të tij. Shoqëria projektuese "D" ShPK gëzon të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën e arkitekturës dhe projektimit elektrik, pasi së paku, njëri prej drejtuesve teknik të saj është i pajisur me licencë në arkitekturë dhe inxhinieri elektrike. Duke pasur në vëmendje se secili prej këtyre drejtuesve teknik mund të shkëpusë marrëdhëniet e punës me shoqërinë projektuese, DAZHTLP duhet të marrë siguri të lartë se këto projekte janë hartuar nga personat përgjegjës dhe të licencuar në arkitekturë dhe inxhinieri elektrike. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin se polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale të hartuesit të raportit të auditimit të eficiencës energjitiqe është jashtë afatit, shprehen se: "Ju bëjmë me dije se polica e sigurimit në periudhën që hartuesi i raportit të auditimit të energjisë ka hartuar dhe nënshkruar këtë raport, të cilën e ka paraqitur për miratim në Agjencinë e Eficiencës Energjitiqe ka qënë brenda afatit, pavarësisht se aplikimi për leje nga aplikanti është bërë në datë 20.06.2023. Nëse i referohemi datës së paraqitur në nënshkrimin elektronik të këtij raporti rezulton data 05.05.2023, që do të thotë se raporti i eficiencës së energjisë është përfunduar në periudhën që ka qënë brenda afatit polica e sigurimit."

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se, raporti i auditimit të eficiencës energjitiqe, apo çdo projekt tjetër, për një objekt të caktuar, në mungesë të lejes së ndërtimit të miratuar nga organet kompetente, nuk përbën rrezik për veprime të gabuara, mosveprim apo harresë, të cilat mund të ndodhin gjatë kryerjes së detyrave profesionale të të siguruarit, pasi objekti për të cilin është hartuar projekti nuk është i zbatueshëm. Referuar nenit 5 të Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Përgjegjësive Profesionale, marrim informacionin se siguruesi mbulon kërkesat për dëmshpërblim përgjatë periudhës së sigurimit ose periudhës së zgjeruar të mbulimit. Nga sa më sipër cituar, afati i policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale, së paku, duhet të mbulojë afatin e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, që të quhet i vlefshëm. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin tuaj se kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhurnuara gjatë 3 muajve të fundit, shprehen se: "Ju informojmë se në aplikimin për leje zhvillimi të këtij objekti është paraqitur kartela e rifreskuar e parcelës në të cilën do të realizohet zhvillimi si dhe është dërguar për rregjistrim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës leja e zhvillimit sipas shkresës me nr. 131/2 prot., datë 01.03.2023, që do të thotë se është informuar ASHK në lidhje me lejet e lëshuara në këtë pasuri".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se, edhe pse Bashkia Mallakastër ka njoftuar ASHK në lidhje me miratimin e lejes së zhvillimit, dokumentat e pronësisë do të

duhej të ishin kërkuar të rifreskuara, pasi, së pari, në fazën e miratimit të lejes së zhvillimit, ASHK ka miratuar në heshtje, ndërkohë që referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6, DAZHTLP nuk do të duhej të mjaftohej vetëm me miratimin në heshtje. Së dyti, DAZHTLP nuk ka kërkuar mendimin e ASHK në fazën e miratimit të lejes së ndërtimit, edhe pse ky veprim kërkohet në mënyrë emërore në vendimin e sipërcituar. Së treti, regjistrimi i lejes së zhvillimit nuk është bllokim hipotekor dhe nuk është garanci mbi mos-tjetërsimin e pronës në zhvillim. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin se deklaratat e përgjegjësive profesionale të hartuesëve të projektit arkitektonik dhe rilevimit topografik nuk janë të nënshkruara nga personi përgjegjës, por nga aplikanti, shprehen se: “Ju informojmë se deklaratat e përgjegjësive profesionale ashtu sikurse edhe projekti arkitektonik dhe rilevimi topografik janë të nënshkruara nga S.K në cilësinë e drejtuesit ligjor, jo të aplikantit, të shoqërisë projektuese “D ” shpk, në të cilën bëjnë pjesë edhe nënshkruesit e këtyre projekteve.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se, referuar nenit 26 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 5, i gjithë dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, për kërkesat nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, duhet të jetë i nënshkruar me firmë elektronike nga personat përkatës. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin se mungon licenca profesionale personale e hartuesëve të projektit arkitektonik, shprehen se: “Ju informojmë se arkitekti është pjesë e shoqërisë projektuese “D ” ShPK, dhe projekti arkitektonik është hartuar dhe nënshkruar në cilësinë e kësaj shoqërie, prandaj nuk është kërkuar licenca personale profesionale e arkitektit.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se, licenca profesionale personale e hartuesit të projektit arkitektonik është një dokument i nevojshëm, pasi jep siguri mbi formimin profesional të hartuesit të tij. Shoqëria projektuese “D ” ShPK gëzon të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën e arkitekturës, pasi së paku, njëri prej drejtuesve teknik të saj është i pajisur me licencë në arkitekturë. Duke pasur në vëmendje se secili prej këtyre drejtuesve teknik mund të shkëpusë marrëdhëniet e punës me shoqërinë projektuese, DAZHTLP duhet të marrë siguri të lartë se ky projekt është hartuar nga personat përgjegjës dhe të licencuar në arkitekturë. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pretendimin tuaj se aktet e kontrollit nuk janë në rendin e duhur kronologjik, si dhe në lidhje me mungesën e datave në këto akte, shprehen se: “Ju informojmë se ky është një lapsus në vënien e datave në këto akte.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehem se aktet e kontrollit janë nënshkruar së paku nga katër persona përgjegjës. Lapsusi i pretenduar nga ana juaj do të duhej të ishte evidentuar nga ana e funksionarëve të Bashkisë, pasi, referuar nenit 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2, nënpika b), autoriteti vendor ka detyrimin e shqyrtimit të plotësisimit të plotë e të saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, të kërkuara në formular. Për sa më sipër, argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.

Shënim: Për të gjitha observacionet dhe argumentimet e dërguara nga ana e funksionarëve të DAZHTLP, Bashkia Mallakastër, mbi Projekt Raportin e Auditimit, të cilat janë të njëjta me ato të dërguara mbi akt-konstatimet, qëndrimi i Grupit të Auditimit do të jetë i njëjtë dhe nuk do të trajtohen së dyti.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër, konstatohet se gjatë vitit 2023, struktura e IMTV ka qenë e përbërë nga:

Tabela nr. 1

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit
1	A.X	Kryeinspektor	Inxhinieri ndërtimi	20.05.2019	Në vazhdim
2	A.S	Inspektor/jurist	Juridik	21.10.2019	09.06.2023
3	SH.XH	Inspektor	I mesëm	14.10.2019	Në vazhdim
4	K.Y	Inspektor/jurist	Juridik	02.11.2023	Në vazhdim

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Sa më sipër, është në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 11, ku përcaktohet se: “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e **drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit**”.

Duke parë tabelën e mësipërme, konstatohet se në strukturën e IMTV ka vetëm një punonjës me profil arsimimi teknik, si inxhinier ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj., profile të cilat janë të specializuar në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, në cilësinë e kryeinspektorit. Gjithashtu, konstatohet se një prej inspektorëve të IMTV, Bashkia Mallakastër, nuk është me arsim të lartë, por me arsim të mesëm (teknik ndërtimi).

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga shqyrtimi i blloqeve të proces verbaleve për konstatimin e kundërvajtjeve, janë mbajtur gjithsej 5 proces-verbale konstatimi, si pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2

Nr.	PV konstatimi	Dënim me gjobë	Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
1	Nr. 000135, datë 09.02.2023	Nr. 000014, datë 10.02.2023	LL.G	Ndërtim çatie mbi soletë, me hapësirë të shfrytëz.	532,099 lekë
2	Nr. 000136, datë 05.04.2023	Nr. 000015, datë 06.04.2023	A ShPK	Shkelje e afatit për përfundimin e punimeve	100,000 lekë
3	Nr. 000137, datë 08.05.2023	Nr. 000016, datë 08.05.2023	R	Shkelje e afatit për përfundimin e punimeve	100,000 lekë
4	Nr. 000138, datë 25.09.2023	Nr. 000017, datë 28.09.2023	E	Ndërtim muri rretues, mbi gjurmën e murit egzistues	50,000 lekë
5	Nr. 000140, datë 09.11.2023	Nr. 000018, datë 09.11.2023	E ShPK	Shkelje e afatit për përfundimin e punimeve	100,000 lekë

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Në zbatim të proces-verbaleve të konstatimit janë vendosur **5** masa administrative dënim me gjobë, me vlerë totale **882,099 lekë**, është marrë 1 vendim për pezullim punimesh dhe asnjë vendim për prishje të objekteve të kundërligjshëm (referuar tabelës së plotësuar nga IMTV Bashkia Mallakastër).

Në lidhje me konstatimin nr. 1, me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, është marrë masa ndëshkuese me gjobë me vlerë 532,099 lekë, e përlllogaritur sipas kostos së ndërtimit për m². Për këtë konstatim nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm nga kryeinspektori, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”. Për këtë konstatim, nga ana e kryeinspektori është bërë kërkesa nr. 1813, datë 14.04.2023, për lëshimin e urdhërit ekzekutiv, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë.

Në lidhje me konstatimin nr. 2, me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, si dhe në lidhje me konstatimin nr. 3, me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000137, datë 08.05.2023, është marrë masa ndëshkuese me gjobë me vlerë 100,000 lekë/secilin. Në asnjë prej këtyre rasteve nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Në lidhje me konstatimin nr. 4, me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes 000138, datë 25.09.2023, është marrë masa ndëshkuese me gjobë me vlerë 50,000 lekë, por nuk është nxjerrë

vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”.

Në lidhje me proces-verbalet e konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, (referuar Tabelës nr. 2), konstatohet se në asnjë prej këtyre rasteve evidentimi i shkeljes nuk është kryer nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, por informacioni ka ardhur nga Prokuroria, pasojë kjo e mos-ushtrimit të aktivitetit inspektues në territorin e Bashkisë Mallakastër, veprime këto në kundërshtim me nenin 1, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, nenin 5, pika “a”.

Në lidhje me proces-verbalet e konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, për të cilat fillimisht do të duhej të ishte nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, dhe më pas vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm, konstatohet se në asnjë rast IMTV nuk ka njoftuar dhe kërkuar asistencë nga IKMT për prishjen e këtyre ndërtimeve, në kushtet e mungesës së mjeteve të përshtatshme për kthimin në gjendjen fillestare nga ana e Bashkisë Mallakastër. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 52, të Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pika 6.

Në lidhje me asistencën që IMTV duhet të kërkojë nga IKMT, konstatohet se IMTV nuk ka njoftuar dhe kërkuar asistencë nga IKMT për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, në kushtet e mungesës së mjeteve të përshtatshme për kthimin në gjendjen fillestare nga ana e Bashkisë Mallakastër.

Shënim: Në vazhdim, nga Bashkia Mallakastër është pararqitur dokumenti me observacionet mbi Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën 1816 prot; datë 18.04.2024, protokolluar në KLSH me shpresën nr. 33/13, datë 22.04.2024, nga nga z. A.X , në cilësinë e Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor. Duke qenë se argumentimet dhe observacionet për këtë gjetje janë të njëjta me ato mbi akt-konstatimet, qëndrimi i Grupit të Auditimit do të jetë i njëjtë dhe nuk do të trajtohen së dyti.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Mallakastër, nuk ka kryer detyrat e tij funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në:

b. Çertifikatë përdorimi për shtesë kati (banim) mbi objekt ekzistues, me adresë në fshatin Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. B.P , për të cilën është marrë Vendimi nr. 01, datë 07.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar aktit përfundimtar të kolaudimit, i cili është hartuar në datën 15.11.2022, shprehemi se zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të parashikuar në lejen për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, pra brenda datës 15.10.2022. Në sistemin e-lejet, si dhe nga auditimi i aktivitetit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) është konstatuar se nuk është marrë asnjë masë ndaj subjektit zhvillues për shkelje të afatit të punimeve. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 52 të Ligjit 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika dh).

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bashkia Mallakastër është paraqitur observacioni me shkresën 1816 prot; datë 18.04.2024, protokolluar në KLSH me shpresën nr. 33/13, datë 22.04.2024, nga nga z. A.X , në cilësinë e Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, ku ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mos-ushtrimin e aktivitetit inspektues në objektin me leje të miratuar me Vendim nr. 04, datë 06.06.2023, shprehen se: “Sipas planit të punës të muajit Mars, u kontrolluar subjekti dhe u konstatua se zhvilluesi, pas përfundimit të punimeve kishte vendosur tenda të çmontueshme, të cilat ishin çmontuar përsëri. Bashkëlidhur foto të objektit të përfunduar”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se merret në konsideratë dhe se konstatimi nuk do të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A.X me detyrë kryeinspektor i IMTV Bashkia Mallakastër; **Z. SH.XH** , me detyrë inspektor pranë IMTV, **Z. K.Y** me detyrë inspektor pranë IMTV; **Z. A.S** me detyrë ish-inspektor pranë IMTV.

2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 204/8 prot., datë 11.07.2023, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 1014/16 prot., datë 12.07.2023, ku janë lënë për zbatim 29 masa organizative, 1 masë për shpërbllim dëmi në vlerën 112,566 lekë dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 846,572 lekë, 14 masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 1,171,333,912 lekë dhe 20 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 23 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërbllim dëmi është rekomanduar 1 masë në vlerën 112,566 lekë e cila është janë pranuar plotësisht, nga masa e pranuar 1 masë është e pa zbatuar.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 2 masa në vlerën 846,572 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është e pa zbatuar.

d. Për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 14 masa në vlerën 1,171,333,912 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 9 masa janë në proces zbatimi.

e. Masa disiplinore janë rekomanduar 20 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 20 masa janë në proces zbatimi.

-Gjithashtu nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Q.I Kryetar i Bashkisë Mallakastër.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Mallakastër ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1014/18 prot., datë 26.07.2023, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Mallakastër administruar në KLSH me nr. 204/8 prot., datë 11.07.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 1014/16 prot., datë 12.07.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- 29** masa organizative.
- 1** masë për shpërblim dëmi në vlerën **112,566 lekë**.
- 2** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **846,572 lekë**.
- 14** masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **1,171,333,912 lekë**.
- 20** masa disiplinore.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Mallakastër të Kryetarit të Bashkisë z. Q.I me nr. 1014/18 prot., datë 26.07.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	29	29	0
Masa për shpërblim dëmi	1 112,566 lekë	1 112,566 lekë	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	2 846,572 lekë	2 846,572 lekë	0
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	14 1,171,333,912 lekë	14 1,171,333,912 lekë	0
Masa disiplinore	20	20	0
Totali	65	65	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Mallakastër:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	29	1	3	2	23
Masa për shpërblim dëmi	1 112,566 lekë	0	0	0	1
Masa për eliminimin e efekteve negative	2 846,572 lekë	0	1	0	1
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	14 1,171,333,912 lekë	1	4	9	0
Masa disiplinore	20	0	0	20	0
Totali	65	2	8	31	25
Totali në %	100%	3%	11%	47.6%	38.4%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për hartimin e strategjisë së riskut është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 329, datë 01.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë. Në lidhje me këtë situatë nuk janë masat e duhura për hartimin e strategjisë së riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave për vitin 2023, por ka mbetur thjesht në fazën e ngritjes së grupit të punës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i mbajtjes së të dhënave për administrimin e taksave dhe tarifave vendore konstatohet se, deri më datën 31.12.2023, Bashkia Mallakatër nuk disponon një program kompjuterik të licencuar për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Rekomandimi nuk është zbatuar

1.3. Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se Regullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mallakastër është ajo e vitit 2020, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 18.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë. Në lidhje me përditësimin e rregullores së brendshme është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 74, datë 21.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë, por ka mbetur thjesht në fazën e ngritjes së grupit të punës. Gjithashtu për vitin 2023 nuk hartuar harta e proceseve të punës si dhe nuk janë hartuar programe trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, edhe për vitin 2023 nga Bashkia Mallakastër nuk janë masat e duhura për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve, ndërmarrjen e shërbimit publik etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nuk janë zhvilluar auditime në fushat me risk si menaxhimi financiar dhe kontrollin, prokurimet etj., por është audituar një prej fushave me risk të evidentuar në rekomandim konkretisht administrimi i taksave dhe tarifave vendore.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 61,663,958 lekë. Në gjendjes e kësaj llogarie nuk është përfshirë vlera prej 1,199,565,653

lekë e cila u përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore. Për më tepër në pasqyrat financiare nuk evidentohet llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë".

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aksionet e Bashkisë Mallakastër konkretisht të Ujësjetës Kanalizime Sh.a Mallakastër sot pjesë e Shoqërisë Rajonale U në vlerën 34,640,004 lekë (5.49% e 621,858,000 lekë) dhe Shoqërisë Aksionare B në vlerën 500,000 lekë (25% e 2,000,000 lekë).

Rekomandimi nuk është zbatuar

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i'u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në gjendjen e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" është ngrurtësuar vlera 39,937,791 lekë që i përket objekteve 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Mallakastër për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Mallakastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 39,937,791 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 "Studime dhe Kërkime".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" nuk ka projekte që kanë përfunduar për të cilat duhej të kontabilizohen në Klasën 2 sipas rastit, por për këtë llogari nga auditimi i pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" nuk është përllogaritur normë amortizimi.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr. 231 "Investime në proces" dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitet afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Gjendja e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 669,570,307 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie janë përfshirë 8 kontrata punimesh, mbikëqyrje dhe kolaudimi të përfunduara dhe të likuiduara në vlerën 171,116,853 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarinë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore".

Rekomandimi nuk është zbatuar

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2023 konkretisht llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak, për vlerën 3,977,574 lekë, si rrjedhojë e moskontabilizimit të detyrimeve për shpronësim.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që të kryhej vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në observacion janë paraqitur:

-Fatura me vlerë 1,083,608 lekë e subjektit “K ” për punime në objektin “Përmirësime të kushteve të banimit në ndërtesa për komunitetet e pafavorizuara”.

-Fatura me vlerë 4,242,352 lekë (detyrim i ngelur -5% garanci), e subjektit G Shpk për punime në objektin “Përmirësime të kushteve të banimit në ndërtesa për komunitetet e pafavorizuara”.

Për këtë problematikë, paraqesim këtë Observacion, duke sqaruar si më poshtë:

1. Në lidhje me konstatimin se ndaj subjektit “K ” Shpk ka mbetur vlera prej 1,083,608 lekë pa u likuiduar nga faturat e depozituara nga ky subjekt, ju bëjmë me dije se Bashkia Mallakastër ndaj këtij subjekti i ka likuiduar të gjitha detyrimet për punimet e kryera në objektin “Përmirësime të kushteve të banimit në ndërtesa për komunitetet e pafavorizuara” dhe nuk ka detyrime të pa likuiduara.

Likuidimi i fundit është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 737, datë 29.12.2023, në vlerën 3,901,218 lekë dhe me këtë likuidim është mbyllur detyrimi ndaj subjektit “K ” Shpk, sipas gjithë situacioneve dhe faturave të dorëzuara. Ndaj dhe nuk mund të kontabilizohet në llogarinë 404 “Furnitorë për investime” pasi nuk egziston detyrimi.

Nga situacionet dhe faturat e dorëzuara rezulton se nga subjekti “K ” Shpk.

-Vlera e kontratës 27,891,509 lekë

-Situacionuar dhe faturuar 25,429,698 lekë

-Likuiduar 25,429,698 lekë

Pa situacionuar dhe faturuar pasi nuk janë realizuar punimet sipas preventivit janë 2,461,811 lekë, për të cilat nuk ka detyrim për tu likuiduar.

2. Në lidhje me konstatimin se ndaj subjektit G Shpk ka mbetur vlera prej 4,242,352 lekë pa u likuiduar nga faturat e depozituara nga ky subjekt, ju bëjmë me dije se Bashkia Mallakastër ndaj këtij subjekti i ka likuiduar të gjitha detyrimet për punimet e kryera në objektin “Përmirësime të kushteve të banimit në ndërtesa për komunitetet e pafavorizuara” dhe nuk ka detyrime të pa likuiduara.

Nga situacionet dhe faturat e dorëzuara rezulton se nga subjekti G Shpk rezulton se:

-Vlera e kontratës 26,123,990 lekë

-Situacionuar dhe faturuar 25,380,099 lekë

-Likuiduar 25,380,099 lekë

Likuidimi i fundit është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 230, datë 10.05.2023, në vlerën 1,386,390 lekë dhe me këtë likuidim është mbyllur detyrimi ndaj subjektit G Shpk, sipas gjithë situacioneve dhe faturave të dorëzuara. Ndaj dhe nuk mund të kontabilizohet në llogarinë 404 “Furnitorë për investime” pasi nuk egziston detyrimi.

Pa situacionuar dhe faturuar pasi nuk janë realizuar punimet sipas preventivit janë 743,891 lekë, për të cilat nuk ka detyrim për tu likuiduar.

Rekomandimi është zbatuar

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi mbi planifikimin e buxhetit vjetor për vitin 2023 konstatohet se, nga Bashkia Mallakastër nuk janë parashikuar fonde për vlerësimin e aktiveve të institucionit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e pronave të transferuara me VKM-të përkatëse.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për:
-Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

-Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk janë masat e duhura për kontabilizimin e të gjitha aktiveve të pasqyrat financiare për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe llogarinë 212 “Ndërtesa dhe kontruksione”.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për periudhën 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit 192,162,428 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate 127,847,465 lekë pa Tvsh. Në 6 procedura (me objekt “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)”, viti 2023, me fond limit 78,253,438 lekë pa Tvsh, “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”, viti 2023, me fond limit 21,477,925 lekë pa Tvsh, “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër”, viti 2023, me fond limit 4,039,835.83 lekë pa Tvsh, “Blerje filtra, vaj motorri,

hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”, viti 2023, me fond limit 1,666,550 lekë pa Tvsh, “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2023 (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)”, viti 2023, me fond limit 8,072,770 lekë pa Tvsh, “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”, viti 2023, me fond limit 78,651,909 lekë pa Tvsh) me fond limit 192,162,428 lekë pa Tvsh janë konstatuar shkelje të rregullave të LLP në në vendosjen e kriterëve të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe objektin e kontratës, si dhe të pa argumentuara.

Rekomandimi nuk është zbatuar

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për periudhën 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit 192,162,428 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate 127,847,465 lekë pa Tvsh.

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)” viti 2023, me fond limit 78,253,438 lekë pa Tvsh, me fitues BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk, me vlerë të ofertës 49,092,600 lekë pa Tvsh rezulton se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” viti 2023, me fond limit 21,477,925 lekë pa Tvsh, me fitues OE “N ” Shpk, me vlerë të ofertës 21,477,925 lekë pa Tvsh rezulton KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratari” Damës Mallakastër” viti 2023, me fond limit 4,039,835.83 lekë pa Tvsh, me fitues OE “SH ” Shpk, me vlerë të ofertës 2,601,100 lekë pa Tvsh rezulton se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)”, viti 2023, me fond limit 78,651,909 lekë pa Tvsh, me fitues OE “LL ” Shpk, me vlerë të ofertës 45,366,340 lekë pa Tvsh rezulton se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.

Rekomandimi nuk është zbatuar

13.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër ka realizuar në total 29 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 13,026,184 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 10,417,436 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje nga 29 procedura të realizuara me fond limit 13,026,184 lekë pa Tvsh janë audituar 15 procedura me fond limit 10,239,248 lekë pa Tvsh ose në masën 78.6% të vlerës totale të fondit limit.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër ka realizuar në total 7 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 4,436,710 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 3,720,125 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje nga 7 procedura të realizuara me fond limit 4,436,710 lekë pa Tvsh janë audituar 5 procedura me fond limit 3,781,358 lekë pa Tvsh ose në masën 85.2% të vlerës totale të fondit limit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla për Bashkinë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nuk janë konstatuar problematika mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë por janë evidentuar mangësi si mungesë dokumentacioni për hartimin e fondit limit apo mos argumentim i fondit limit.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për, rekrutimin në stafin e IVMT të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me arsimin e punonjësve situata është e njëjtë me atë të konstatuar në auditimin e mëparshëm konkretisht: IMTV ka në strukturën e saj vetëm një punonjës me arsimim të lartë teknik si inxhinier ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj., në cilësinë e kryeinspektorit. Gjithashtu, një prej inspektorëve të IMTV, Bashkia Mallakastër, nuk është me arsim të lartë, por me arsim të mesëm (teknik ndërtimi).

Rekomandimi nuk është zbatuar

14.2. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe IVMT Mallakastër të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IVMT, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Mallakastër.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me bashkërendimin e punës midis strukturave: Në një rast, IMTV nuk ka kryer kontrolle gjatë ndërtimit të objektit të pajisur me leje ndërtimi dhe/ose nuk ka evidentuar shmangiet nga projekti i miratuar. Në një rast tjetër, IMTV nuk ka evidentuar shkeljen e afatit të përfundimit të punimeve dhe nuk ka marrë masat ndëshkuese sipas rastit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejet e ndërtimit të miratuara përgjatë periudhës 2022, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, konstatohet se vazhdohet të ketë mangësi në dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

16.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër të marrë masa për vendosjen e tabelave kufizuese për tonazh sipas aftësisë mbajtëse të shtresave rrugore të projektuara. Të kërkohet nga Kontraktori riparimi i defekteve të shtresave asfaltike, por edhe të defekteve të tjera të mundshme, para përfundimit të periudhës së garancisë së riparimit të defekteve.

Brenda periudhës së garancisë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Mallakastër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Mallakastër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e masave të lëna në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH por ka mbetur në të njëjtën fazë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Mallakastër nuk janë masat për hartimin e PBA-së 2023-2025.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe realizuar 219,320 mijë lekë ose në masën 71 %. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.

Rekomandimi nuk është zbatuar

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor, për projekte të cilat nuk janë planifikuar në PBA.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, konstatohet se: Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)" viti 2023 me fond limit 78,253,438 lekë pa Tvsh dhe "Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)" viti 2023 me fond limit 78,651,909 lekë pa Tvsh, janë zhvilluar pa u siguruar fondet përkatëse.

Rekomandimi nuk është zbatuar

21.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Përgjatë vitit buxhetor 2023 dhe në vijim

21.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

21.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimeve 21.2, 21.2, dhe 21.3: Të pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Vlera e faturave të pa likuiduara më datë 31.12.2023, është 10,419,769 lekë. Nga strukturat drejtuese nuk është kryer një analizë për shkaqet dhe mënyrën si do të kryhet likuidimi i këtyre detyrimeve.

Rekomandimet 21.1, 21.2, dhe 21.3, nuk janë zbatuar

A.1. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se janë 36 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 10 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 22 nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime për 2 subjekte në vlerën 847,516 lekë.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 9 rekomandime në vlerën 1,455,619,879 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga këto 1 rekomandim për vlerën 11,534,944 lekë zbatuar, 2 rekomandime për vlerën 1,137,138,382 lekë në proces zbatimi, 6 rekomandime për vlerën 300,946,553 lekë nuk janë zbatuar, si dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht për vlerën 6,000,000 lekë.

-Janë lënë 11 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 108-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Konkretisht rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshtetimin e zbatimit të rekomandimeve në proces, si më poshtë vijon:

A.1.1. MASA ORGANIZATIVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi, i cili të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.3. Rekomandimi: Të kryhen ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, për ato funksione të cilat me ligj janë kompetencë e institucioneve të tjera duke rishikuar edhe strukturën e bashkisë me qëllim alokimin eficient të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, ku të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

2.2. Rekomandimi: Të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngriejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mallakastër.

3.2. Rekomandimi: Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mallakastër.

Në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

Në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

7.2. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likuidimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar radhën e likuidimit sipas parimit “hyrje e parë – dalje e parë”.

Në vijimësi

9.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin

e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit, sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

10.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

10.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

11.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** “U Sh.a.”, me NUIS K...N, për 100% të aksioneve, në vlerën 621,858,000 lekë; **2.** “B ” Sh.a., me NUIS L...Q, për 25% të aksioneve në vlerën 500,000 lekë; **3.** “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Mallakastër”, me NUIS M...Q, për 100% të aksioneve, në vlerën 67,105,362 lekë, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **689,463,362 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

11.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të bërë çregjistrimin e shoqërisë “Ujësjiellës kanalizime”, e themeluar në datën 28.02.1997, aktualisht me status “Aktiv”, me NIPT/NUIS J...S, kapitali i së cilës rezulton të jetë transferuar i gjithi në shoqërinë “U ”, me NIPT/NUIS K...N.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale në Bashkinë Mallakastër të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerën e plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

Në vijimësi

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mallakastër, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë të përshtatshme me procedurën dhe duke dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.4. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Mallakastër, të marrë masa për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, ku të bashkërendohet puna me të gjitha institucionet e tjera publike brenda kompetencave që u njeh ligji, duke përfshirë edhe kërkesën drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse objektet për të cilat është aplikuar për leje ndërtimi, duhet t'i nënshtrohen apo jo Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për plotësimin e procedurave, duke vendosur masat e pezullimit për ndërtimet që kryhen pa lejet përkatëse. Të administrohet në dosjet e tyre praktika, duke bashkëlidhur fotografitë e kundërvajtjes ku të pasqyrohet fakti i evidentuar në procesverbalet e konstatimit. Të mbahet korrespondencë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku çdo 3 muaj të përcillet informacioni periodik i aktivitetit të tyre.

22.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së, të marrë masa për kontrollin e objekteve të pajisura me leje ndërtimi dhe në çdo rast të mbajë aktet e kontrollit ku të pasqyrohet situata e objektit në ndërtim dhe evidentimi i shkeljeve në rast konstatimi.

22.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë**.

Në vijimësi

Për sa trajtuar më sipër rekomandimet nr. 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2, 4.1, 7.1, 7.2, 8.1, 9.1, 10.2, 10.4, 11.1, 11.2, 12.1, 15.1, 20.4, 21.1, 22.1, 22.2, 22.3, që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohen përveç rekomandimit nr. 22.3.

A.1.2. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa tvsh** nga BOE "SH" Shpk, & "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt "Ndërtim shëtitore nga shkolla "O" deri tek varrezat e qytetit", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa tvsh** nga OE "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt "Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja "5 Shkurti", Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Për sa trajtuar më sipër rekomandimet 1.1, dhe 2.1, nga Bashkia Mallakastër nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës totale 847,516 lekë.

A.1.3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar/vjelë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **30,433,851 lekë**.

2.3. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Fier). Për familjet fermere debitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë periudhën/vlerën e papaguar, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës debitore prej **68,669,251 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,218,252 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, (sipas normës së interesit të Bankës së Shqipërisë, plus tetë pikë përqindje) për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifatat e plotat për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **6,000,000 lekë**, sipas Aneksëve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), **197,346 mijë lekë** pa TVSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për marrjen në dorëzim të objektit jo sipas projektpreventivit dhe pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të objektit, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa trajtuar më sipër rekomandimet 1.1, 2.1, 2.2, 2.3, 3.1, 6.1, 7.1 dhe 8.1, që i përkasin kategorisë masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimin e mëparshëm të cilat nuk janë zbatuar dhe nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës totale prej 304,667,354 lekë por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, që i përkasin situatës së boxhit tatimorë. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohen.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Mallakastër në vlerën 112,566 lekë, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër të marrë masa për zbritjen e vlerës **112,566 lekë** nga vlera e garancisë së punimeve të Kontraktorit BOE “**K SHPK & C**” SHPK, për përfitim të padrejtë si referencë e gabuar e çmimit për zëra të rinj punimesh, si dhe për punime të certifikuara dhe të pa realizuara.

Brenda periudhës së garancisë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës 112,566 lekë ndaj BOE “K ” Shpk & “C ” Shpk.

Rekomandimi nuk është zbatuar

C.1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër nuk kanë kryer një analizë mbi shkaqet që kanë çuar në humbjen e proceseve gjyqësore. Gjithashtu përgjatë vitit 2023 Bashkia Mallakastër ka pasur dy procese gjyqësore me z. E.Ç dhe znj. M.L në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ku Bashkia ka paguar detyrimin nga humbja e procesit gjyqësor vlerën totale 2,998,640 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Brenda vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se vlera për t’u paguar për humbjen e proceseve gjyqësore për vitin 2023 është 19,805,360 lekë ku deri më datë 31.12.2023, është likuiduar shuma 7,998,640 lekë si dhe mbetet për t’u likuiduar vlera 11,806,720 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

C.2. MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **1,148,624,094 lekë** për 140 subjekte (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjithashtu referuar listës së paraqitur në oservacion është likuiduar vlera 30,300,440 lekë dhe mbetet në proces për arkëtim vlera 118,323,694 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare 2,466,047 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2023, situata debitoare në lidhje me dhënien me qira të pasurive të paluajtshme është në vlerën 3,004,710 lekë nga kontrata për dhënien me qira të sipërfaqen për vendosjen e antenave dhe tokave bujqësore. Gjithashtu referuar listës së paraqitur në oservacion është likuiduar vlera 228,680 lekë dhe mbetet në proces për arkëtim vlera 2,237,367 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga auditimi me zgjedhje i kontratave të qirasë konstatohet se nuk ka ndryshimeve për kamatëvonesat dhe indeksin e çmimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t'i përcjellë Sektorit të Tatim Taksave listën me subjektet debitoare për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe Sektori i Tatim Taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitoare prej 12,874 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit:

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 426,844 lekë për 13 persona, ka paguar detyrimet 1 persona me vlerë 38,864 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2023 gjithsej 12 persona me vlerë 387,980 lekë. Ndërsa situata debitoare progresive më datë 31.12.2023, për mos likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 9,773,789 lekë për 319 persona.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror

Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,116 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimeve 4.1 dhe 4.2: Të pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Mallakastër janë kryer njoftimet për shlyerjen e detyrimeve tatimore për subjektet si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 3442 prot., datë 10.07.2023, është njoftuar për shlyerjen e detyrimit tatimor Subjekti "P ";

2. Me shkresën nr. 3443 prot., datë 10.07.2023, është njoftuar për shlyerjen e detyrimit tatimor Subjekti "SH " Shpk;

3. Me shkresën nr. 3444 prot., datë 10.07.2023, është njoftuar për shlyerjen e detyrimit tatimor Subjekti "N " Shpk;

4. Me shkresën nr. 3445 prot., datë 10.07.2023, është njoftuar për shlyerjen e detyrimit tatimor Subjekti "E" Shpk;

Gjithashtu referuar observacionit janë arkëtuar detyrimet në vlerën 2,336,126 lekë si më poshtë:

-Subjekti SH më datë 20.07.2023, vlerën 215,555 lekë;

-Subjekti SH më datë 20.07.2023, vlerën 1,000,000 lekë liçencim 5 vjet;

-Subjekti N Shpk më datë 20.07.2023, vlerën 120,571 lekë;

-Subjekti N Shpk më datë 21.06.2023, në vlerën 1,000,000 lekë liçencimi 5 vjet.

Rekomandimet 4.1 dhe 4.2 janë zbatuar pjesërisht

5.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 986,696 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Referuar observacionit janë arkëtuar detyrimet në vlerën 457,415 lekë si më poshtë:

-Subjekti S më datë 21.06.2023, në vlerën 220,416 lekë;

-Subjekti C Shpk më datë 06.07.2023, në vlerën 236,999 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim-Taksave, në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë "Familje", ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 4,516,750 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kjo problematikë është konstatuar edhe për vitin 2023 konkretisht sipas rregjistrave

për njësitë administrative numri i familjeve të njërive administrative është 7,248 familje të cilat nuk janë tarifuar për vlerën 7,248,000 lekë për tarifën e pastrimit për të cilën ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër. Tarifa e gjelbërimit dhe e ndriçimit nuk ofrohet si shërbim nga Bashkia Mallakastër dhe abonentët nuk janë tarifuar për këto shërbime.

Rekomandimi është në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Fier –Mallakastër, për arkëtimin e tyre.

7.2. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 98,950 mijë lekë.

7.3. Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga agjenti tatimor UK SH.A Fier-Mallakasër prej 811 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

Statusi i rekomandimeve 7.1, 7.2 dhe 7.3: Të pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 199, datë 20.07.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. E.B , z. A.R , znj. L.S , z. M.M dhe z. H.M për analizimin dhe hartimin e planit të masave në zbatim të Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Për sa i përket detyrimeve të pa arkëtuara nga abonentët familjarë paraqiten më datë 78,615,454 lekë. Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Mallakastër nuk është hartuar një plan masash për arkëtimin e këtyre detyrimeve por thjesht ka mbetur në fazën e urdhrit për ngritjen e grupit të punës. Gjithashtu nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore 811,000 lekë nga Agjenti Tatimor Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Fier-Mallakastër.

Rekomandimet 7.1, 7.2 dhe 7.3, janë në proces zbatimi

8.1.Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me arkëtimin e gjobave për vitin 2023: konstatohet se janë vendosur 5 (pesë) gjoba, me vlerë totale 882,099 lekë, janë paguar dhe arkëtar 4 (katër) prej tyre me vlerë totale prej 350,000 lekë, ndërsa për konstatimin me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, si dhe vendim për dënimin me gjobë me nr. 000014, datë 10.02.2023, me vlerë 532,099 lekë, nga ana e kryeinspektori është bërë kërkesa nr. 1813, datë 14.04.2023, për lëshimin e urdhërit ekzekutiv, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

8.2. Rekomandimi Kryeinspektori i IVMT Bashkia Mallakastër në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Mallakastër.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga analiza e trajtuar më sipër ky rekomandim 8.1, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e të ardhurave të munguara

në vlerën 228,066 lekë ndaj subjektit “A Sh.P.K”, si rrjedhojë e diferencës së krijuar nga përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga OE “A ” Shpk është shlyer detyrimi ndaj Bashkisë Mallakastër në vlerën 228,066 lekë nëpërmjet transaksionit me numër reference P231026AEZBOP14, datë 26.10.2023, në R. B. drejt Degës së Thesarit Mallakastër për llogari të Bashkisë Mallakastër.

Rekomandimi është zbatuar

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Mallakastër vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**”, për:

-Z. M.M, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, si dhe procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-46), (2.4) faqe (54-92), dhe (2.5) faqe (92-102) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Z. A.R, me detyrë Drejtor i Financës, për mangësitë e konstatuara planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si dhe në hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-46) dhe pikën (2.3) faqe (46-54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Z. E.A, me detyrë Drejtor i Bujqësisë, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-46) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Znj. E.S, me detyrë Përgjegjës i sektorit të pyjeve, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-46) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Z. A.X, me detyrë Kryeinspektori IVMT-së Mallakastër, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit, si dhe në procedurat e prokurimit publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) dhe pikën (2.6) faqe (102-108) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Z. F.M, me detyrë Anëtar i NJP, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. A.S, me detyrë Kryetar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. F.B, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. K.S, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

Z. E.B, me detyrë Kryetar i KVO, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. N.S, me detyrë Anëtar i KVO, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. A.XH, z.E.G dhe z.A.M, me detyrë Agjent Tatimor pranë NJA-ve, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit).

-Z. E.Y, me detyrë Anëtar i NJP dhe i Komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).

-Z. E.H, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. A.B, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. B.Y , me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. P.G , me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. Q.L, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. E.BN, me detyrë Anëtar i komisionit të përlllogaritjes së fondit limit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-92) të Raportit të Auditimit).*

-Z. B.V , me detyrë nëpunës në sistemin e-leje, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (92-102) të Raportit të Auditimit).*

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Me Urdhrin nr. 260, datë 14.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër është ngritur komisioni disiplinor për analizimin e rekomandimeve të KLSH-së, masa disiplinore për nëpunësit civil i përbërë nga znj. L.S kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. J.LL, znj. M.Q , znj. A.H, znj. M.SH . Deri më datë 31.12.2023, nga komisioni i sipërpërmendur nuk është hartuar një relacion përkatës mbi masat disiplinore.*

Rekomandimi është në proces zbatimi

D.1. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësin e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Vërejtje”** për:

▪ z. B.J., ish Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave në Bashkinë Mallakastër, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-46) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 16, datë 16.02.2024)

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Mallakastër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore.

-Nuk janë hartuar plane vjetore të miratuara nga titullari i institucionit për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave vjetore.

-Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshmen dërguar pranë MFE-së nuk përfshin të gjithë kapitujt dhe elementët përkatës.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pika 2-3, 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut”, Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, hapi 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan parregullsitë, si më poshtë:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

-Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Nga shqyrtimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm për Bashkinë Mallakastër, pika 1 e saj, “Objekti i kartës së auditimit të brendshëm” nuk është përditësuar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e cila nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

-Në planin strategjik nuk është paraqitur volumi i punës që do të kryhet në 3 vitet e ardhshme (por është paraqitur për vitet 2022-2024) pra nuk është parashikuar veprimtaria që do të zhvillohet nga NJAB në vitin 2025, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2.

-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konformë me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Mallakastër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemi i Prokurimeve, Sistemi i Pagave, Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit, ku sipas përcaktimit të bërë në kapitullin nr. 3.1.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për të përcaktuar kohën për kryerjen e auditimeve merret në konsideratë niveli i riskut për çdo sistem. Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Mallakastër, të marrë masa:

-Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

-Gjithashtu nga Përgjegjësi i NjAB-së të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Referuar buxhetit vjetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak Mallakastër me Vendimin nr. 70, datë 19.12.2022, të ardhurat së bashku me transfertat e pakushtëzuar, sektoriale dhe të kushtëzuara janë në vlerë 1,087,483,820 lekë dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,087,483,820 lekë. Buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Në hartimin e buxhetit vjetor Bashkia Mallakastër ka përfshirë edhe fondet e kushtëzuara në vlerën 267,046,820 mijë lekë. Në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 104, këto fonde nuk mund të miratohen si pjesë e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore por përdoren vetëm për financimin e funksionit të deleguar, projekte të veçanta dhe sipas llogarisë ekonomike për të cilin është dhënë ose sipas përcaktimeve të legjislacionit apo marrëveshjes. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme në hartimin e buxhetit vjetor të përfshihen vetëm ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar/specifike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 820,442 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 870,641 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 605,412 mijë lekë ose në masën 69%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 322,848 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 293,316 mijë lekë ose në masën 90%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 223,802 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,265 mijë lekë ose në masën 39%.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 8,673 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,511 mijë lekë ose në masën 52%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 219,320 mijë lekë ose në masën 72%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 300,860 mijë lekë dhe realizuar 219,320 mijë lekë ose në masën 71%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mallakastër në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, germa “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, Udhëzimit MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit MFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.2.1-2.2.5, faqe 35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Mallakastër nuk administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Gjithashtu nuk disponohet një korrespondencë shkresore me Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me raportim mujor apo vjetor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44, UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.2.1-2.2.5, faqe 35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për hartimin e raporteve mujore dhe atë vjetor mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, duke informuar edhe njëkohësisht Këshillin Bashkiak Mallakastër dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë dhe zbatimin e buxhetit të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mallakastër më datë 01.01.2023, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 10,419,769 lekë. Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2023 nuk është parashikuar asnjë fond për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 nuk është likuiduar vlera e detyrimeve të prapambetura 10,419,769 lekë, por janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 19,805,360 lekë si pasojë e humbjes së vendimeve gjyqësore. Raportimi në MFE i detyrimeve

të prapambetura nga Bashkia Mallakastër është kryer me shkresën nr.440 prot, datë 29.01.2024, detyrimet e prapambetura janë raportuar në vlerën 10,419,769 lekë.

Nga verifikimi i faturave të palikujduara rezultoi se më datë 31.12.2023, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën 22,226,489 lekë.

Detyrimet e Bashkisë Mallakastër vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive. Në këto kushte likuidimi i këtyre faturave nuk mund të kryhet.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1-2.2.5, faqe 35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

6.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 394,650,000 lekë dhe realizimi në vlerën 191,560,521 lekë ose në masën 48% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 203,089,479 lekë.

Referuar vlerës 203,089,479 lekë të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

“Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 37,576,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,035,861 lekë ose realizuar në masën 13%, “Taksë toke” është planifikuar në vlerën 26,226,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,863,521 lekë ose realizuar në masën 52%,

“Taksë ndotje mjedisi” është planifikuar në vlerën 122,446,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 59,136,080 lekë ose realizuar në masën 48%, “Taksa e kalimit të pronësisë” është planifikuar në vlerën 24,439,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë ose realizuar në masën 0%.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 3,442,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,660,495 lekë ose realizuar në masën 309%, “Tarifë për dhënie leje, liçenca dhe autorizime është planifikuar në vlerën 1,824,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,107,926 lekë ose realizuar në masën 170%, “Regjistrimi i automjeti të përdorura” është planifikuar në vlerën 13,113,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,139,589 lekë ose realizuar në masën 107%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim-Taksave, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Mallakastër në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Mallakastër dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mallakastër. Bashkia Mallakastër ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Mallakastër, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjykitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në nënparagrafin 2.2.6, faqe 42-52 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

8.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjykitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Mallakastër kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim-Taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Mallakastër i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë

30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Mallakastër, të marrin masa për planifikimin e fondeve për blerjen e një programi kompjuterik ku të përfshihet Sektori i Financë dhe Sektori i Taksave Vendore për mbajtjen veprimeve kontabël dhe të detyrimeve fiskale me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

9.2. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Mallakastër, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentët familjarë më të gjitha detyrime vjetore që ato kanë në zbatimin të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezulton se përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Mallakastër dhe njërive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023, gjithsej rezultojnë 6 subjekte të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Mallakastër të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë, kërkesë për bashkëpunim nga Sektorit të Tatim Taksave dhe Policisë Bashkiake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa “b” dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

Deri më datë 31.12.2024

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi të ardhurat e realizuara nga kontratat e qirave për sipërfaqeve pyjore, kullimore dhe inproduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Mallakastër, rezulton se në territorin e Bashkisë Mallakastër ushtrojnë aktivitet 2 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullimore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private, konkretisht:

1. Subjekti “**F**” **ShPK** me Nipt L...D, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1829, datë 29.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Drizari, Hekal për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.144 km² ose 14.4 ha

2. Subjekti “**C**” **ShPK** me Nipt L...A, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1868, datë 08.04.2019, për shfrytëzimin e vendburimit Povel Grashicë për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.033 km² ose 3.3 ha.

Veprime në kundërshtim me nenin 17, i Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, i Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9

dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Deri më datë 31.12.2024

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike janë konstatuar problematikat si më poshtë:

-Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit të Bashkisë Mallakastër nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 85, germa “c”.

-Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të Bashkisë Mallakastër të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se është nxjerrë jashtë përdorimit **vlera totale 4,702,409 lekë** për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,110,070 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,592,339 lekë. Nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë kontabilitetit është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbalin e asgjësimit të aktiveve). Gjithashtu është nxjerrë jashtë përdorimit **vlera 1,517,730 lekë** që i përket llogarisë 532 “Vlera të tjera” është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbal mbi asgjësimin e biletave të tregut, parkimit dhe biletave për therje bagëti gjedhi).

-Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se është nxjerrë jashtë përdorimit **vlera totale 1,475,891 lekë** për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 1,423,891 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 52,000 lekë. Nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë kontabilitetit është kryer pa dokumentacion justifikues (procesverbalin e asgjësimit të aktiveve). Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandim: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

12.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **7,696,030 lekë** e ndarë kjo për Bashkinë Mallakastër vlerën 6,220,139 lekë për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,110,070 lekë, llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,592,339 lekë, llogarinë 532 “Vlera të tjera” në vlerën 1,517,730 lekë dhe për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike vlerën 1,475,891 lekë për llogarinë 327 “Inventar i imët” në vlerën 1,423,891 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 52,000 lekë që i përket aktiveve apo letrave me vlerë të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion

justifikues. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

Deri më datë 31.03.2025

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 159,129,766 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 193,554,879 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 48,897,392 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,729,649 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është mbivlerësuar në vlerën 133,927,838 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 49-50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 61,111,859 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 61,697,234 lekë me një rritje në vlerën 58,375 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 1,192,034,397 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Sektorit të Tatim Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2025

15. Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 10,422,499 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,419,769 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 10,419,769 lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohet në

llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

16. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 60,557,883 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 19,546,668 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 80,104,551 lekë. Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Sistemi i furnizimit me ujë nga burimi i Poçemit për qytetin e Ballshit” në vlerën 21,405,216 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Gjithashtu për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 66-69, VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), pika 5 dhe germa “d”, pika 36, “Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogaritët me metodën lineare me normë amortizimit 15%”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për:

-Sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 21,405,216 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

-Aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

17. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 718,330,558 lekë kosto historike është përfshirë vlera 653,605,722 lekë për 146 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

b. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 708,932,190 lekë kosto historike është përfshirë vlera 322,013,137 lekë për 143 objekte e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Mallakastër (në formë tabelore në programin Excel) e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë

27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se përpara vitit 2023 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 62,500,417 lekë në Shoqërinë U (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Mallakastër. Në lidhje me këtë situatë nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Mallakastër dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë U për vlerën kontabël 62,500,417 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Deri më datë 31.12.2024

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 34,640,004 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare U me Nipt K...N është 621,858,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale U me Nipt M...G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër 34,640,004 lekë ose 5.49% ($5.49 \cdot 621,858,000 / 100 = 34,640,004$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare B me Nipt L...Q është 2,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Mallakastër është 500,000 lekë ose 25% ($25 \cdot 2,000,000 / 100 = 500,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

20. Gjetje nga auditimi: Llogaria 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 25,795,965 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 19,546,668 lekë dhe pakësim në vlerën 25,795,965 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë. Kjo llogari përbëhet nga dy projekte Studim Projektim “Ndërtimi Ujësjiellësit të fshatrave të Njësia Administrative Aranitas” në vlerën 9,303,986 lekë dhe Studim Projektim “Ndërtim i Ujësjiellësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë” në vlerën 10,546,668 lekë të përfunduara dhe të likuiduara dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 19,546,668 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të projekteve të përfunduara dhe të likuiduara që i përkasin llogarisë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” duke i kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Deri më datë 31.03.2025

21. Gjetje nga auditimi: Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 213,850,186 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 669,570,307 lekë dhe pakësim në vlerën 213,850,186 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 669,570,307 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie janë përfshirë 8 kontrata punimesh, mbikëqyrje dhe kolaudimi të përfunduara dhe të likuiduara në vlerën 171,116,853 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 171,166,853 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të kontratave të përfunduara dhe të likuiduara të punimeve, supervizorit dhe kolaudimit që i përkasin llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” duke i kontabilizuar në llogaritë 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

Deri më datë 31.03.2025

22. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 19,546,668 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 669,570,307 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 689,116,975 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, germa “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2025

23. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Mallakastër dhe Njësive Administrative Ballsh, Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar, Selitë, rezulton se:

Me VKM i janë kaluar kësaj njësie vendore, gjithsej 1652 pasuri përdorim/pronësi, por nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, konstatohet se nga Bashkia Mallakastër disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel dhe jo regjistër fizik, në të cilin evidentohen analitikët e këtyre llogarive me emërtimin dhe vlerën përkatëse por nuk paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Mallakastër të cilat janë të evidentuara në kontabilitet asnjë prej tyre nuk posedon titull pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Mallakastër të kaluar me VKM, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështje Sociale Bashkia Mallakastër, të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,489,713 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 698,822 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,330,767 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 734,579 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 10,729,649 lekë ku totali shkon në vlerën 20,983,530 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 28,708,429 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.

8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

25. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Mallakastër në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 94,675,833 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Mallakastër. Për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Mallakastër janë ngurtësuar fonde në vlerën 39,937,791 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Mallakastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 39,937,791 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, u konstatua se kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 3,977,574 lekë si rrjedhojë e mos kontabilizimit të detyrimeve për shpronësim. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, funksionimi kontabël i llogarive të Klasës 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë Mallakastër ndaj të tretëve, në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Deri më datë 31.03.2025

27. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,861,939,155 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 251,052,915 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,865,460 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 251,052,915 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 8,865,460 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera

neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 546,104,586 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

27.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

29. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit 192,162,428 lekë pa TVSh dhe realizim kontrate 127,847,465 lekë pa TVSh. Nga auditimi i 6 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Mallakastër për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, me fond limit 192,162,428 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 127,847,465 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në aplikimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

-Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 192,162,428 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 127,847,465 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

-Në 4 procedura nga 6 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 118,537,965 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Mallakastër, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

-Në 3 procedura prokurimi, preventivat e punimeve janë hartuar nga punonjës të Bashkisë Mallakastër të cilët nuk janë të pajisur me liçensat përkatëse profesionale në fushën e në fushën e projektimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa “a” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1-2.4.3, faqe 76-131 të Projekt Raportit të Auditimit)*.

29.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në hartimin e projekteve nga persona të palicesuar, në dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji-shkolla)” viti 2023 me fond limit 78,253,438 lekë pa TVSh dhe “Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës)” viti 2023 me fond limit 78,651,909 lekë pa TVSh konstatohet se, këto procedura kanë iniciuar pa u siguruar fondet përkatëse. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1-2.4.3, faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të marrë masa që, përpara nisjes së procedurave të prokurimeve, garatimin e fondeve me qëllim realizimin e objektit që prokurohet. Gjithashtu për procedurat e prokurimit të cilat e kanë afatin kohor të zbatimit të kontratës për më tepër se një vit, të kryhet parashikimin i likuidimit të tyre që në fazën e PBA-së sipas listës analitike të investimeve dhe buxhetit vjetore sipas viteve përkatëse që do të kryhet zbatimi i kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike)” viti 2023 me fond limit 21,477,925 lekë pa TVSh konstatohet se, nuk argumentohet sasia e kërkuar prej 130,830 litra diezel (naftë), konkretisht në dokumentin e mbajtur nga komisioni për përlogaritjen e fondit limit nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimet e viteve të mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet së bashku me plan shpërndarjen për mjetet e flotës së institucioni. Gjithashtu në përbërje të Njesisë së Prokurimit nuk ka asnjë specialist fushe për objektin që prokurohet. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 2, neni 76, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1-2.4.3, faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Përgjegjësi i Sektorit të Transportit të marrin masa që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant naftë, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e institucionit.

31.2. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të merren masa që, në Njësinë e Prokurimit të përfshijë specialist të fushës me qëllimin hartimin me objektivitet të kriteret të veçanta për kualifikim apo specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: a. Në auditimin e 20 procedura me vlerë të vogël në Aparatin e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike me fond limit 14,020 mijë lekë ose 82% e vlerës së fondit të prokuruar, nga e cila: për aparatin e bashkisë në 15 procedura me fond limit 10,239 mijë lekë pa TVSh dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në 5 procedura me vlerë të vogël me fond limit 3,781,358 lekë pa TVSh, janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

- Në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim konkretisht:
- Në 7 raste nga KPVV është hartuar një preventiv i cili i referohet studimit të tregut, por në këtë dokument nuk evidentohet ku janë marrë ofertat për studimin e tregut.
- Në 8 raste nuk dokumentohet mënyra e përlogaritjes së fondit limit.
- Në 16 raste nga KPVV nuk është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriteret të veçanta të pranimit.
- Në 3 raste në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë), pra kalimi nga një operatorë ekonomik tek tjetri në rastet e s’kualifikimit apo të tyre.

-Në 6 raste faturat tatimore nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 1 rast nuk disponohet një procesverbal i cili duhej të mbahej nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla ku bashkëlidhur të evidentohet lista e nënshkruar nga të gjithë personat që kanë marrë këtë shërbim.

-Në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë për procedurën “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” viti 2023 me fond limit 799,972 lekë pa TVSh dhe “Blerje veshje për punonjësit” viti 2023 me fond limit 799,550 lekë pa TVSh.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56, pika 1, 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36 dhe 42, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 7 dhe pikat 11-12. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1-2.4.3, faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese (sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

32.2. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Mallakastër dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese (sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e fondit limit, në publikimin e Sistemin e Prokurimit Elektronik, në ngritjen e komisionit për marrjen e mallrave në dorëzim, etj.,.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Në total mjetet të cilat do të furnizohen me karburant naftë (diezel) referuar kontratave me objekt “Blerje karburant (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)” me nr. 1149/9 prot., datë 16.05.2023, dhe nr. 50/4 prot., datë 03.05.2023, janë 29 të llojit Autoveturë, kamion, eskavator, skrep, traktor me goma, zjarrfikëse, kamionçinë, autobot uji, auto fshirëse, transportier, rul etj., të cilat përbëjnë flotën e mjeteve të institucionit.

-Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e mjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.,. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi pronësinë e mjeteve me zgjedhje konstatohet se, 26 mjete nuk janë të pajisura me çertifikatë të kontrollit teknik dhe 3 mjete të tipit Eskavator Volvo me numër shasia VC220DH00280406, Skrep Fai me numër shasia 96DTE12208043 dhe Eskavator Mini Cat me numër shasia CAT0308CKKCX02052, pjesë të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë pra nuk disponojnë çertifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22, Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, neni 4, germa “a”, Ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 2, pika 1, germa “a”, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58, neni 113 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat

5-10, dhe pikat 35-36. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të hartohen kartelat përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve.

33.2. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të merren masa për pajisjen me certifikatë pronësie, certifikatë të kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësisë ndaj palëve të treta për mjetet të cilat nuk i disponojë këto dokumentacione duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin nr. 6, datë 02.02.2022, të z. Q.I Kryetar i Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. A.H , z. F.B dhe z. E.H për caktimin e normativave për konsumin e karburantit për mjetet e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike. Në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur grupi i punës më datë 10.02.2023, është mbajtur procesverbali për miratimin e normativave mbi konsumin e karburantit për mjetet e flotës së Bashkisë Mallakastër (i vetmi dokumentacion i cili disponet nga institucioni për miratimin e normativave).

Nga grupi i punës i sipërpërmendur nuk është kryer një analizë mbi konsumin e karburantit për mjetet që kanë njësi matëse kilometrazhin apo orët/volumet e punës konkretisht nuk janë kryer testime në rrugë nacionale dhe urbane apo rurale (në varësi të përdorimit të mjetit) në të cilën të evidentohen kilometrat në fillim dhe në fund të lëvizjes së mjetit (për 100 km) si dhe nuk janë kryer testime duke u ndërthurur orët e punës me volumet e punës si gjurmime, pastrime, shtrim rruge etj., (në varësi të përdorimit të mjetit/makinerive) me qëllim pasqyrimin sa më real mbi përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5, 10, 19 dhe 35-36. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të merren masa në të ardhmen që, përpara fazës së miratimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e testimeve përkatëse të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve me qëllim caktimin e normativave sa më reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe me certifikatë përdorimi për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, u konstatua se:

-Në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i distancave nga objektet e tjera;

-Në **4 raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore;

-Në **2 raste**, Bashkia Mallakastër dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, neni 17, pika 4, 6, Ligjin nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, neni 52 dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, neni 15, 18, 21, 34, 27 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 144-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHITLP), Bashkia Mallakastër të marrë të gjitha masat që për çdo leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi të respektohen kondicionet urbane, duke i plotësuar ato me dokumentacione e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, duke u siguruar mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve.

Për subjektet që kanë hartuar projektin ndërtimor të kërkohet në çdo rast dokumentacioni që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, të kërkohet dhe respektohet mendimi i autoriteteve publike në lidhje me miratimin e këtyre lejeve, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër, konstatohet se struktura e IMTV për vitin 2023 nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 11. Në strukturën e IMTV ka vetëm një punonjës me profil arsimimi teknik, si inxhinier ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj., profile të cilat janë të specializuara në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, në cilësinë e kryeinspektorit. Gjithashtu, konstatohet se një prej inspektorëve të IMTV, Bashkia Mallakastër, nuk është me arsim të lartë, por me arsim të mesëm (teknik ndërtimi). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 150-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor të profileve teknike që kanë lidhje me ndërtimtarinë, sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu, në vijim, nga ana e Bashkisë Mallakastër, të plotësohet struktura e njësisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor vetëm me punonjës që kanë arsimim të lartë, sipas përcaktimeve ligjore, duke synuar rekrutimin e stafit me profil arsimimi teknik.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT Bashkia Mallakastër për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, rezulton se:

Janë mbajtur gjithsej **5** (pesë) proces-verbale konstatimi, nga të cilat janë nxjerrë **5** (pesë) vendime për dënim me masë administrative (gjobë) me vlerë **882,099 lekë**, është marrë **1** (një) vendim për pezullim punimesh dhe asnjë vendim për prishje të objekteve të kundërligjshëm.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, konstatohet se nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm nga kryeinspektori, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000135, datë 09.02.2023, si dhe në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 000137, datë 08.05.2023, konstatohet se në asnjë prej këtyre rasteve nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve, veprim ky jo në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

Në lidhje me proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes 000138, datë 25.09.2023, është marrë masa ndëshkuese me gjobë me vlerë 50,000 lekë, por nuk është nxjerrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika “d”.

Në lidhje me proces-verbale të konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, (referuar Tabelës nr. 2), konstatohet se në asnjë prej këtyre rasteve evidentimi i shkeljes nuk është kryer nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, por informacioni ka ardhur nga Prokuroria, veprime këto në kundërshtim me

nenin 1, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, nenin 5, pika “a”.

Në lidhje me proces-verbalet e konstatimit nr. 1, dhe nr. 4, (referuar Tabelës nr. 2), konstatohet se në asnjë rast IMTV nuk ka njoftuar dhe kërkuar asistencë nga IKMT për prishjen e këtyre ndërtimeve, në kushtet e mungesës së mjeteve të përshtatshme për kthimin në gjendjen fillestare nga ana e Bashkisë Mallakastër. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 52, të Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 150-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Mallakastër të marrë masa për:

-Të ndjekur me përpikmëri procedurat administrative dhe inspektuese, të parashikuar në legjislacion dhe rregullore, në lidhje me inspektimin, evidentimin, si dhe ndërmarrjen e masave administrative, për të gjithë kundërvajtësit e konstatuar në shkelje të dispozitave ligjore;

-Të nxjerrë vendimin e pezullimit të punimeve, në çdo rast që subjektet zhvilluese kanë nevojë për hapësirë kohore për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit justifikues të konstatimit të IMTV;

-Të nxjerrë vendimet e prishjes së objekteve të konstatuar në mospërputhje me ligjin, edhe nëse për këto çështje palët mund të jenë në procese gjyqësore;

-Të merren masa për të njoftuar rast pas rasti, autoritetet kompetente, në këtë rast IKMT, për të kërkuar asistencë prej tyre për prishjen e objekteve të kundërligjshme, në kushtet kur IMTV nuk është e pajisur me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të prishjes;

-Të merren masa për kryerjen e inspektimeve periodike për evidentimin e kundërvajtjeve, sipas përgjegjësisive përkatëse dhe sipas planeve të punës, mujore dhe vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Mallakastër, nuk ka kryer detyrat e tij funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit, *konkretisht*:

b. Çertifikatë përdorimi për shtesë kati (banim) mbi objekt ekzistues, me adresë në fshatin Hekal, Bashkia Mallakastër, me zhvillues z. B.P , për të cilën është marrë Vendimi nr. 01, datë 07.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar aktit përfundimtar të kolaudimit, i cili është hartuar në datën 15.11.2022, shprehem se zhvilluesi nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit të parashikuar në lejen për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, pra brenda datës 15.10.2022. Në sistemin e-lejet, si dhe nga auditimi i aktivitetit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) është konstatuar se nuk është marrë asnjë masë ndaj subjektit zhvillues për shkelje të afatit të punimeve. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 52 të Ligjit 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika dh). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 150-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

39.1. Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Licencave dhe Projekteve (DAZHHTLP), Bashkia Mallakastër të marrin masa për rritjen e bashkëveprimit ndërstrukturor me qëllim respektimin e dispozitave ligjore në lidhje me afatet e përfundimit të punimeve të objekteve me leje të miratuara. Nga ana e DAZHHTLP të merren masa për të informuar zyrtarisht IMTV për të gjitha rastet që miratohet dokumenti “Njoftim për Fillimin e Punimeve”, si dhe të merren masa nga IMTV për të inspektuar në mënyrë periodike respektimin e afatit të përfundimit të punimeve nga zhvilluesit e objekteve të miratuara.

Menjëherë dhe vijimësi

40. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 204/8 prot., datë 11.07.2023, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me nr. 1014/16 prot., datë 12.07.2023, ku janë lënë për zbatim 29 masa organizative, 1 masë për shpërblim dëmi në vlerën

112,566 lekë dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 846,572 lekë, 14 masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 1,171,333,912 lekë dhe 20 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 23 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë në vlerën 112,566 lekë e cila është janë pranuar plotësisht, nga masa e pranuar 1 masë është e pa zbatuar.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 2 masa në vlerën 846,572 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe **1 masë është e pa zbatuar.**

d. Për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 14 masa në vlerën 1,171,333,912 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 9 masa janë në proces zbatimi.

e. Masa disiplinore janë rekomanduar 20 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 20 masa janë në proces zbatimi.

Gjithashtu nga Bashkia Mallakastër nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “c”, neni 30, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 152-172 të Projekt Raportit të Auditimit).*

40.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

40.2. Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësisht edhe afatin e raportimit.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

B.1.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandimet nr. 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2, 4.1, 7.1, 7.2, 8.1, 9.1, 10.2, 10.4, 11.1, 11.2, 12.1, 15.1, 20.4, 21.1, 22.1, 22.2, 22.3, që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet përveç rekomandimit nr. 22.3.

22.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT në vlerën **750,000 lekë.**

Në vijimësi

B.1.2. Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **621,602 lekë pa TVSh** nga BOE “SH” ShPK, & “A” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1604 prot., datë 17.07.2019, me objekt “Ndërtim shëtitore nga shkolla “O” deri tek varrezat e qytetit”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,914 lekë pa TVSh** nga OE “A ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 462 prot., datë 15.02.2019, me objekt “Rikualifikim i bllokut të pallateve të TEC-it, Lagjja “5 Shkurti”, Bashkia Mallakastër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

B.1.3. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimin e mëparshëm

Rekomandimet nr. 1.1, 2.1, 2.2, 2.3, 3.1, 6.1, 7.1 dhe 8.1, që i përkasin kategorisë masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimin e mëparshëm të cilat nuk janë zbatuar dhe nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës totale prej 304,667,354 lekë, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, që i përkasin situatës së borxhit tatimorë. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet.

Menjëherë dhe vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: -Për periudhën nga data 01.08.2023, deri më 31.12.2023, nga drejtuesit e mjeteve të Bashkisë Mallakastër duke përfshirë edhe Sektorin e MZSH-së në total është tërhequr nga magazina dhe konsumuar sasia e karburantit 3,834 litra naftë në vlerën 729,534 lekë.

Nga auditimi i praktikës së mbajtjes së dokumentacionit justifikues në Bashkinë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në fletët e udhëtimit nuk paraqiten të dhënat sa është kilometrazhi i mjetit në fillim dhe në përfundim të lëvizjes por është përmbledhësja ditore e kilometrave të përshkruara nga secili mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

Për mjetet që njësi matëse kanë volumet dhe orët e punës në fletët e udhëtimit nuk ndodhet i përcaktuar vendi i punës (sipas rrugëve apo kanaleve etj., për çdo ditë pune), objekt i punës, orari i nisjes dhe përfundimit të punës, gjatësi/distanca e rrugë apo kanaleve në të cilën është kryer punimi apo pastrimi, fotot e punimeve të realizuara por ndodhet vetëm përmbledhësja e volumeve dhe orëve të punës dhe e datave të bashku me vendin e punës (emërtimi sipas njësisë administrative) për secilin mjet. Për më tepër nuk disponohet edhe dokumentacioni si kërkesë për nevojën e furnizimit, program pune apo urdhër pune, autorizim etj.,.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5, 10, 19 dhe 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4, faqe 131-144 të Projekt Raportit të Auditimit).*

41.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të dokumentojë të gjithë procesin e konsumit të karburantit, duke hartuar rregulla në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit të shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet dhe pajisjet e institucionit, si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) “Të drejtat e KLSH”, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë**

publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **26,259,410 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush” me REF-34714-06-28-2022, me nr. 3408/9 prot., datë 27.09.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, dhe Kontraktorit OE “C” Shpk. Vlera e kontratës është 109,498,855.68 lekë me TVSh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. **1.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorrush” dhe “Diga e Rezervuarit-Kutë” u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës. Sipas detajit teknik në projektin e zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm; në terren kjo gjë nuk është respektuar në disa pjesë të rrugës. Konkretisht në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorrush” ishte realizuar shtresën (binder + asfalt) më një lartësi totale mesatarisht 7 cm dhe në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Kutë” ishte realizuar shtresa (binder + asfalt) më një lartësi totale mesatarisht 9 cm. Në total për segmentet rrugore vlera e dëmit ekonomik shkon 12,440,493 lekë pa TVSh. **2.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Kutë” dhe “Diga e Rezervuarit-Çorrush” u vunë re disa çedime në rrugë në disa pjesë të sajë me një sipërfaqe totale 50 m², të cilat kanë efektin ekonomik 128,100 lekë pa TVSh. **3.** Në segmentin rrugor “Diga e Rezervuarit-Çorrush” në disa pjesë të tije u vu re se nënshtresa e rrugës nuk ishte realizuar me mbushje me çakëll 30 cm sipas projektit; por ajo ishte realizuar 10 cm në një gjatësi rreth 150 ml me efekt ekonomik 99,750 lekë pa TVSh. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **12,668,343 lekë pa TVSh** (12,440,493 + 128,100 + 99,750) e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “C” Shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **12,668,343 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “C” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj” me nr. REF-35560-07-06-2022, me nr. 3486/13 prot., datë 05.10.2022, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, dhe Kontraktorit OE “S” ShPK. Vlera e kontratës është 129,202,020 lekë me TVSh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. **1.** Në segmentin rrugor fshati Dukas u vu re mos respektim i detajeve teknike të profilit tërthor të rrugës në (Segmentin 3’). Sipas detajit teknik në projektin e zbatimit shtresa e binderit është 6 cm dhe shtresa e asfaltit 4 cm. Në terren ka ndodhur një shmangie nga projekti i zbatimit, u vu re se ishte realizuar vetëm shtresa binder me një lartësi totale 6 cm dhe jo shtresa e asfaltit; duke patur efektin ekonomik 656,640 lekë pa TVSh. **2.** Nga kontrolli në terren dhe i dokumentacionit tekniko-ligjor të dosjes së objektit pjesa “Materiali fotografik për punimet e kryera në objekt” u vu re se muret mbajtëse ishin kryer duke mos respektuar vizatimet teknike, nga dy fije vertikale shpërndarëse në projekt në një fije shpërndarëse vertikale, duke patur një efekt ekonomik 227,500 lekë. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **884,140 lekë pa TVSh** (656,640 lekë + 227,500 lekë) e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori “S” ShPK, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin

dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **884,140 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “S ” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrejtit të jashtëm të ujësjesit rajonal (nga burimi i Poçemit)” me nr. 777/7 prot., datë 06.07.2021, lidhur midis AK Bashkia Mallakastër, përfaqësuar nga titullari i sajë z. Q.I dhe Kontraktorit BOE “A ” ShPK & “E ” ShPK & “K ” ShPK. Vlera e kontratës është 568,485,331.72 lekë me TVSh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi si më poshtë vijon: **1.** Për zërin e punës “F.V.Tub cel. Ø(355.6 x δ=8,5)mm i h/izoluar ne fabrike L= 5710m” ka një pasaktësi në llogaritjen e peshës së tubit të çelikut. Kontraktori këtë zë e ka raportuar 429.91 ton ndërsa sipas llogaritjeve analitike referuar skedës teknike të prodhuesit ky zë shkon 392.91 ton; pra kemi një diferencë me efekt financiar prej 6,232,650 lekë pa TVSh. **2.** Referuar kapitullit “Depo 200 m³” në situacionin përfundimtar kemi futjen e disa zërave të rinj pune midis tyre kemi dhe zërin “F.V.Mates E.M. Dn 300mm PN-40” me çmimin 996,072 lekë/copë. Po të shihet me vëmendje ky zë pune ekziston në preventivin e ofertuar fitues të tenderit me çmimin 779,984 lekë/copë. Ky zë i ri me çmimin 996,072 lekë/copë nuk duhet të ishte pranuar në preventivin e rishikuar si nga ana e Mbikëqyrësit dhe nga ana e AK. Pra kemi një diferencë e që ka një efekt financiar 432,167 lekë pa TVSh. **3.** Referuar kapitullit “Tubacionet e transmetimit” në situacionin përfundimtar zëri “F.V.Stafe EF Dn (350 x110)mm” është raportuar 24 copë ndërsa në librezën e masave ky zë është raportuar 10 copë. Pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 219,856 lekë pa TVSh. **4.** Referuar kapitullit “Fuqia punëtoze Kabina” zëri i punës “Montim Transformatori fuqie 750kVA, 20/0.4kV” në situacionin përfundimtar është raportuar 30 copë, ndërkohë tek pjesa e pajisjeve ky zë është lënë 0 sepse transformatorët janë vendosur të tipit (1000kVA, 6/0.4 kV.) Pra kemi një diferencë me efekt financiar 28 copë x 9,450 lekë/copë = 264,600 lekë pa TVSh. **5.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “Germim shkëmbi i copëtuar me ekskavator 0.5 m³, shkëmb, ne themele gjerësi >2 m, me shk ne toke” është raportuar 20,003.49 m³ sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m³, pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 1,491,644 lekë pa TVSh. **6.** Referuar situacionit përfundimtar zëri “Shtrese zhavorri lumi t=30cm, përhapur e ngjeshur me makineri” është raportuar 22,824 m² sipas llogaritjeve analitike ky zë pune shkon 15,160.5 m², pra kemi një diferencë që ka një efekt financiar 3,831,750 lekë pa TVSh. **7.** Sipas kapitullit “Depo V=Rrethi i depos Klos” në situacionin përfundimtar zëri “Rrethim me zagarë metal.galv(zgar komplet)” është raportuar 167.20 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky rrethim ishte realizuar me një lartësi më të vogël me efekt financiar 122,569.04 lekë pa TVSh. **8.** Sipas kapitullit “Depo V=Rrethi i depos Klos” në situacionin përfundimtar zëri “Hidroizolim me emulsion me 2 duar bitum(nga jashtë)” është raportuar 119.27 m² ndërsa sipas matjeve faktike në terren ky zë nuk ishte kryer me bitum, me efekt financiar 66,791.2 lekë pa TVSh. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet në total vlera prej **12,662,028 lekë pa TVSh** (6,232,650 + 432,167 + 219,856 + 264,600 + 1,491,644 + 3,831,750 + 122,569.04 + 66,791.2); e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori BOE “A ” ShPK & “E ” ShPK & “K ” ShPK, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3. Rekomandimi: AK Bashkia Mallakastër, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për

arkëtimin e vlerës prej **12,662,028 lekë pa TVSh** nga Kontraktori BOE “A ” ShPK & “E ” ShPK & “K ” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 30.07.2024

4. Gjetje nga auditimi: Ndërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike përfaqësuar nga z. V.M Drejtor i NSHP-së dhe OE “E ” Sha përfaqësuar nga z. D.D Administrator i Kompanisë është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023, me objekt “Blerje filtra, vaj motori, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash viti 2023”, me vlerë 1,870,800 lekë me TVSh.

Me Urdhrin nr. 32, datë 30.08.2023, të z. V.M Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga z. E.Y , z. E.H dhe z. E.XH . Nga OE “E ” Sh.a është lëshuar fatura tatimore me nr. 174/2023, datë 19.09.2023, në vlerën 1,870,800 lekë likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 212, datë 09.11.2023. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 27, datë 19.09.2023, e cila përfshin secilin mjet referuar preventivit. Nga komisioni i sipërpërmendur është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim i datë 11.09.2023.

Për sa trajtuar më sipër mallrat janë sjell pranë Bashkisë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike 6 ditë me vonesë nga OE “E ” Sh.a duke u bazuar në fletë-hyrjen në magazinë dhe faturën tatimore përkatëse. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike **nuk janë aplikuar penalitetet në vlerën 44,899 lekë në momentin e likuidimit të kontratës** (Data e lidhjes së kontratës 30.08.2023, + 15 ditë afati i lëvrimit të mallrave shkon në datën 13.09.2023; Formula e përlllogaritjes së penalitetit $4/1000 * 1,870,800 \text{ lekë} = 7,483 \text{ lekë}$ penalitet për 1 ditë vonesë; 6 ditë penalitet * 7,483 lekë = 44,899 lekë penalitet) ndaj OE “E ” Sh.a. Veprime këto në kundërshtim me Kontratën nr. 76/5 prot., datë 30.08.2023, në nenin 5 “Dorëzimi” dhe nenin 17 “Dëmet e likuiduara”, germa “a” dhe DT Stojca nr. 6. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.4.4, faqe 131-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **44,899 lekë** nga “E ” Sh.a, për mos aplikimin e penalitetit si pasojë e mos dorëzimit të mallrave pranë AK brenda afateve të parashikuara në kontratë.

Deri më 30.07.2024

C. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 është shpenzuar vlerën 7,998,640 lekë, nga e cila vlera 2,998,640 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 2 raste, ndërsa vlera 5,000,000 lekë për 1 rast i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore (dëmshpërblim për shpronësimet). Për sa trajtuar më sipër **vlera 7,998,640 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Mallakastër.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. (Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.2.1-2.2.5, faqe 35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara

të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër konstatohet se deri më datën 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën **64,904,730 lekë** shumë e cili i përket vetëm abonentëve familjarë.

Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, është krijuar borxhi tatimor në **vlerën 6,462,724 lekë për abonentët familjar**. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datë 31.12.2023, është në vlerën **71,367,454 lekë**.

Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Mallakastër konstatohet se deri në datë 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën **1,114,815,925 lekë**. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2023, është në vlerën **1,107,401,700 lekë**.

Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, janë në vlerën **1,178,769,154 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër** e përbëra nga:

-Detyrime abonentët familjarë në vlerën **71,367,454 lekë;**

-Detyrime nga biznesi VIP në vlerën **1,074,888,444 lekë;**

-Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **11,207,733 lekë;**

-Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **8,985,573 lekë;**

-Detyrime nga institucionet në vlerën **12,319,950 lekë;**

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në nënparagrafin 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale **1,178,768,204 lekë**, e cila përbëhet nga:

-**71,367,454 lekë** detyrime nga **abonentët familjarë;**

-**1,074,888,444 lekë** detyrime nga **biznesi VIP;**

-**11,207,733 lekë** detyrime nga **biznesi i madh;**

-**8,985,573 lekë** detyrime nga **biznesi i vogël;**

-**12,319,000 lekë** detyrime nga **institucionet;**

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim-Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Tatim-Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mallakastër, për mos kalimin

e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me VKB nr. 61, datë 24.11.2022, është miratuar paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Mallakastër për vitin 2023, në të cilën janë përfshirë taksat dhe tarifat vendore për familjarët dhe abonentët privatë. Për abonentët e qytetit Ballsh është përcaktuar agjent tatimor Shoqëria Rajonale U e cila i tarifon abonentët sipas paketës fiskale në faturën mujore të ujit. Nga informacioni i përcjell nga Sektori i Tatim Taksave nga 2,221 familje në Njësinë Ballsh tarifohen vetëm 1,363 abonentë familjarë. Abonentët familjarë të përjashtuar nga tarifatat sipas paketës fiskale i përkasin kategorive të kryefamiljarëve të parashikuara në paketën fiskale. Sipas regjistrave për njësitë administrative numri i familjeve të njërive administrative është 7,248 familje të cilat nuk janë tarifuar për **vlerën 7,248,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara**, për tarifën e pastrimit për të cilën ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër. Tarifa e gjelbërimit dhe e ndriçimit nuk ofrohet si shërbim nga Bashkia Mallakastër dhe abonentët nuk janë tarifuar për këto shërbime.

Gjithashtu nuk janë tarifuar bizneset e mëdha të cilat kanë si adresë ushtrimi aktiviteti në njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër për tarifën e pastrimit në **vlerën 770,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara**.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 4, pika 7, neni 20, neni 20-24, dhe Paketa Fiskale miratuar me VKB nr. 61, datë 24.11.2022. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Administratorët e Njërive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve dhe bizneseve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të abonentëve familjarë dhe privat, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës pastrimit për vitin 2023, rezultojnë 8,018,000 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mallakastër.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është 9,385,810 lekë për 307 persona. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 426,844 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 38,864 lekë si dhe është krijuar detyrim për këtë taksë në vlerën 387,980 lekë për 12 persona. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në **vlerën 9,773,789 lekë e cila përbën të ardhura të munguara**.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit, Liçencave dhe Projekteve në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **9,773,789 lekë** ndaj **319** personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mallakastër me palët e treta konstatohet se:

a. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, por janë aktive 4 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2023 kanë qenë aktive 4 kontrata me sipërfaqe totale 1,020 m² me vlerë kontrate 729,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2023 OE “O” Sh.a **nuk ka shlyer detyrimin për kontratat në shumën 571,750 lekë.**

b. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Mallakastër ka lidhur 31 kontratë të reja për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave me vlerë kontrate 178,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2023 janë shlyer të gjitha detyrimet.

c. Bashkia Mallakastër administron 210 kontrata qiraje për tokën bujqësore në Njësitë Administrative Hekal, Qëndër, Aranitas, Selitë, Kutë dhe Fratar, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2013 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas VKM-së nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, konkretisht 7,000 lekë/Ha në vit.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Mallakastër nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithsej 1,368,387 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se **në fund të vitit 2023 janë debitor 127 subjekte në vlerën 2,432,960 lekë.** Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatëvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-52 të Projekt Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Bashkia Mallakastër, Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës, Mjedisit dhe Konsumatorit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit sipas kontratave të qirasë në shumë **3,004,710 lekë.**

1.2. Rekomandim: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mallakastër** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes, **për 2 punonjës**, respektivisht:

1. Z. A.M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë, mos mbajtjen e akt rakordimeve me agjentit tatimor UK Sh.A Fier, keq menaxhimin mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore.

2. Z. A.R, me status nëpunësi civil me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare.

F.1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", VKM nr. 115, datë 05.3.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil" dhe shkronja "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Mallakastër, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

H. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

H.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), Bashkia Mallakastër.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7/1 dhe 12, Kreu III, dhe nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar dhe Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 "*Per inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Per Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", për shkelje të

ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mallakastër, sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative (gjobë) për:

1. Subjekti OE “D ” Shpk përfaqësuar nga administrator z. N.XH , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr. 3408/9 prot., datë 27.09.2022 me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorush”, me Kontraktor punimesh OE “C ” Shpk, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 12,668,343 lekë pa TVSH.

2. Subjekti “M ” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. M.A , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr. 3486/13 prot., datë 05.10.2022 me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj”, me Kontraktor punimesh OE “S ” Shpk si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 884,140 lekë pa TVSH.

3. Subjekti BOE “G ” & “I ” Shpk, përfaqësuar nga administrator Z. G.B , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me nr.777/7 prot., datë 06.07.2021 me objekt: “Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)” me Kontraktor punimesh BOE “A ” Shpk & “E ” Shpk & “K ” Shpk, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 12,662,028 lekë pa TVSH.

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1. “Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit” nga faqja 35 deri 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela B.1. Ndryshimet e Buxhetit Bashkia Mallakastër:

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr/datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artikull (me emër)/ shtuar artikull (me emër)				
					Shtesa	Shuma	Pakësime	Shuma	
Viti 2023	Nr. 70, datë 19.12.2022	1,087,483,820	Nr. 10, datë 21.02.2023	4,711,425	230 + 231 (Investime)	4,711,425	230 + 231 (Investime)	33,973,600	
					602 (Shpenzime operative)	9,700,000			
					230 + 231 (Investime)	24,273,600			
			Nr. 32, datë 27.06.2023	5,021,918	600 + 601 (Paga dhe sigurime)	5,021,918	602 (Shpenzime operative)		17,000,000
					602 (Shpenzime operative (Shpronësime)	17,000,000			
			Nr. 36, datë 24.07.2023	7,618,176	600 + 601 (Paga dhe sigurime)	7,618,176			
			Nr. 41, datë 23.08.2023		230 + 231 (Investime)	150,000	230 + 231 (Investime)		150,000
					602 (Shpenzime operative)	1,500,000	602 (Shpenzime operative)		1,500,000
			Nr. 44, datë 28.09.2023		230+231 (Investime) Kap.01	53,288,580	230 + 231 (Investime) Kap.05		53,288,580
			Nr. 52, datë 30.10.2023	10,000,000	230 + 231 (Investime)	7,000,000			
600 + 601 (Paga dhe sigurime)	3,000,000								
Nr. 55, datë 30.11.2023		230 + 231 (Investime) Kap.01	36,000,000	230 +231 (Investime) Kap.05		36,000,000			

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr/datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artikull (me emër)/ shtuar artikull (me emër)				
					Shtesa	Shuma	Pakësime	Shuma	
			Nr. 69, datë 21.12.2023	22,849,000	602 (Shpenzime operative)		18,849,000		
					230 + 231 (Investime)		4,000,000		

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Tabela B.5. Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit:

000/Lekë

Nr.	Artikulli	Emërtimi	Buxheti sipas burimeve të financimit për vitin 2023						Tr. Kushtëzuar për funksione të deleguara	Totali
			Tr. Pakushtëzuar	Tr. Specifike	Të ardhurat	Totali pa fondet e kushtëzuara	Tr. Kushtëzuar për Investime 230-231	Tr. Kushtëzuar për funksione të deleguara		
1	600	Paga	96,629	79,115	75,150	250,894	0	7,739	258,633	
2	601	Sigurime	16,033	13,212	13,173	42,418	0	862	43,280	
3	602	Shpenzime Operative	29,547	15,359	43,359	88,265	0	2,673	90,938	
5	604	Transferta Korente të brendshme	848	0	0	848	0	5,911	6,759	
6	606	Transf. familje dhe individ	2,203	544	1,763	4,510	0	222,559	227,069	
7	609	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0	
8	230-231	Investime	161,081	0	58,238	219,319	505,527	0	724,846	
Totali			305,494	108,231	191,686	605,406	505,527	239,744	1,350,677	

Tabela B.7. Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2023 jepen në vijim:

Lekë

Kodi i detyrimit të prapambetur	Emërtimi i detyrimit të prapambetur	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2022	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2023 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2023 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2023 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2023)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2023 (situata më 31.12.2023)	Vlera e paguar gjatë vitit 2023 për detyrimin e prapambetur	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8	9=3+7-8
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta								
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore	945,792	0	0	945,792	19,805,360	7,998,640	12,752,512
4864200	Detyrime për shërbime dhe mallra	844,928	0	0	844,928	0	0	844,928
4864300	Detyrime për mirëmbajtje	0	0	0	0	0	0	0
4864400	Detyrime për investime	3,978,037	0	0	3,978,037	0	0	3,978,037
4864900	Detyrime të tjera	4,651,012	0	0	4,651,012	0	0	4,651,012
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta		10,419,769	0	0	10,419,769	19,805,360	7,998,640	22,226,489
II. Detyrime të prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministritë e linjës)								
4864400	Detyrime për Investime nga Ministritë e Linjës (Ministria e Infrastrukturës)							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Ministria e Brendshme për punonjës të Gjendjes Civile)							
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin								
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		10,419,769	0	0	10,419,769	19,805,360	7,998,640	22,226,489

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Tabela nr. 1. Të dhënat në mënyrë analitike mbi strukturën e Sektorit të Tatim-Taksave për vitin 2023.

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Urdhri i emërimit
1	A.M	Përgjegjës sektori	Kontabilitet Finance, Master Profesional	Datë 05.04.2018
2	A.XH	Specialist	Administrim Biznesi, Master Shkencor	Datë 23.04.2007
3	E.G	Specialist	Administrim Biznesi, Master Profesional	Datë 08.08.2016
4	L.D	Specialist	Master Shkencor Financë	Datë 23.01.2023
5	G.H	Specialist	E mesme ekonomik	Datë 11.01.2021

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Tabela nr. 6. Informacion përmblendhës mbi ndarjen e tokës bujqësore në Bashkinë Mallakastër.

Nr.	Emri i Fshatit	Tokë Bujqësorë Gjithsej	Kategoritë e tokës						
			II	III	IV	V	VI	VII	
a	b	c	1	2	3	4	5	6	
I	Ballsh	64.91	-	-	64.91	-	-	-	
Shuma		64.91	-	-	64.91	-	-	-	
II	Nj.Ad.Selitë								
1	Gjerbes	248,95	-	-	162.9	-	86.5	-	
2	Cerril	154	-	-	-	-	-	154	
3	Kapaj	180.4	-	-	134	-	-	46.2	
4	Selitë	64	-	-	-	-	-	64	
Shuma total		647,35	-	-	296,9	-	86,5	264,2	
III	Nj.Ad. Qëndër								
1	Belishovë	190.38	-	10.44	19.49	111,47	41.9	7	
2	Belishovë e Re	102.1	-	13	62.14	23	0.5	3.23	
3	Lapulec	278	-	0	3.5	51.7	209.8	13	
4	Lofkend	112.9	-	0	8.1	52.9	34.4	17	
5	Visokë	297.5	-	0	142.8	110.10	40.2	5.2	
6	Grancie	131	-	0	29	59.5	41.2	1.5	
7	Drenovë e Re	72.6	-	0	0	23	47,41	2.1	
8	Dren Fushë	107.6	-	0	67.9	36,45	3.2	0	
9	Dukas	92.47	-	0	36,22	50,24	6	0	
10	Lavdan	105.1	-	0	0	0	57,22	47,85	
11	Kash	142	-	0	31,94	106	3,47	0	
12	Usoj	98.41	-	0	23,47	29,4	45,5	0	
13	Drenovë	243	-	0	0	55,2	161,3	26,53	
Shuma		1,973,06	-	23,44	424,56	597,49	692,1	123,41	
IV	Nj.Ad Hekal								
1	Mollaj	269.33	31.68	132.53	105.13	-	-	-	
2	Klos	29.93	-	200.43	92.56	-	-	-	
3	Rromës	426.57	22.83	221.27	169.87	11.62	-	-	
4	Hekal	860.4	20.1	460.46	379.8	-	-	-	
Shuma		1,586.23	74.61	1,014.69	747.36	11.62	-	0	
V	Nj.Ad Greshicë								
1	Greshicë e Re	369.24	-	-	-	112.91	256.33	-	
2	Greshicë	335	-	-	-	173.71	141	20.51	
Shuma		704.24	-	-	-	286.62	397.33	20.51	
VI	Nj.Ad Aranitas								
1	Metoh	209	-	5.17	56.75	95.04	29.5	23.49	
2	Aranitas	431	35	88.07	64.85	135.8	76.57	31	
3	Kalenj	254	-	30.10	91.32	81.08	37	14.3	
4	Panahor	355.97	9.8	35.38	81.33	198.6	24.35	13	
5	Cfir	304.82	-	13.28	57.16	221.14	12.59	-	
6	Cycen	56.46	-	2.42	22.98	28.49	2.15	0.41	
Shuma		1,611.25	44.8	174.42	374.39	760.15	182.16	82.2	
VII	Nj.Ad Fratar								
1	Dames	101.35	-	-	35	29	21	15	
2	Bejar	482.61	-	140.22	137.87	110.67	68.70	25.27	
3	Ninesh	443.31	-	-	147.65	128.96	95.18	71.51	
4	Gadurov	109.89	-	-	40.78	32.91	23.06	13.17	
5	Kremenar	134.32	-	-	52.7	41.7	27.62	9.44	
6	Malas	101.35	-	-	34.90	28.60	20.90	14.90	
Shuma		1,372.83	-	140.22	448.9	371.84	256.46	149.29	
VIII	Nj.Ad Fratar								
1	Ngracan	307	-	-	40.6	160.9	103	1.8	
Shuma		307	-	-	40.6	160.9	103	1.8	
IX	Nj.Ad Kutë								
1	Corrush	540.97	162.91	216.21	107.66	53.17	-	-	
2	Kutë	519.79	104.52	311.43	103.84	-	-	-	
3	Drizar	153.29	-	91.50	44.90	16.87	-	-	
4	Pocem	38.72	-	23.38	11.69	3.89	-	-	
5	Anëbreg	180.02	39.59	108.31	36.28	-	-	-	
Shuma		1,432.79	307.02	750.83	304.37	73.93	-	-	
Total Bashkia Mallakastër		9,699.66	426.43	2,103.6	2,701.99	2,272.55	1,717,55	641.41	

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

Tabela nr. 12. Situata debitore nga dhënia me qira e tokave bujqësore.

Njësia	Sipërfaqja	Nr. i Kontratave	Detyrime të prapambetura 2022	Vlera 2023	Pagesa 2023	Detyrime të prapambetura 2023	Debitorë
Qendër	614,9	70	1,008,730	369,440	255,440	1,122,730	35
Hekal	616,1	46	190,134	429,007	396,953	235,770	36
Aranitas	484,7	47	675,080	267,420	325,360	617,140	25
Kutë	248,5	24	348,600	142,500	113,700	377,400	15
Selitë	76	6	57,000	45,600	48,600	48,000	3
Fratar	190,7	17	18,480	114,420	100,980	31,920	13
Totali	2,230,90	210	2,298,024	1,368,387	1,241,033	2,432,960	127

Burimi i të dhënave: Bashkia Mallakastër.

VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nr. Aktit	Data e mbajtjes së aktit	Objekti i akt konstatimit, akt verifikimit	Nr Fletëve	Protokolli i Bashkisë Mallakastër		Audituesi
						Nr.	Datë	
1	Akt konstatimi	1	16.02.2024	Auditim mbi kontrollin ne brendshëm financiar publik.	12	122/4	01.03.2024	Artan Vokshi
2	Akt konstatimi	2	16.02.2024	Auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla.	15	122/5	01.03.2024	Artan Vokshi
3	Akt konstatimi	3	16.02.2024	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.	13	122/6	01.03.2024	Kejvi Haxhaj
4	Akt konstatimi	4	16.02.2024	Burimi i krijimit të taksave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.	16	122/7	01.03.2024	Kejvi Haxhaj
5	Akt konstatimi	5	16.02.2024	Mbi auditimin e zbatimit e kërkesave të Ligjit nr. 107/2014, "Përplanifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".	9	122/8	01.03.2024	Paolo Xhezo
6	Akt konstatimi	6	16.02.2024	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësishë Vendore (IVMT).	5	122/9	01.03.2024	Paolo Xhezo
7	Akt konstatimi	7	16.02.2024	Tenderi "Rikonstruksion i rrugës Panahor-Ngraçan (Segmenti Panahor-Subashja) dhe rrugës Ballsh-Drenovë e Re (Segmenti depo uji shkolla)" viti 2023.	18	122/10	01.03.2024	Marjus Hajro
8	Akt konstatimi	8	16.02.2024	Tenderi "Blerje karburanti (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)" viti 2023.	7	122/11	01.03.2024	Marjus Hajro
9	Akt konstatimi	9	16.02.2024	Tenderi "Ndërhjtyje e menjëhershme në pronën publike, shkolla "Hajredin Fratari" Damës Mallakastër" viti 2023.	10	122/12	01.03.2024	Marjus Hajro
10	Akt konstatimi	10	16.02.2024	Tenderi "Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash" viti 2023.	4	122/13	01.03.2024	Marjus Hajro
11	Akt konstatimi	11	16.02.2024	Tenderi "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit (Për nevojat e Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike) viti 2023.	4	122/14	01.03.2024	Marjus Hajro
12	Akt konstatimi	12	16.02.2024	Tenderi "Rikonstruksion i rrugës Rromës-Qafa e Drenovës (segmenti qendër Rromës-lagja Tabakaj, rrugës Fratar-Drizar dhe rrugës Ninësh-Nenaj-Damës) viti 2023".	15	112/15	01.03.2024	Marjus Hajro
13	Akt konstatimi	13	16.02.2024	Auditim i zbatimit të kontratave "Blerje karburanti (Diezel) viti 2023 (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike)" viti 2023 dhe "Blerje filtra, vaj motorri, hidrauliku, antifrizë, alkool frenash" viti 2023.	18	122/16	01.03.2024	Marjus Hajro
14	Akt konstatimi	14	16.02.2024	Zbatimi i punimeve "Rikonstruksion i rrugës "Diga e Rezervuarit-Anëbreg, Kutë, Çorrush".	4	122/17	01.03.2024	Ani Spahiu
15	Akt konstatimi	15	16.02.2024	Zbatimi i punimeve "Rikonstruksion i rrugëve në fshatrat Dukas, Visokë, Greshicë, Mollaj".	5	122/18	01.03.2024	Ani Spahiu
16	Akt konstatimi	16	16.02.2024	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	26	122/19	01.03.2024	Marjus Hajro
17	Akt konstatimi	17	01.03.2024	Zbatimi i punimeve "Ndërtimi i linjës së transmetimit të rrjetit të jashtëm të ujësjellësit rajonal (nga burimi i Poçemit)".	9	122/20	01.03.2024	Ani Spahiu
18	Akt konstatimi	18	01.03.2024	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	42	312/20	01.03.2024	Marjus Hajro

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT